**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

001 Numër:105/2026
Data:23.07.2026

**Komuna e Istog**
Opština Istok
Istog Municipality

http://kk.rks-gov.net/istog/
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

**Për**: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe nenit 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve te Kuvendit te Komunës.

**T H Ë R R A S**

Mbledhjen e **8-të** të rregullt të Legjislacionit të VIII-të të Kuvendit të Komunës.
Mbledhja do të mbahet me**: 31.07.2026, e Premte,** në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë **në ora 10:00.**

**R E N D D I T E:**

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2026,
4. Njoftimi me raportin e punës së Kryetarit të komunës për 6 mujorë (janar – qershor) të vitit 2026,
5. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe Planit të Veprimit për Eliminimin e të gjeturat të rekomanduara nga AP.
6. Raporti për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes se qëllimit te dhënies në shfrytëzim te pronave te paluajtshme të komunës.
7. Raporti i zbatimit te planit lokal te veprimit për barazinë gjinore 2024-2026 për periudhën Janar – Qershor 2026.
8. Njoftim me raportin e KRM Ambienti – Istog, Janar – Qershor 2026.
9. Themelimi i komisionit te aksionarëve për KRM – Ambienti njësia në Istog.

**Kryesuesi i Kuvendit**
**z. Enver Rugova**

**Vërejtje :**
Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje,
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
"Ambienti" SH.A.
Nr. 976
Data. 08 · 07 · 2026
NJËSIA OPERATIVE - ISTOG

AMBIENTI KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE **Njësia Operative – Istog**

**RAPORT GJASHTËMUJOR I PUNËS**

**K.R.M. "Ambienti" Sh.A.**

**Njësia Operative Istog**

Për periudhën: Janar – Qershor 2026

---

Për:

- Z. Ilir Ferati – Kryetar i Komunës së Istogut
- Komisionin e Aksionarëve
- Drejtorinë për Shërbime Publike
- Asamblenë Komunale të Istogut

---

Nga:

Ndërmarrja K.R.M. "Ambienti" Sh.A.

Njësia Operative Istog

---

## Hyrje

Ky raport paraqet aktivitetet, funksionimin dhe rezultatet e punës së K.R.M. "Ambienti" Sh.A. – Njësia Operative Istog për periudhën Janar–Qershor 2026, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat komunale për menaxhimin e mbeturinave dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ndërmarrja ushtron veprimtarinë e saj në bazë të:

- Ligjit për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Statutit të Ndërmarrjes;
- Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Rregulloreve të brendshme të Ndërmarrjes "Ambienti".

---

## Veprimtaria e Ndërmarrjes

Veprimtaria e K.R.M. "Ambienti" Sh.A. – Njësia Operative Istog ndahet në:

### Veprimtaria primare

Veprimtaria primare përfshin grumbullimin, bartjen dhe deponimin e mbeturinave komunale në Deponinë Sanitare në Sferkë, Komuna e Pejës, si dhe bartjen dhe deponimin e mbeturinave nga institucionet e rëndësisë së veçantë, përfshirë Burgun dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) në Dubravë, Komuna e Istogut.

### Veprimtaria sekondare

Veprimtaria sekondare përfshin pastrimin dhe fshirjen e përditshme të sipërfaqeve publike, larjen e tyre, mirëmbajtjen e gjelbërimit, mirëmbajtjen e varrezave dhe memorialeve, si dhe angazhimin e fuqisë punëtore dhe mekanizmit gjatë aksioneve për rregullimin e ambientit dhe kryerjen e punëve të tjera në kuadër të veprimtarisë së Ndërmarrjes.

---

## Shtrirja gjeografike e shërbimeve

Shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike janë ofruar në 100% të territorit të Komunës së Istogut, duke përfshirë zonat urbane dhe rurale.

**Struktura organizative**

Gjatë gjashtënujorit , struktura organizative e Ndërmarrjes ka qenë e organizuar në këta sektorë:

- Sektori Administrativ;
- Sektori Operativ.

| | Pozita | Numri |
|---|---|---|
| **Sektori administrativ** | | |
| | **Menaxher** | **1** |
| | **Zyrtar financiar** | **1** |
| | **Kontabilist** | **1** |
| | **Faturist** | **1** |
| | **Arkatar** | **1** |
| | **Inspektor** | **1** |
| | **Zyrtar për ankesa dhe kërkesa të klientëve** | **1** |
| | **Inkasantë** | **6** |
| | **Referët furnizimi** | **1** |
| | **Pastrues** | **1** |
| **Sektori i operatives** | | |
| | **Kryepunëtor** | **2** |
| | **Automekanik** | **1** |
| | **Vozitës** | **7** |
| | **Punëtorë fizik** | **24** |
| | **Roje** | **2** |
| **Totali** | | **51** |

**FATURIMI DHE INKASIMI**

**Janar- Qershor 2026 janë lëshuar këto fatura mujore:**

| Nr | Muaj | Nr.faturave | Amvisëri | Institucione | Biznese | Shuma e faturimit me TVSH € | Shuma e inkasimit me TVSH € |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 10825 | 9910 | 70 | 845 | 105277.84 | 85131.15 |
| 2 | Shkurt | 10857 | 9950 | 69 | 838 | 99407.60 | 97020.09 |
| 3 | Mars | 10891 | 9974 | 70 | 847 | 100658.54 | 77825.26 |
| 4 | Prill | 10904 | 9981 | 71 | 852 | 100774.28 | 85220.33 |
| 5 | Maj | 10916 | 9990 | 69 | 857 | 99624.63 | 75902.59 |
| 6 | Qershor | 10940 | 10015 | 70 | 55 | 99795.82 | 81403.92 |
| | Totali | 65333 | 59820 | 419 | 4294 | 605538.71 | 502503.34 |

**Në periudhën Janra –Qershor janë regjistruar 115 klientë të rinj në të gjitha kategoritë e shërbimit.**

**Tabela e Faturimit dhe Inkasimit me TVSh për periudhën Janar –Qershor/2026**

| Nr. | Kategoria e Klientëve | Faturimi € | Inkasimi € | Përqindja (%) |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Amvisëria | 414328 | 311617.69 | 75.21 |
| 2. | Institucionet | 87422.53 | 82197.64 | 94.02 |
| 3. | Bizneset | 103788.18 | 108688.01 | 104.72 |
| | TOTALI | 605538.71 | 502503.34 | 82.98 |

## Të hyrat dhe shpenzimet

Të hyrat e ndërmarrjes gjatë periudhës raportuese janë realizuar nga inkasimet e kryera për shërbimet e ofruara ndaj klientëve.

Shpenzimet e realizuara gjatë periudhës raportuese, kanë qenë kryesisht të domosdoshme për mbarëvajtjen e aktivitetit operacional të ndërmarrjes dhe përfshijnë:

- Shpenzime për të ardhura personale të punëtorëve;
- Shpenzime për derivate të naftës, të cilat janë të pashmangshme dhe relativisht të larta, bazuar në natyrën dhe intensitetin e aktivitetit të ndërmarrjes;
- Shpenzime për ulje, goma, antifriz, bateri dhe materiale të tjera ndihmëse;
- Shpenzime për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, duke marrë parasysh se pjesa më e madhe e tyre është e vjetruar;
- Shpenzime për blerjen e rrobave të punës për punëtorët (xhaketa, pantallona, bluza/maica dhe këpucë pune);
- Shpenzime për pajisje mbrojtëse personale, si doreza dhe çizme;
- Shpenzime për mjete pune, përfshirë: fshesa, lopata, kolica, kosa për bar, tela për trimer, bishta për lopata, grabuja dhe pajisje për gërryerjen e barit nëpër trotuare;
- Shpenzime për pjesë dhe materiale teknike, si: rrotëza për kontejnerë, shpanera, llamarinë;
- Shpenzime për material administrativ, përfshirë: fatura, letër, tonera, blloqe për inkasantë, blloqe për shfrytëzim të automjeteve, lapsa, fletore, fascikla dhe foldera;
- Paisje për mirëmbajtjen e hapsëirave publike
- Shpenzime kapitale për blerjen e një cistern për larje të rrugve dhe hapsirav publike.

**Specifikimi i shpenzimeve Janar Qershor/ 2026**

| Nr | Përshkrimi | Totali € |
|---|---|---|
| 1 | Shpenzimet e KES\|CO | 236.40 |
| 2 | Shpenzimet e IPKO-S | 180 |
| 3 | Shpenzimet e Vala | 443.76 |
| 4 | Shpenzime Adminidtrative | 1323.50 |
| 5 | Shpenzimet e Naftës | 56304.10 |
| 6 | Shpenzimet e Vajrave | 4481.50 |
| 7 | Tatime dhe Kontribute ,QL tatimi në fitim | 38264.62 |
| 8 | TVSH | 28109.75 |
| 9 | Shpenzimet e provizionit | 279.10 |
| 10 | Shpenzimet e PAGAVE | 211311.21 |
| 11 | Shpenzimet e Auto gomave | 2938 |
| 12 | Shpenzimet e reprezentacionit | 633.7 |
| 13 | Paisje për hapsira publike | 7830 |
| 14 | Shpenzimet e Regjistrimit te Automjeteve | 5601.08 |
| 15 | Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit , mjete punë | 29483.34 |
| 16 | Shpenzime higjienike | 156.82 |
| 17 | Blerja e Cisternes | 49560 |
| 18 | Sigurimet shëndetsore | 6547.50 |
| 19 | Pagesa për Deponi | 24000 |
| 20 | Dorza,rroba pune | 5370.82 |
| 21 | Fatura dhe blloka të inkasantëve për Administrat | 744.50 |
| 22 | Tatimi në pronë | 149.90 |
| 23 | Të tjera | 695 |
| | Totali | 474644.60 |

Sektori i operatives

Në këtë sektor janë të angazhuar shumica e fuqisë punëtore të Ndërmarrjes.
Në zonën e përfshirjes në rrjetin e mbledhjes së mbeturinave kemi të shpërndarë :

**Numri i kontejnerëve :**

| Nr. | vendbanimi | Nr. i kontejnerëve 1.1 m³ | Nr. i kontejnerëve të hapur (7m³,5m³) | Nr. i kontejnerëve 120L | Nr.i komposterve |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Banjicë | | | | |
| 2 | Banjë | 36 | | | 2 |
| 3 | Belicë | 1 | | | |
| 4 | Bellopojë | 3 | | | |
| 5 | Carallukë | | | | 4 |
| 6 | Cërkolez | 1 | | | |
| 7 | Cerrcë | 6 | | | 3 |
| 8 | Dobrushë | 14 | | | |
| 9 | Draglec | 9 | | | |
| 10 | Drejë | | | | |
| 11 | Dubovë e Vogël | | | | |
| 12 | Dubravë | 1 | | | |
| 13 | Gurakoc | 34 | | | 2 |
| 14 | Istog | 161 | | 600 | 10 |
| 15 | Istog i poshtëm | 6 | | 180 | 3 |
| 16 | Kaliqan | 2 | | | 1 |
| 17 | Kashicë | 4 | | | |
| 18 | Kërrninë | 1 | | | 3 |
| 19 | Kosh | | | | |
| 20 | Kovragë | 7 | | | 1 |
| 21 | Llugë | 2 | | | 1 |
| 22 | Llukac i Begut | 1 | | | 3 |
| 23 | Llukac i Thatë | | | | |
| 24 | Lubovë | 4 | | | 7 |
| 25 | Lubozhdë | 7 | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **26** | **Mojstir** | | | | **1** |
| **27** | **Muzhevinë** | **4** | | | |
| **28** | **Orrobërdë** | | | | |
| **29** | **Osojan** | **3** | | **100** | |
| **30** | **Polanë** | | | | |
| **31** | **Prekallë** | | | | |
| **32** | **Prigodë** | **1** | | | **1** |
| **33** | **Rakosh** | **9** | | | **3** |
| **34** | **Serbobran** | | | | |
| **35** | **Shalinovicë** | | | | |
| **36** | **Sinajë** | **7** | | | **5** |
| **37** | **Staradran** | **2** | | | **1** |
| **38** | **Studenicë** | | | | **2** |
| **39** | **Suhogërllë** | **2** | | | |
| **40** | **Tomoc** | **3** | | | **6** |
| **41** | **Trubuhoc** | **1** | | | |
| **42** | **Tuçep** | | | | |
| **43** | **Uçë** | **2** | | | |
| **44** | **Veriq** | **1** | | | |
| **45** | **Veriq i Ri** | | | | |
| **46** | **Vrellë** | **17** | | | **12** |
| **47** | **Zablaq** | | | | |
| **48** | **Zallq** | **11** | | | |
| **49** | **Zhakovë** | **1** | | | |
| **50** | **Kamenic** | **1** | | | **1** |
| **51** | **Shushicë** | **3** | | | |
| **52** | **Burgu** | **33** | | | |
| **53** | **F.S.K** | **22** | | | |
| **54** | **Devolli (Sinajë)** | **7** | **1** | | |
| **55** | **Padalishtë** | | | | |
| **56** | **Policia Jasenovik** | | **1** | | |
| | **Totali** | **430** | **2** | **880** | **72** |

AMBIENTI KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE Njësia Operative – Istog

**Sasia e mbeturinave e deponuar në deponi Sferkë Pejë për Janar -Qershor 2026 është si vijon :**

| Nr | Muaj | Shprazjet në deponi Sferk | Sasia e mbeturinave T | Nafta L | KM |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 113 | 830.80 | 6378 | 26146 |
| 2 | Shkurt | 98 | 626.90 | 5836 | 25496 |
| 3 | Mars | 122 | 788.40 | 6660.31 | 26091 |
| 4 | Prill | 116 | 745.90 | 6872 | 25466 |
| 5 | Maj | 112 | 715 | 7061 | 26186 |
| 6 | Qershor | 137 | 820.30 | 6675 | 26533 |
| | Totali | 698 | 4527.3 | 39482.3 | 155918 |

Mesatarja: Xhirot,mbeturinave në ton,Nafta dhe Km:

| | | Xhirot | Mbeturinave në ton | Nafta L | Km |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ditore | 5.28 | 34.29 | 299.10 | 1181.19 |
| 2 | Mujore | 116.33 | 754.55 | 6580.38 | 25986.33 |
| 3 | Gjashëmujor | 698 | 4527.3 | 39482.3 | 155918 |

**Numri i ditëve të punës të ralizuar në mbledhje dhe bartjen e mbeturinave: 160 ditë.**
**Numri i ditëve të punës të ralizuar në mirëmbajtjen e hapsirave publike: 179 ditë.**

## Automjetet

| Automjetet për grumbullim dhe transport të mbeturinave | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Nr | Tipi | Kapacite ti ton | Viti i prodhimit | Targat |
| 1 | Ford | 7 T | 2011 | 03-671-EI |
| 2 | Ivecok Calabrez | 5T | 2000 | 03-213-JQ |
| 3 | Merceds me Grepa | 5T | 1987 | 03-149-IQ |
| 4 | Kamionet T4 | 1T | 2000 | 03-453-AI |
| 5 | Mercedes 3.4t | 3.4T | 2004 | 03-206-GO |
| 6 | Man | 5T | 2007 | 03-219-HD |
| 7 | Mercedes Benz | 5T | 2022 | 03-690-HP |
| 8 | Traktor | - | - | Në shfrytzim |
| 9 | Iveco Automatik | 7 T | 2009 | 03-856-ID |
| 10 | Mercedes Bens Actros 03-413-JH | 9T | 2008 | 03-371-JH |
| 11 | Mercedes Bens Actros 03-371-JH | 9T | 2008 | 03-413-JH |
| 12 | Veturë Golf | | 2018 | 03-740-JI |
| 13 | Autofshis | | 2017 | 03-452-JL |
| 14 | Cistern | 8500L | 2000 | 03-349-JT |

**AMBIENTI** KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE **Njësia Operative – Istog**

**Plani Operative Janar-Qershor 2026**

| **Plani Operative** | | **K.R.M "Ambenti"** | **Njësia Operative Istog** | |
|---|---|---|---|---|
| **DITET E JAVËS** | | | Vendbanimet që shërbehën, sipas rradhitjes në terën | Vendi ku zbrazen mbeturinat |
| **E Hënë** | 1 | | Gurrakoc | Deponia-Sferkë |
| | 2 | | ISTOGU Zona qendër- RR. Lidhja e Prizerenit<br>-RR. Deshmort Dervishaj<br>BURGU- | Deponia-Sferkë |
| | 3 | | Tomoc 2 lagje, Serbobran, Osmanaj ,Gurrakoc, Prekallë.<br>Dobrushë 2 lagje, Kamenicë,Vrellë Qendra,Lagj Dreshaj në Vrellë, lagj Idrizaj Lubozhdë, Lagj Hajdint bekt në Cerrcë, Istog Lagj Bytyqt, Lagj Llullakve- RR.Hasan Prishtina- Rrugës Hasan Halili | Deponia-Sferkë |
| | 4 | | Llugë,Kerrninë e Epermë, Zhakovë. Cerkolezë, Suhogerllë | Deponia-Sferkë |
| | 5 | | Banjë, Lubovë | Deponia-Sferkë |
| **E Martë** | 1 | | FSK- Kovragë | Deponia-Sferkë |
| | 2 | | Istog Zona qendër- RR. UÇK<br>-RR. Hysen Bujupi<br>-RR. Femi Agani | Deponia-Sferkë |
| | 3 | | -Cerrcë- Lubozhdë | Deponia-Sferkë |
| | 4 | | Kashicë, Staradran | Deponia-Sferkë |
| | 5 | | Veriq, Dubravë- Llukafc i Begut-Dobrushë | Deponia-Sferkë |
| | 1 | | Tomoc, Muzhevinë,Lagj Arifaj | Deponia-Sferkë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| E Merkurë | 2 | | Istog Zona qendër- Burgu- Laqjeja Shqiponja -RR. Drita e Parë, -RR. Arben Januzaj,-RR.Bajram Gashi-RR. Nimon Shabani | Deponia-Sferkë |
| | 3 | | Orroberdë, Kaliqani, Qendra Vrellë | Deponia-Sferkë |
| | 4 | | Trubohocë, Zbllaq. Osojan,Kerrninë e Ultë | Deponia-Sferkë |
| | 5 | | Bollopojë- Gurrakoci- Banjë | Deponia-Sferkë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| E Enjte | 1 | | Istog Zona Qendër- Synë- Mojstirë-Shushicë | Deponia-Sferkë |
| E Premte | 1 | | Cerrollukë, Banjë,Baic, Dubovë e vogel, Istog i Poshtëm | Deponia-Sferkë |
| | 2 | | Istog Zona qendër- BURGU,RR. UÇK, -RR.Hysen Bujupi, -RR. Lidhja e Prezrenit -RR. Dëshmorët Dervishaj | Deponia-Sferkë |
| | 3 | | Studenicë, Stupe, Kamenicë | Deponia-Sferkë |
| | 4 | | Uqë, Rakosh, Kërrninë e Eperme | Deponia-Sferkë |
| | 5 | | Istog- Gurrakoc- Zallq- Drejë-Kosh-RR- Pjetër Lorenc Mazrreku, Shalinovicë | Deponia-Sferkë |
| E Shtune | 1 | | Drogolecë -Prigodë | Deponia-Sferkë |
| | 2 | | Istog Zona qendër- Lagjja Blakaj, -RR. Rexhë Murati, -RR. Shaban Moni,- RR, Liria,- RR.Dheu i Bardh -RR. Selim Bajrami,-RR. Tirana -RR. Gazmend Zajmi -RR. Hajzer Hajzeri- RR. Rexhë Destani, -RR. 12 Prilli -RR. Drita e Parë | Deponia-Sferkë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 3 | | Vrellë me të gjitha rrugët | Deponia-Sferkë |
| | 4 | | Banjë, Gurrakoc zona qendër | Deponia-Sferkë |
| **E Diel** | | | | |
| | 1 | | Istog, Banjë, Gurrakoc zonat qendër | Deponia-Sferkë |
| | | | | |
| | | | | |

**Raporti i punës për Janar-Qershor 2026**

- Janë shqyrtuar kërkesa të qytetarëve që lidhen me shërbimet e ofruara nga kjo Ndërmarrje si dhe ngarkesat e tyre me obligime;

- Zgjerimi i veprimtarisë së grumbullimit të mbeturinave derë me derë.
- Vendime të tjera.

- Gjatë muajve Janar- Qershor 2026 është punuar sipas planit operativ për menaxhim të mbeturinave.

Në vazhdimësi kemi realizuar fshirjen e rrugëve dhe trotuareve në të gjithë qytetin, gjithashtu edhe nëpër zonat urbane si: Banjë, Vrellë, Gurrakoc, Zallq, Rakosh.
Mirëmbajtjen e hapësirave publike si: parqe ,varrezave, memorialve të dëshmorve, larje të rrugëve.

**1.Pastrimi i rrugëve publike në komunen e Istogut**

| Muaj | Sipërfaqja e perfunduar $m^2$ |
|---|---|
| Janar | 3058470 |
| Shkurt | 1572458 |
| Mars | 1717155 |
| Prill | 1735685 |
| Maj | 926900 |
| Qershor | 901130 |
| Totali | 9911798 |

**2.Larja e rrugëve publike në komunen e Istogut**

| Muaj | Sipërfaqja e perfunduar $m^2$ |
|---|---|
| Janar | 0 |
| Shkurt | 0 |
| Mars | 0 |
| Prill | 0 |
| Maj | 106830 |
| Qershor | 106830 |
| Totali | 213660 |

**3.Pastrimi i memorialve të Dëshmorëve në Komunën e Istogut**

| Muaj | Sipërfaqja e perfunduar $m^2$ |
|---|---|
| Janar | 9318 |
| Shkurt | 9318 |
| Mars | 9318 |
| Prill | 9318 |
| Maj | 9318 |
| Qershor | 9318 |
| Totali | 55908 |

**4.Pastrimi i Varrezave në Komunën e Istogut**

| Muaj | Sipërfaqja e perfunduar $m^2$ |
|---|---|
| Janar | 46144 |
| Shkurt | 48725 |
| Mars | 59304 |
| Prill | 80784 |
| Maj | 84710 |
| Qershor | 93295 |
| Totali | 412962 |

5.Mirëmbajtja dhe Pastrimi i parqeve publike në Komunën e Istogut

| Muaj | Sipërfaqja e perfunduar $m^2$ |
| --- | --- |
| Janar | 163470 |
| Shkurt | 113861 |
| Mars | 113861 |
| Prill | 115583 |
| Maj | 103844 |
| Qershor | 102574 |
| Totali | 713193 |




































Gjatë periudhës raportuese gjashtëmujore, KRM "Ambienti" – Njësia Operative Istog ka realizuar aktivitete të vazhdueshme në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit, me qëllim të përmirësimit të pastërtisë publike dhe ruajtjes së ambientit në territorin e Komunës së Istogut.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, janë identifikuar dhe eliminuar gjithsej 51 deponi ilegale, të shpërndara në zona të ndryshme të komunës. Paralelisht, janë zhvilluar aksione të rregullta për pastrimin dhe grumbullimin e mbeturinave përgjatë akseve rrugore lokale dhe regjionale.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve, është grumbulluar një sasi totale prej 21 tonë mbeturinash. Këto rezultate dëshmojnë për angazhimin e vazhdueshëm të Njësisë Operative Istog në përmbushjen e obligimeve të saj dhe shërbimin ndaj qytetarëve.












**Njësia Operative – Istog**

Në muajin Janar është realizuar rritja e pagave në bazë të vendimit të Kryeshefit në të gjitha sektoret.

Në muajin Prill janë blerë paisje për mirëmbajtjen e hapsëirave publike me vlerë 7830 €

Në muajin Maj është blerë një Cistern për larje të rrugve dhe hapsirav publike më vlerë 49560 €

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar aktivitete në terren për sensibilizimin e popullatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe përmbushjen e obligimeve ndaj Kompanisë "Ambienti".

Ky raport paraqet aktivitetet kryesore të Njësisë Operative "Ambienti" – Istog për periudhën Janar–Qershor 2026.

**Korrik, Istog**
**08. 07.2026**

**Menaxher**
**Alferd Tahirsylaj**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

ZKA
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

### Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Istogut (KI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Istogut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

### Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Keqklasifikime në kategori të ndryshme ekonomike jo adekuate në vlerë prej 2,231,264€, të cilat janë realizuar përmes ekzekutimit të vendimeve gjyqësore/ përmbarimore.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

### Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Istogut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

### Baza për konkluzion

A1 Tejkalim në realizimin e furnizimeve të sasive të përcaktuara në kontratën publike kornizë.

A2 Shpërblimi me kontratë i operatorit ekonomik (OE) në mungesë të plotësimit të kritereve të vendosura në dosjen e tenderit.

A3 Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare.

B2 Shfrytëzimi i pronës komunale pa kontratë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

### Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Istogut.

### Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Istogut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Istogut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

### Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Istogut me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Istogut.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

# 2 Gjetjet dhe rekomandimet[4]

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.Gjithashtu duhet të theksojmë se për vitin 2025 Thesari kishte ekzekutuar përmes procedurave përmbarimore/gjyqësore vlerën prej 2,231,264€, këto pagesa ishin  për kontratën kolektive të cilat ishin realizuar, nga kategoria ekonomike investime kapitale 1,974,035€ si dhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 257,229€.
Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre 5 (pesë) janë rekomandime të reja, dhe 7 (shtatë) të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

**Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve**

**Gjetja**

Ligji mbi Ndarjet Buxhetore Nr. 08/L-332 neni 15 paragrafi 12 përcakton se, ndarjet buxhetore nga rezerva me prioritet ndahen në kategorinë përkatëse të shpenzimeve për shlyerjen e vendimeve përmbarimore dhe gjyqësore me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ.
Si dhe bazuar në qarkoren buxhetore me Nr. 2025/02 të lëshuar nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) pika 3 kufijtë buxhetor për komunat, në kolonën rezerva komunat duhet të ndajnë buxhet për shlyerjen e detyrimeve kontingjente mjetet për ndarjen për detyrime kontingjente duhet ti marrin brenda kufijve të ndarë buxhetor për komunat, duke përjashtuar kategorinë paga dhe shtesa.

Gjithashtu, sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike" shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike jo adekuate në vlerë prej 2,231,264€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas urdhrave përmbarimor të gjykatës për zbatimin e kontratës kolektive nga kategoria e investimeve kapitale 1,974,035€, dhe nga mallra dhe shërbime 257,229€.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk kishte marrë parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore për të bërë planifikim adekuat sipas nevojave dhe kërkesave të shpenzimeve sipas kategorive përkatëse.

**Ndikimi**

Pagesat e realizuara nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare Vjetore të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-ve.

**Rekomandimi B1**

Kryetari duhet të sigurojë që, me rastin e përgatitjes së buxhetit të merr parasysh kërkesat e ligjit të buxhetit dhe qarkores buxhetore të MFPT, në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike adekuate.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

**Çështja A1 - Mos përputhje e sasive të realizuara sipas çmimit për njësi të peshuar dhe sasisë së realizuar**

**Gjetja**

Rregullorja Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik paragrafi 54.15 përcakton: Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët, dhe në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qellim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Po ashtu, sipas interpretimit të KRPP-së së datës 09.06.2023, gjatë realizimit të Kontratës Publike Kornizë – Shërbime, Ofruesi i Shërbimeve, faturimin e bënë duke u bazuar në shërbimet e kryera dhe çmimet për njësi të shërbimeve të kontratës (jo çmimeve të peshuara), por nuk lejohet të kaloj vlerën sipas kategorive dhe vlerën totale të parashikuar të kontratës.

Kontrata publike kornizë me çmim njësi ''Shërbimet e kujdesit paliativ, social, shëndetësor, shtëpiak dhe ambulator" me vlerë të parashikuar 450,000€ për 7 kategori të shërbimeve (Kategoria A 5%, B 10%, C 5%, Q 20%, D 20%, DH 20% dhe E 20%) janë vërejtur mospërputhje të theksuara ndërmjet peshimit të kategorive dhe realizimit të shërbimeve. Kategoria A" shërbimet shëndetësore'' ishte peshuar me 5% apo shprehur në vlerë 22,500€, deri sa në 15 fatura të rishikuara ishin realizuar 317,838€ (73% nga vlera totale), duke tejkaluar peshën e parashikuar prej 295,338€. Po ashtu të kategoria C "shërbimet shëndetësore" ishin peshuar me 5% apo shprehur në vlerë 22,500€, deri sa ishin realizuar në vlerë prej 114,952€ (26% nga vlera totale). Vlera e parashikuar sipas kontratës së nënshkruar 09.08.2024, nuk ishte tejkaluar pasi pagesat totale ishin në vlerë 435,804€. Megjithatë, realizimi i shpenzimeve nuk ishte në përputhje me peshimin e kategorive, pasi për kategoritë e peshuara me 90% janë realizuar vetëm 3% e vlerës, duke ndikuar në mos arritjen e qëllimit të planifikimit dhe kontraktimit për këto shërbime.

Tejkalimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës së caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në realizimin jo sipas objektivave të përcaktuara të organizatës. Kjo po ashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore për dy kategori dhe mosrealizim të parapare të kategorive tjera të peshuara sipas kontratës.

**Ndikimi**

Tejkalimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës së caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në realizimin jo sipas objektivave të përcaktuara të organizatës dhe mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët në realizim të kontratës. Kjo po ashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore për dy kategori dhe mosrealizim të parapare të kategorive tjera të peshuara sipas kontratës.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të vendosë kontrolle në përcaktimin e nevojave reale të komunës, në mënyrë që këto kontrata të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit. Po ashtu duhet të siguroj që të mos tejkalohen sasitë e parashikuara me kontratë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A2 - Shpërblimi më kontratë në mungesë të plotësimit të kritereve të vendosura në dosjen e tenderit**

**Gjetja** Ligji i prokurimit publik Neni 59 paragrafi 4 parasheh: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

OE të shpërblyer me kontratë në mungesë të plotësimit të kërkesave të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit po i paraqesim rastet si në vijim:

- Te kontrata "Rehabilitimi i kanalit të Gogës nga penda deri në Gurrakoc" në vlerë 596,631€, në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit në kërkesën 9 (aneksi 1 lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike) është kërkuar që OE të disponojë dy (2) cilindër vibrues me peshë 7-13 ton. Megjithatë, në ofertën e dorëzuar është prezantuar vetëm një (1) cilindër vibrues me peshë 13 ton, edhe pse ekziston një cilindër tjetër që është ofruar me dudë doganorë por përshkimi në të është cilindër jo vibrues;
- Te kontratat "Ndërtimi i rrugëve lokale – Lot 1 në Prigodë (Lagja Gashi Mehaj), Lot 2 në Llukafcë të thatë (Rruga Shaban Hajzeraj). Lot 3 Ndërtimi i rrugës në Llukafcë të thatë dhe Lot 4 Ndërtimi i rrugës Kamer Loshi në Veriq", për 4 lotet në vlerë totale 344,257€, në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, në kërkesën për kapacitetin teknik dhe profesional, kërkohet në pikën 7. OE duhet të jetë i licencuar nga komisioni i pavarur i minierave dhe mineraleve (KPMM) për bazë betoni, bazë asfalti dhe Gurëthyes (sortues) kopjet e licencave. Në ofertën e dorëzuara OE i shpërblyer më kontratë i mungonte licenca për Gurthyes (sortues).

Kjo ka ndodhur si pasojë e mungesë së funksionimit të kontrolleve të brendshme, në fushën e prokurimit, si dhe komisioni i vlerësimit nuk kishte vlerësuar ofertat në pajtim me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit.

**Ndikimi** Kontraktimi i OE pa i përmbushur kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, eliminon mundësinë e një procesi të mirëfilltë të prokurimit, i cili mund të përjashtoj nga procesi OE të përgjegjshëm dhe mund të ndikoj që kontrata të mos realizohet.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e prokurimit, në mënyrë që vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Po ashtu, përmes zyrtarëve përgjegjës të sigurojë se anëtarët e komisioneve procesin e vlerësimit e kryejn në pajtim me kriteret e vendosura në dosjen e tenderit, dhe në rast të gabimeve eventuale këto të evidentohen para nënshkrimit të raportit të vlerësimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A3 - Kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare**

**Gjetja**

Ligji i prokurimit publik Nr. 04/L-042, nenin 9 paragrafi 3 përcakton se, "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet a ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla". Po ashtu Ligji i Buxhetit nr. 08/L-332 për vitin 2025, neni 12 paragrafi 7 përcakton se; "Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në rast se shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2025 dhe për dy (2) vitet në vijim".

Komuna kishte lidhur kontrata për projekte në mungesë të buxhetit, rastet janë identifikuar si në vijim:

- Kontrata "Vazhdimi – Ndërtimi i qendrës së Istogut rruga Ibrahim Rugova, Fadil Ferati dhe UÇK-së" në vlerë totale të kontraktuar 3,448,492€. Në PIP për vitin 2025 dhe dy vitet vijuese janë paraparë fonde në vlerë 1,546,026€, ndërsa përmes marrëveshjes së mirëkuptimit me Ministrinë e Infrastrukturës për vitet 2025 dhe 2026 janë siguruar edhe 1,018,044€. Nga kjo rezulton një mungesë e fondeve për realizimin e projektit për 884,422€.
- Kontrata "Rregullimi i shtratit të lumit të Istogut, prej burimit të ujit e deri të ura e hotel troftës – Faza e parë" në vlerë të kontraktuar 1,499,672€. Në PIP janë paraparë fonde në vlerë 1,017,217€, duke rezultuar në mungesë të fondeve për realizimin e projektit në vlerë 482,455€.

Kjo ka ndodhur për shkak të analizave të mangëta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

**Ndikimi**

Mungesa e analizës së mirëfilltë të kostove financiare për projektet kapitale, nënshkrimi i kontratave për tej limiteve buxhetore dhe hyrja në obligime kontraktuale pa u siguruar mjetet e nevojshme buxhetore, krijon vështirësi dhe çrregullon rrjedhën financiare, rrit nevojën për ridestinime buxhetore për të mbuluar deficitin e këtyre projekteve si dhe rrezikun e kostove shtesë.

**Rekomandimi A3**

Kryetari duhet të sigurojë se vlerat e kontratave publike të lidhura (nënshkruara) për projektet kapitale të janë në përputhje me shumat e aprovuara me ligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin fiskal dhe për dy (2) vitet në vijim.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B2 - Shfrytëzimi i pronës komunale pa kontratë**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | Sipas Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 23përcakton: 1. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.<br><br>Në një (1) rast të shfrytëzimit të pronës komunale, kontrata për shfrytëzimin e pronës kishte skaduar në vitin 2012, megjithatë, prona vazhdon përdoret nga shfrytëzuesi dhe të faturohet nga komuna. Shfrytëzuesi i kësaj prone kishte obligim të papaguar të qirasë ndaj komunës në vlerë 10,320€.<br><br>Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme për të formalizuar procesin e kontraktimit të pronave të dhëna me qira. |
| **Ndikimi** | Shfrytëzimi i pronave komunale në mungesë të kontratave shkakton paqartësi për kushtet kontraktuale në mes komunës dhe shfrytëzuesit të pronës publike, por edhe vështirësi në inkasimin e të hyrave nga qiraja. |
| **Rekomandimi B2** | Kryetari duhet të sigurojë që, pas përfundimit të afatit të caktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona t'i kthehet komunës, apo kontratat të vazhdohen bazuar në çmimet e tregut, sipas procedurave përkatëse për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2025, ishin 1,496,509€, përderisa ishin realizuar 2,244,607€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2025, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 397,963€, si dhe të hyra nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës në vlerë 6,334€.

**Çështja A4 - Mos raportimi i Kryetarit në Kuvendin Komunal lidhur me pronat e dhëna në shfrytëzim**

**Gjetja** Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se "Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t'i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim".

Kryetari i Komunës nuk kishte paraqitur asnjë raport periodik gjashtëmujor Kuvendit Komunal lidhur më monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

Shkak i ndodhjes është anashkalimi i kërkesave ligjore në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

**Ndikimi** Mungesa e raportimit për monitorimin e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim përveç se krijon pa pajtueshmëri ligjore dhe ndikon transparencën dhe realizimin e plotë të të hyrave nga ana e komunës.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme si dhe përmbushjen e planeve për dhënie të pronave në shfrytëzim.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 8,862,935€ derisa janë shpenzuar 8,841,170€, apo rreth 100% e buxhetit. Numri i pozitave të aprovuara sipas ligjit të buxhetit ishte 985 punonjës, ndërsa në fund të vitit numri i të punësuarve ishte 971.

**Çështja A5 - Mos azhurnimi i kontratave të punës në bazë të ligjit për zyrtarët publik**

| | |
|---|---|
| **Gjetja** | Rregullorja (QRK) nr. 06/2024 për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil neni 34 përcakton se “Obligohen institucionet në fushën e veprimit të kësaj Rregulloreje të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se tre (3) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje”. Po ashtu sipas Ligjit Nr. 08/I-197 për zyrtarët publik neni 102 paragrafi 1 përcakton: “Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës”.<br><br>Komuna ka hartuar me datën 04.06.2025 rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale, si parakusht për harmonizimin e kontratave të punës me kuadrin e ri ligjor. Nga 70 kontrata të testuara, në 30 raste, kontratat nuk ishin të azhurnuara sa i përket koeficienteve dhe elementeve tjera të përcaktuara me Ligjin për zyrtarët publik.<br><br>Si rrjedhojë, zyrtarët publikë vazhdojnë të kenë kontrata të pa harmonizuara me ligjin dhe rregulloret në fuqi. Mos azhurnimi i kontratave ka ardhur si rezultat i vonesës së themelimit të komisionit të ristrukturimit në administratën Komunale. |
| **Ndikimi** | Mos azhurnimi i kontratave të punës dhe mospërputhja me sistemin e ri të koeficienteve ka shkaktuar mosrespektim të kërkesave ligjore dhe ka ndikuar në mos përfshirjen e saktë të pozitave në strukturën e pagave. |
| **Rekomandimi A5** | Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e punës të azhurnohen dhe të harmonizohen me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe rregulloren për klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës. |

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,751,105€, prej tyre në 2025 ishin shpenzuar 5,502,536€,që kanë të bëjnë më vendime gjyqësore përmbarimore, ndërtimin dhe rregullimin e infrastrukturës rrugore, ujësjellësit, rrjetin e kanalizimeve ndërtimin e parqeve dhe investime tjera kapitale, ku kemi hasur si në vijim:

**Çështja B3 - Mungesë e informatave të plota për menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike**

**Gjetja**

Rregullorja Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik neni 70.24 f thekson se menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik".

Menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar me informata të plota menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve në modulin përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

**Ndikimi**

Mungesa e plotë e të dhënave të menaxhimit të kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë dhe transparent të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

**Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë të dhënat e plota për menaxhimin e kontratave në modulin përkatës në sistemin e prokurimit publik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 125,513,904€, pasurive jokapitale është 748,622€, si dhe e stoqeve 108,151€. Ku kemi hasur në çështjet si në vijim:

**Çështja B4 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare**

**Gjetja**

Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare, neni 19.4.3 përcakton se: "Çdo fundvit bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Po ashtu neni 21 i kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare", po ashtu neni 11.3 përcakton se: "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet dhe zhvlerësimi".

Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare dhe atë për administratën komunale, sektorin e shëndetësisë dhe për drejtorinë e arsimit. Mirëpo nuk kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar më gjendjen e pasurive me regjistrat kontabël rrjedhimisht nuk dihet diferencat në mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Po ashtu nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare që kanë të bëjnë më vlerësimin e pasurive të dëmtuara, vlerësimin e kërkesave për tjetërsim të pasurive si dhe përgatitjen e raportit për pasuritë që duhet të largohen nga përdorimi.

Gjithashtu duhet të theksojmë se nga analiza e shpalosjes dhe të dhënave të pasurive jo financiare kapitale mbi 1,000€ në PFV kemi vërejtur se akoma ka të regjistruara në kategorinë investime në vijim për vitet 2015 deri në vitin 2023 në vlerë totale 6,092,907€ të cilat përkundër që mund të jenë në përdorim akoma mbahen në regjistra si pasuri në vijim.

Kjo gjendje ishte për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme lidhur me zbatimin e kërkesave të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mungesës së udhëzueseve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

**Ndikimi**

Mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit më gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë. Po ashtu regjistrimi jo i duhur në procesin e përmbylljes së investimit kapital ka ndikim në vlerën e shpalosjes financiare të pasurive kapitale si rezultat i mos aplikimit të zhvlerësimit.

**Rekomandimi B4**

Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe të bëhet krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen kontabël të pasurive, duke i sqaruar të gjitha diferencat lidhur me regjistrimin e drejtë të pasurisë jo financiare kapitale sipas klasifikimit kontabël.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B5 - Nënvlerësimi i pasurive nën 1,000€ dhe mos regjistrimi në sistemin e-pasuria**

**Gjetja**

Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.1. përcakton se, "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Po ashtu neni 6.3. përcakton se: Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Pasuritë jo kapitale nën 1,000€, të cilat janë raportuar me vlerë prej 748,622€ në nenin 19.3.2 të PFV, ishin nënvlerësuar për 9,478€, si pasoj e mos regjistrimit të tyre, tutje për Drejtorin e Arsimit dhe të Shëndetësisë nuk ishte në funksion përdorim sistemi e-pasuria për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive jo financiare jo kapitale.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në monitorimin dhe verifikimin e regjistrave të pasurisë, ku kjo kupastaj ka ndikuar që pasuritë të mos jenë regjistruar në regjistrat përkatës.

**Ndikimi**

Mos regjistrimi i pasurisë, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, mund të ndikon në humbjen a po tjetërsimin e pasurisë dhe prezantimin e informatave jo të plota në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi B5**

Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtarët e pasurive regjistrojnë pasuritë jo kapitale në regjistra kontabël, ashtu që pasuritë të raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.5 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme janë shpalosur në PFV në vlerë 3,027,866€, dhe ishin nga tatimi në pronë në vlerë 2,761,936€, lejeve të ndërtimit në vlere prej 42,324€, taksa nga afarizmi për biznese në vlere prej 174,831€, si dhe nga qiraja në vlerë 40,835€ dhe tjera 7,940€.

**Çështja B6 - Rritja e llogarive të arketueshme**

**Gjetja**

Sipas nenit 26 të ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L- 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kapitulli për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove dhe neni 27 përcakton se nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Arkëtimi i të hyrave tjera duhet të bëhet sipas afateve të përcaktuara në faturë për secilin lloj të të hyrave.

Komuna nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhje e llogarive të arketueshmeve (LIA) pasi që vazhdon rritja e tyre nëpër vite. Gjatë vitit 2025 edhe pse LIA-të ishin rritur për 1,477,144€ në krahasim me vitin paraprak, komuna nuk kishte marrë ndonjë veprim konkret për inkasimin e tyre. Pjesëmarrjen më të madhe të të arkëtueshmeve është në tatimin në pronë për 2,761,936€. Pavarësisht, se në (9) nëntë raste kemi vërejtur se janë lidhur kontrata për pagesën e tatimit në pronë me këste, për të tjerat si ato për shfrytëzimin e pronës publike, komuna ka bere disa vërejtje me shkrim ndaj shfrytëzuesve. Megjithatë, komuna nuk ka ndonjë një plan për inkasimin e borxheve vite me radhë.

Dobësitë e identifikuara ishin për shkak të mos funksionimit të kontrolleve të brendshme tek menaxhimi i llogarive të arketueshmeve dhe mungesës së veprimeve përkatëse për inkasimin e tyre.

**Ndikimi**

Mos arkëtimi me kohë i LIA-ve reflekton në shkallë më të ulët të buxhetit nga të hyrat vetanake. Njëkohësisht kjo mund të ndikoj edhe në arritjen e objektivave të komunës, duke pamundësuar investime në projekte që financohen nga këto fonde.

**Rekomandimi B6**

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.6 Funksioni i auditimit të brendshëm

Komuna në vitin 2025 nuk ka Funksionalizuar/themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB) dhe nuk ka vepruar konform Rregullores QRK Nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik.

**Çështja B7 - Mos themelimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm**

**Gjetja**

Rregullorja QRK - NR 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, neni 5 përcakton se çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro themelon Njësinë e Auditimit të Brendshëm, e cila duhet të ketë së paku tre auditor.

Komuna e Istogut me pensionimin e Auditorit të Brendshëm prej datës 07.04.2025, nuk kishte funksionale Njësinë e Auditimit të Brendshëm, pasi që nuk ka auditor të brendshëm në organizatë.

Menaxhmenti nuk kishte bërë përpjekje ligjore si shpallja e konkursit për ta themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm.

Mungesa e konkursit për punësim të auditorit të brendshëm ishte shkak i mos themelimit të kësaj njësie shumë të rëndësishme për komunën.

**Ndikimi**

Mos themelimi i NJAB-së, ndikon në pamundësinë e marrjes së veprimeve nga menaxhmenti për të adresuar dobësitë dhe rreziqet e evidentuara në kontrollin e brendshëm.

**Rekomandimi B7**

Kryetari duhet të sigurojë që do ta themeloj NjAB-in sipas kërkesave me stafin e nevojshëm. Po ashtu, duhet të sigurohet për realizimin e auditimeve të parapara me planin vjetor të auditimit të NjAB-së.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

# 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final[5] | 2025 Shpenzimet | 2024 Shpenzimet | 2023 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Burimet e fondeve** | **15,937,257** | **18,123,091** | **17,816,003** | **15,872,565** | **14,692,547** |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 14,440,748 | 15,051,189 | 14,996,894 | 13,970,835 | 13,009,403 |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0 | 950,353 | 943,265 | 440,085 | 521,746 |
| Të hyrat vetanake | 1,496,509 | 1,496,509 | 1,481,289 | 1,379,642 | 1,103,098 |
| Donacionet vendore | 0 | 104,098 | 93,400 | 82,004 | 45,876 |
| Donacionet e jashtme | 0 | 520,942 | 301,155 | 0 | 12,424 |

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,185,834€, kjo rritje është rezultat i rritjes nga granti qeveritar në bazë të Vendimit të Qeverisë për 610,441€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 950,353€, si dhe donacioneve 625,040€.

Në vitin 2025 Komuna ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 17,816,003€, me rritje prej 3% krahasuar me vitin e kaluar (2024 - 95%). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2025 Shpenzimet | 2024 Shpenzimet | 2023 Shpenzimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike** | **15,937,257** | **18,123,091** | **17,816,003** | **15,872,565** | **14,692,547** |
| Pagat dhe mëditjet | 8,252,494 | 8,862,935 | 8,841,170 | 8,772,730 | 8,088,978 |
| Mallrat dhe shërbimet | 2,684,763 | 2,707,359 | 2,674,590 | 2,475,628 | 1,896,275 |
| Komunalitë | 310,000 | 310,967 | 310,899 | 259,149 | 198,874 |
| Subvencionet dhe transferet | 453,000 | 490,725 | 486,808 | 478,580 | 478,413 |
| Investimet Kapitale | 4,237,000 | 5,751,105 | 5,502,536 | 3,886,479 | 4,030,006 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:
•Buxheti final në raport me buxhetin fillestar tek kategoria pagave dhe mëditjeve ishte rritur për 610,441€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së pagave dhe vlerës së koeficientëve të pagave. Shpenzimi në këtë kategori ishte 100% e buxhetit final;
• Buxheti final në raport me buxhetin fillestar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 22,596€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 99%. Realizimi i kësaj kategorie ishte ndikuar edhe nga pagesat përmes vendimeve gjyqësore të pagave jubilare në vlerë 257,229€;
• Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për shpenzime komunale ishte rritur për 967€, përderisa realizimi ishte 100% e buxhetit final;
• Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për subvencione dhe transfere ishte rritur për 37,725€, përderisa realizimi ishte në shkallën prej 99% e buxhetit final.; dhe
• Buxheti final në raport me buxhetin fillestar në kategorinë e investimeve kapitale ishte rritur për 1,514,105€, ndërsa realizimi ishte 96% e buxhetit për shkak se disa projekte kishin mbetur pa realizuar si rezultat i vendimeve gjyqësore. Realizimi i kësaj kategorie ishte ndikuar edhe nga pagesat përmes vendimeve gjyqësore të pagave jubilare në vlerë 1,974,035€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2025




Të hyrat e planifikuara për vitin 2025 ishin 1,496,509€, ndërsa janë realizuar 2,244,607€, apo 150% nga plani. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu, në vitin 2025 Komuna e Istogut ka përfituar të hyra nga gjobat në trafik dhe gjykatave në vlerë 397,963€ si dhe të hyrat nga Agjencioni i pyjeve në vlerë 6,334€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme pasi që të njëjtat i planifikon dhe realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa komunës i alokohen për shpenzime.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2025 Pranimet | 2024 Pranimet | 2023 Pranimet |
|---|---|---|---|---|---|
| **Totali i të hyrave** | **1,496,509** | **1,496,509** | **2,244,607** | **1,927,367** | **1,339,018** |
| Të hyrat tatimore | 598,363 | 598,363 | 725,139 | 492,113 | 589,605 |
| Të hyrat jo tatimore | 898,146 | 898,146 | 1,518,736 | 1,435,254 | 749,413 |
| Të hyrat tjera | 0 | 0 | 732 | | |

# 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare për vitin 2024 ka rezultuar me 10 rekomandime. Komuna kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen rekomandimet e dhëna. Deri ne fund të auditimit tonë, tri (3) rekomandime janë zbatuar dhe shtatë (7) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur ne Grafikun 2, me poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**




**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2024 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë që, pas përfundimit të afatit të caktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona t'i kthehet komunës, apo kontratat të vazhdohen bazuar në çmimet e tregut, sipas procedurave përkatëse për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. | Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 2. | Pasqyrat Financiare Vjetore | Kryetari duhet të sigurojë planifikime të mirëfillta buxhetore sipas natyrës së shpenzimeve, apo të bëhet ridestinimi i mjeteve, ashtu që shpenzimet të paguhen dhe regjistrohen nga buxheti i kategorive përkatëse, në përputhje me planin kontabël të thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF. | Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin.. | Nuk ka filluar zbatimi |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3. | Subvencionet dhe transferet | Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit, do të përfitojnë vetëm OJQ-të që i plotësojnë kriteret e rregullores për subvencionim, ashtu që mjetet të shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe të arrihet qëllimi i subvencionimit. | Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe kjo çështje nuk ka rezultuar në vitin 2025. | I zbatuar |
| 4. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit në aspektin teknik, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve, në mënyrë që punët të realizohen sipas planit. | Kjo çështje është zbatuar, nuk kemi hasur raste të tilla në vitin 2025. | I zbatuar |
| 5. | Investimet kapitale | Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë të dhënat e plota për menaxhimin e kontratave në modulin përkatës në sistemin e prokurimit publik dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse. | Raporti i monitorimit nuk ishte plotësuar sipas kërkesave. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 6. | Pasuritë | Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë. | Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 7. | Pasuritë | Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtarët e pasurive regjistrojnë pasuritë jo kapitale në regjistra kontabël, ashtu që pasuritë të raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar. Po ashtu, të gjitha pasuritë e mbajtura në regjistra duhet të jenë të mbështetura me dokumentacion dhe ekzistencë fizike, në mënyrë që të evitohet mundësia e humbjes apo keqpërdorimit të pasurisë. | Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 8. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë. | Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2025, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme për ta adresuar rekomandimin. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 9. | Obligimet e papaguara | Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave. | Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe kjo çështje nuk ka rezultuar në vitin 2025. | I zbatuar |
| 10. | Auditimi i Brendshëm | Kryetari duhet të sigurojë që NjAB dhe KA të plotësohet me staf të nevojshëm, sipas kërkesave ligjore. Po ashtu, duhet të sigurohet për realizimin e auditimeve të parapara me planin vjetor të auditimit të NjAB-së dhe funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit. | Komuna nuk ka arritur që ta funksionalizoj NJAB-in. | Nuk ka filluar zbatimi |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit

Hysen Boqolli, Udhëheqës i ekipit

Edon Kabashi, Anëtar i ekipit

Florim Maliqi, Anëtar i ekipit

Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit

# Shtojca I: Letër konfirmimi

Nr./Br. 01-016-13183 Nr. i faq/Br.str. 1
Data/Datum 27.04.2026
ISTOG • ISTOK

Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

LETËR E KONFIRMIMIT

01. Nr. 405/2026

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Istogut, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Ilir Ferati

Kryetar i Komunës së Istogut

Data: 27. 04. 2026, Istog,

# Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[6] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[7], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**
***Forma e opinionit***

**Opinioni i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

### Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

### Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

### *Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit*

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[6] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[7] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT - OPSTINA ISTOK
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË - DIREKCIJA UPRAVE
II
Nr./Br. 01-016-21154 Nr. i faq/Br.str /
Data/Datum 29.06.2026
ISTOG • ISTOK

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E ISTOGUT/ OPSTINA ISTOK/ MUNICIPALITY OF ISTOG

KRYETARI/PREDSEDNIK/MAYOR

---

# RAPORT

## I PUNËS SË KRYETARIT PËR PERIUDHËN

## JANAR- QERSHOR 2026

**PËRMBAJTJA:**

1. HYRJE
2. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE
3. DREJTORIA PËR INSPEKSION
4. DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA, EKONOMI DHE ZHVILLIM
5. DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI
6. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS
7. DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
8. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
9. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL
10. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI
11. DREJTORIA PËR PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE
12. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE EMERGJENCA MBROJTJE DHE SHPETIM
13. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

## *HYRJE*

Udhëheqësi i Komunës

Komuna, si njësi themelore e pushtetit lokal, funksionon në bazë të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/08), Statutit të Komunës si akti më i lartë i komunës, si dhe Ligjeve të tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fusha e veprimtarisë së saj. Me ligjin e përmendur janë përcaktuar struktura dhe organet e pushtetit lokal, ndërsa Komunave u është lënë hapësirë për formimin e drejtorive, respektivisht përcaktimin e numrit të tyre. Në këtë kontekst, si organet e Komunës në Ligjin për vetëqeverisjen lokale janë përcaktuar: Kryetari, si organi më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe Kuvendi Komunal, si organi më i lartë vendimmarrës.

Kryetari i Istogut, z. Ilir Ferati (LDK), është zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2025. Lidhja Demokratike e Kosovës mban 14 nga 27 ulëset në Asamblenë Komunale. Partia e dytë më e madhe, me 6 ulëse, është PDK, e përcjellur nga VV me 3 anëtarë të asamblesë, AAK me 3 anëtar dhe GIBI me një ulëse, dhe një asambleist i pavarur. Në kuadër të kuvendit janë themeluar dy komitete obligative: Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitete, Komiteti për barazi gjinore dhe komitete të tjera, siç parashihen me ligj. Komuna publikon procesverbalin dhe të gjitha aktet e miratuara nga takimi i Asamblesë në ueb-faqen komunale.

Komuna e Istogut është e organizuar në 13 drejtori dhe Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim, duke shtuar Zyrën e Kryetarit, përgjegjëse për obligimet horizontale të komunës.

## *KRYETARI I KOMUNËS*

Kryetari është organi më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët, i cili e përfaqëson komunën. Gjatë këtij viti, Kryetari i Komunës, në veçanti, krahas punëve dhe obligimeve të tjera, ka shqyrtuar dhe realizuar çështje të rëndësishme nga përgjegjësitë komunale duke:

- Realizuar projektet prioritare të përcaktuara nga viti i kaluar dhe ato të përcaktuara nga ky vit;
- Shqyrtuar kërkesat e ndryshme të qytetarëve;
- Organizuar dhe menaxhuar organet komunale të administratës dhe i ka kompletuar ato me profesionistë, duke angazhuar përkushtim të vazhdueshëm në organizimin dhe sistematizimin e

shërbimit civil, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtësuar për kryerjen e shërbimeve komunale;

- Hartuar dhe propozuar rregulloret dhe vendimet e ndryshme në fushën e kompetencave komunale, të cilat kanë kaluar nëpër Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin për miratim;
- Kryer detyrat dhe punët e tjera të rregullta, të përcaktuara nga fusha e veprimtarisë dhe kompetencat e tij.

Kryetari i Komunës në periudhën Janar-Qershor 2026 ka nënshkruar gjithsej 22 (njëzetë e dy) Memorandume Bashkëpunimi (MB), ndër to marrëveshje me Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal, MBPZHR-në, KFOR-in, Këshillin Evropian, Fondin Kosovar për Efikasitet të Energjisë, Organizata Joqeveritare (OJQ), etj. Në kuadër të Zyrës së Kryetarit funksionojnë edhe: Zyra e Integrimeve Evropiane, Zyra Ligjore, Zyra e Komunikimit dhe Informimit, Zyra e Menaxherit të Personelit, Avokati Publik dhe Auditori i Brendshëm. Në kuadër të Zyres së Integrimeve Evropiane dhe Zyres Ligjore hartohen planet operative për përmbushjen e prioriteteve për integrime evropiane, ofrohen këshillime dhe mendime profesionale juridike, ofrimi i ndihmës dhe hartimi i projekt-rregulloreve komunale, etj. Në kuadër të Zyres së Informimit në mënyrë të rregullt ofrohen informata për opinionin dhe mediat elektronike dhe ato të shkruara për të gjitha aktivitetet e Kryetarit, Drejtorateve, dhe punën në përgjithësi të organeve komunale të administratës, si dhe bëhet azhurnimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes së komunës.

Avokati publik, në pajtim me ligjet pozitive në fuqi, mbron interesat e Komunës pranë gjykatave kompetente.

Gjatë kësaj periudhe të qeverisjes, është bërë një punë e madhe në aspektet e propozimeve dhe realizimeve të projekteve kapitale të rëndësishme për komunën tonë. Janë identifikuar prioritetet e tjera, dhe është vazhduar me prioritete të cilat janë realizuar dhe do të paraqiten në vijim në kuadër të raportimeve të drejtorateve përkatëse. Krahas synimeve të cekura më lartë, Kryetari ka kryer edhe punë të tjera, duke përfshirë kontaktimin me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, përfaqësues të OSBE-së dhe KFOR-it dhe vizita të ndryshme të niveleve ndërkombëtare, qeveritare, komunale, që i ka bërë Kryetari dhe që i janë bërë komunës sonë në këtë periudh njëvjeçare.

## ZYRA E INTEGRIMEVE EVROPIANE

## RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHEN JANAR-QERSHOR 2026

Zyra për Integrime Evropiane (ZIE) nuk ka zyrtarin përgjegjës i cili kryen punët dhe obligimet në përputhjen me Rregulloren 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integrim Evropian. Zyrtarët vazhdimisht informohen për të siguruar se punët janë në përputhje me standardet evropiane si dhe hulumtojnë programe të ndryshme të asistencës së BE-së dhe donatorëve të tjerë për të ofruar mbështetje për qeverisje të mirë dhe zhvillim lokal.

### *SEKTORI LIGJOR*
### *RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026*

Ky raport paraqet aktivitetet dhe punët e realizuara nga Sektori Ligjor i Komunës së Istogut gjatë periudhës Janar–Qershor 2026. Gjatë kësaj periudhe, sektori ka ofruar mbështetje juridike për Kryetarin e Komunës, drejtoritë komunale dhe njësitë organizative, duke siguruar përgatitjen dhe shqyrtimin e akteve juridike, kontratave, autorizimeve, marrëveshjeve dhe dokumenteve të tjera ligjore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Puna e sektorit është zhvilluar me qëllim të garantimit të ligjshmërisë së vendimmarrjes, mbështetjes së administratës komunale dhe realizimit efikas të kompetencave të komunës.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar këto aktivitete:

| Nr. | Aktiviteti | Numri |
|---|---|---|
| 1 | Vendime të hartuara | 736 |
| 2 | Propozim-vendime | 4 |
| 3 | Kontrata të hartuara | 56 |
| 4 | Marrëveshje | 2 |
| 5 | Autorizime | 5 |
| 6 | Përpilim i Listës së pronarëve të Komunës | 1 |
| 7 | Kërkesë për AKP | 1 |
| 8 | Njoftime | 1 |
| 9 | Shkresë drejtuar MAPL-së | 1 |
| 10 | Kërkesë për DMZP | 1 |
| 11 | Letër konfirmim | 1 |
| 12 | Kontrata për subvencione | 15 |

| | | |
|---|---|---|
| 13 | Pakt Miqësie | 1 |

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Sektori Ligjor ka përgatitur dhe shqyrtuar një numër të konsiderueshëm vendimesh administrative, të cilat kanë shërbyer për funksionimin e rregullt të administratës komunale dhe zbatimin e kompetencave ligjore të Komunës së Istogut. Po ashtu janë hartuar kontrata dhe marrëveshje të ndryshme për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve komunale, janë përgatitur autorizime për ushtrimin e kompetencave administrative, si dhe janë trajtuar kërkesa dhe shkresa zyrtare drejtuar institucioneve qendrore.

Në kuadër të mbështetjes juridike janë përgatitur kontratat për subvencionet komunale, është hartuar dokumentacioni për Paktin e Miqësisë ndërmjet Komunës së Istogut dhe partnerëve ndërkombëtarë, si dhe janë përgatitur dokumente të tjera juridike sipas kërkesave të organeve komunale. Sektori ka ofruar gjithashtu interpretime ligjore, këshilla juridike dhe mbështetje profesionale për drejtoritë komunale, duke kontribuar në zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi dhe në rritjen e sigurisë juridike gjatë procesit të vendimmarrjes.

Gjatë periudhës Janar–Qershor 2026, Sektori Ligjor ka realizuar me përgjegjësi detyrat dhe kompetencat e tij, duke përmbushur obligimet ligjore dhe administrative në mbështetje të punës së Kryetarit të Komunës, Drejtorive Komunale dhe organeve të tjera të administratës.
Numri i madh i akteve juridike të hartuara dhe të shqyrtuara dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të sektorit në sigurimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative dhe funksionimit efikas të Komunës së Istogut.

## *ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM*
## *RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026*

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2026, Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun e cila funksion në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati, ka vazhduar me punën e saj të përditshme, duke pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha informacionet e duhura që kanë të bëjnë me punën dhe aktivitete e Komunës së Istogut.
Kjo zyrë ka lëshuar çdo ditë të punës komunikata nga më të ndryshme të cilat kanë pasqyruar punën e cila zhvillohet brenda institucionit të Komunës së Istogut.
Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun (ZIK), gjatë kësaj periudhe ka arritur të sigurojë shpërndarjen e rregullt, të saktë dhe në kohë të informacioneve që lidhen me aktivitetet e Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të drejtorive komunale. Pasqyrimi i drejtë dhe i paanshëm i ngjarjeve që zhvillohen për dhe nga Komuna e Istogut është përmbushur si mision themelor i zyrës për Komunikim me Publikun përmes përcjelljes dhe publikimit të plotë të veprimtarisë së organeve të administratës komunale, pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ.
Uebsajti i komunës sonë pavarësisht problemeve që janë paraqitur pas ridizajnimit të ueb faqes komunale nga ana e MAPL-së, çdo ditë është i freskët me plasimin e të gjitha lajmeve dhe ngjarjeve në komunën tonë, përfshirë këtu paralajmërimet e ngjarjeve, përcjelljen e ngjarjeve në komunë, por edhe jashtë komunës.
Në mënyrë që Komuna e Istogut të jetë sa më efikase dhe të ketë një transparencë sa më të madhe karshi shoqërisë civile, medias dhe faktorëve të tjerë relevantë, kemi bërë raportime të rregullta edhe mbledhjet e kuvendit, procesverbalet e kuvendit, po ashtu edhe procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, komitete këto që janë obligative për komunën si dhe është realizuar transmetimi live në YouTube i të gjitha mbledhjeve të Kuvendit Komunal.

Rregulloret e nxjerra nga Kuvendi i Komunës, të gjitha janë publikuar në ueb faqen e Komunës, por edhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Po ashtu vlen të theksohet se ne ueb faqe, bëhen publike vazhdimisht të gjitha njoftimet dhe konkurset, ndërkohë që aty pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e marra nga Kryetari i Komunës si dhe vendimet e drejtorive komunale. Është punuar mjaft shumë edhe në publikimin e të gjitha kontratave te Zyrës së Prokurimit, por edhe njoftimeve të ndryshme të po kësaj zyreje.
Përparësi e ueb faqes së Komunës së Istogut është edhe ajo se secili lajm, informacion, njoftim dhe konkurs bëhet përveç në gjuhën shqipe, edhe në atë të komunitetit pakicë serb.

Në ueb faqen tonë, qytetarët e interesuar, shoqëria civile dhe mediat po ashtu mund të gjejnë të publikuara edhe të gjitha pasqyrat financiare, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen dhe gjithçka tjetër që mund të jetë në interesin e tyre.

Në kuadër të Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtarja për Qasje në Dokumente Publike. Gjate periudhës Janar-Qershor kemi pasur nënte (8) kërkesë për qasje të cilat janë miratuar.
Po ashtu në zyrën për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtari për konsultime publike. Gjatë periudhës Janar – Qershor janë mbajtur një (1) Takime Publike të Kryetarit si dhe një (1) Dëgjim Buxhetor.

## *ZYRA E MENAXHERIT TË PERSONELIT*
## *RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026*

I. QËLLIMI I RAPORTIT
Ky raport përmbledh punën gjashtëmujore të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NMBNJ), duke reflektuar aktivitetet, sfidat, arritjet dhe rekomandimet për përmirësim në funksion të menaxhimit efikas të personelit komunal.

---

II. FUSHAT KRYESORE TË PUNËS
1. Menaxhimi i dokumentacionit personal të stafit
- Janë rifreskuar dhe sistemuar dosjet personale për të gjithë të punësuarit në përputhje me udhëzimet administrative.
- Janë përditësuar të dhënat në sistemin elektronik të menaxhimit të personelit (nëse ka).

2. Procedurat e rekrutimit dhe avancimeve
- Janë shpallur gjithsej 7 konkurse publike për vende të lira pune.
- Janë përmbyllur me sukses 5 procese rekrutimi, ndërsa 2 janë në fazën e intervistimit.
- Janë realizuar 8 procedura të Pensionimit.
- Nje pozitë e liruar me vullnetin e lire te zyrtarit .
- Ne total janë 936 zyrtarë të Punësuar.

3. Zhvillimi profesional i stafit
- Janë evidentuar nevojat për trajnim dhe janë dërguar 24 punonjës në trajnime të organizuara nga MAP/DAP, OSH-të apo ofrues tjerë të licencuar.
- Është hartuar plani vjetor për trajnime (i miratuar në shkurt 2025).

4. Zbatimi i legjislacionit për marrëdhënie pune

- Është zbatuar me përpikëri Ligji për Zyrtarët Publikë dhe rregulloret përkatëse për sistemimin dhe vlerësimin e performancës.
- Është hartuar rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe sistematizimin e Vëndeve të Punës në Administraten Komunale
- Janë shqyrtuar kërkesa të ndryshme si (transferime, pushime pa pagesë, ndërprerje të marrëdhënies pune, etj.).

5. Disiplina dhe etika në punë

- Janë iniciuar 2 procedura disiplinore për shkelje të lehta nga zyrtarët.
- Është ofruar asistencë ligjore dhe administrative për zbatimin korrekt të procedurave disiplinore.

6. Raportim dhe bashkëpunim ndërinstitucional

- Janë përgatitur dhe dërguar në afat të gjitha raportet periodike për MAP, DAP dhe auditorin e brendshëm/lokal.
- Është mbajtur komunikim dhe koordinim me zyrat e tjera brenda komunës për çështje të përbashkëta të personelit.

7. Udhëheqësit e Sektoreve

Në Administratë si stafë menaxhues (Udhëheqës) në institucionet e Komunës së Istogut janë 13 prej tyre 7 meshkuj dhe 6 femra.
Në DKA si stafë menaxhues (Udhëheqës) në institucionet e Komunës së Istogut janë 19 prej tyre 10 meshkuj dhe 9 femra.
Në DKSH si stafë menaxhues (Udhëheqës) në institucionet e Komunës së Istogut janë 5 prej tyre 3 meshkuj dhe 2 femra.
Në Drejtorinë për Kultur, Rini dhe Sport nuk ka asnjë Udhëheqës.
Numri i Pozitave Udhëheqëse në Komunitete nga gjinia mashkullore është 1, ndërsa nga gjinia femërore nuk ka.
Në Komunën e Istogut gjatë këtij gjashtë mujori të vitit 2025 kemi gjithësej 20 poste politike.

---

## III. SFIDAT E HASURA

- Mungesa e një sistemi të automatizuar për menaxhimin e të dhënave të personelit, që e zgjat procesin e përpunimit të të dhënave.
- Kapacitetet e kufizuara në staf, sidomos gjatë muajve të pushimeve dhe kur ka rritje të kërkesave për dokumente.

---

## IV. REKOMANDIME

- Të sigurohet një platformë elektronike funksionale për HR, e ndërlidhur me sistemet qendrore të MAP/DAP.
- Të rritet buxheti për zhvillimin e kapaciteteve të stafit dhe të përfshihet si zë i veçantë në buxhetin komunal.

• Të rishikohet struktura e njësisë për të mundësuar angazhimin e një numri të mjaftueshëm të zyrtarëve në kohë me fluks të lartë.

---

V. PLANIFIKIMI PËR GJASHTËMUJORIN E DYTË

- Finalizimi i sistemit për vlerësimin vjetor të performancës së të gjithë stafit.
- Riorganizimi i skedave të reja për vitin 2026.
- Planifikimi i trajnimeve të brendshme në bashkëpunim me zyrën për trajnime.
- Përgatitja e draft-strategjisë për zhvillimin e burimeve njerëzore në institucion.

## *DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE*
## *RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026*

Drejtoria për Administratë Komunale është drejtoria më e madhe, në kuadër të organeve komunale të administratës, dhe me qëllim të realizimit sa më me sukses të përgjegjësive, në fillim është hartuar plani i punës në të cilin janë paraqitur synimet që do të përmbushën në këtë periudhë.

Administrata komunale është një segment i rëndësishëm i komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal. Gjatë kësaj periudhe kemi bërë përpjekje që administrata të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, përkatësisht që qytetarët si në aspektin kohor gjithashtu edhe në aspektin cilësor t'i realizojnë të drejtat e tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Në këtë drejtim veprimtaria kryesisht ka qenë e orientuar në realizimin e synimeve programore, respektimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe akteve tjera të përgjithshme juridike si parakushte këto për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, në interes të përmbushjes se kërkesave të përgjithshme dhe individuale të qytetarëve pa dallim përkatësie nacionale, fetare, gjinore dhe racore. Orientimet e tilla sipas planit strategjik të punës dukshëm kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë në punë, disiplinës në punë, avancimit të metodës së punës dhe efikasitetit në punë. Në kontekst të kryerjes së shërbimeve deri tani nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga qytetarët tanë, që do të thotë se sipas vlerësimit të përgjithshëm administrata i përmbushë obligimet e saja në mënyrë korrekte dhe cilësore.

Drejtoria për Administratë Komunale është e ndarë në:

1. Sektori i gjendjes civile me zyrat e vendit;
2. Sektori për administratë;
3. Qendra për shërbim të qytetarëve;
4. Arkivi komunal;
5. Zyra e prokurimit publik dhe
6. Sektori për të drejtat e njeriut dhe komunitete

Sektori i Gjendjes Civile

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase, profesionale ndaj qytetarëve Sektori i Gjendjes Civile është i organizuar sipas zyreve të gjendjes civile të bashkësive lokale si Zyra e Gjendjes Civile në Gjurakoc e cila i ofron edhe shërbimet e gjendjes civile të Dobrushës, Zyra e Gjendjes Civile në Banjë kurse në Zyrën e Gjendjes Civile në Istog janë të përfshira Zyra e Gjendjes Civile Rakosh dhe Vrellë.

Qytetarët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre në rregullimin e dokumenteve personale të gjendjes civile. Tani edhe me anë të e-Kioskave ofrohen shërbime 24 orë e cila është mundësi e mirë sidomos për njerëzit e punësuar të cilët mund t'i kryejnë shërbimet e tyre edhe gjatë ditëve të festave si dhe në fundjavë. Këto e-kioske janë të vendosura në: Istog, Gjurakoc, Vrellë, Banjë dhe Rakosh.

Shërbimi i Gjendjes Civile si shërbim në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale kryen shërbime të ndryshme si: bën regjistrimin e lindjeve brenda dhe jashtë vendit në librat amë të të lindurve, lidhjen dhe regjistrimin e martesave në librin amzë të martesave, regjistrimin e vdekjeve brenda dhe jashtë vendit, nxjerrjen e certifikatat e ndryshme të gjendjes civile, përfshirë, të lindjes, ekstraktin nga regjistri qendror i gjendjes civile, certifikatën e shtetësisë, të martesës, të vdekjes, të vendbanimit, të gjendjes martesore, të bashkësisë familjare, certifikatën e vdekjes, kurorëzimit, ç 'lajmërimin e vendbanimit dhe regjistrimin e adresës së re të vendbanimit, pranim e kërkesës me dokumentacionin përcjellës për parashtrimit për fitimin e shtetësisë së Kosovës dhe dorëzimin e tyre për në Departamentin për Shtetësi në Prishtinë, pranimin e kërkesave të ndryshme në kuadër të përgjegjësisë së shërbimit të gjendjes civile.

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2026 janë pranuar 119 kërkesa dhe janë lëshuar 20955 certifikata të ndryshme të gjendjes civile për përdorim brenda dhe jashtë vendit e të cilat më poshtë janë paraqitur në mënyrë tabelare.

Për periudhën janar-qershor të vitit 2026 përveç dokumenteve-certifikatave të lartcekura, janë parashtruar edhe 119 kërkesa të ndryshme të cilat janë si në vijim:

- Ndërrim i emrit personal (emër, mbiemër) – 16
- Regjistrim i mëvonshëm i vdekjes – 48
- Regjistrim i mëvonshëm i vdekjes pa lindje – 9
- Ndërrim i emrit personal për fëmijë – 4
- Regjistrim i mëvonshëm i lindjes – 3

- Vërtetim të kartonit të letërnjoftimit të ish RSFJ-së dhe pasaportës – 22
- Anulim i aktit të martesës (zyrtare) – 2
- Korrigjim në dokumente të arkivuara të emrit personal të të dhënave të prindit – 4
- Kërkesë për regjistrim të rregullt të vdekjes jashtë vendit – 1
- Anulim i regjistrit të veçantë të lindjes (zyrtare) – 1
- Korrigjim i aktit të lindjes (zyrtare) – 2
- Regjistrim i mëvonshëm i vdekjes jashtë vendit – 2
- Korrigjim i aktit të vdekjes (zyrtare) – 2
- Korrigjim i datës së lindjes – 1
- Korrigjim i emrit personal – 1
- Pezullim i dokumenteve të aplikimit për shtetësi – 1

Dokumentet e gjendjes civile të lëshuara për periudhën: 01.01.2026 deri më 30.06.2026:

i. Sektori për administratë

Në kuadër të këtij sektori janë: udhëheqësi i sektorit, shërbimi i teknologjisë së informimit (2 IT), autoparku (2 shërbyes), zyrtari për logjistikë (1 shërbyes), shërbimi i përkthimit (2 shërbyes) dhe shërbimi për mirëmbajtje dhe pastrim të objektit të komunës (5 stafi administrativo mbështetës).

Gjatë periudhës janar-dhjetor të këtij viti, stafi kryesisht janë marr me realizimin e punëve: mirëmbajtja e rrjetit të internetit dhe intranetit, instalimi i programeve softuerike në kompjuterët e stafit civil, mirëmbajtja dhe riparimet softuerike të kompjuterëve të tërë stafit civil dhe politik të administratës komunale dhe punë të tjera të teknologjisë së informimit. Shërbimi i përkthyesve gjatë periudhës raportuese ka bërë përkthime të të gjitha shkresave, vendimeve, procesverbaleve, raporteve dhe dokumenteve të lëshuara nga zyra e kryetarit, drejtorit komunale, kuvendi, komitetet e tij dhe organet të tjera të themeluara nga kuvendi dhe Kryetarit. Në këtë periudhë raportuese janë përkthyer më shumë se 584 shkresa dhe dokumente të cekura. Po ashtu shërbimi i përkthimeve ka bërë përkthimin simulant dhe përkthime të drejtpërdrejta gjatë të gjitha mbledhjeve të kuvendit të komunës, dhe takimeve të ndryshme të organizuara nga Kryetari dhe komisioneve dhe komiteteve të themeluara nga kuvendi dhe Kryetari. Nga stafi i autoparkut është bërë furnizimi i rregullt i të gjitha automjeteve zyrtare me karburante dhe evidenca e shpenzimeve të tyre sipas drejtorive komunale, është bërë mirëmbajtja e automjeteve, duke u kujdesur që të gjitha automjetet të jenë në gjendje funksionale. Nga zyra e logjistikes është bërë, sipas kërkesës së stafit, furnizimi me material të nevojshëm për zyre dhe furnizim me material higjeniko-sanitar. Nga shërbimi i mirëmbajtjes, është bërë mirëmbajtja e objektit të komunës në aspektin e pastërtisë të të gjitha zyrave, nyjave sanitare dhe korridoreve, mënjanimi i defekteve dhe riparimi i prishjeve të dyerve, dritareve mobileve dhe karrigeve të stafit si dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore të objektit të komunës, duke përfshirë edhe furnizimin me lëndë djegëse.

Në kuadër të Drejtorisë, shqyrtohen kërkesa të ndryshme nga kuadri mi fushëveprimit të drejtorisë, duke përfshirë kërkesa për vijimin e stazhit të praktikës, si nga ata/ato që kanë përfunduar studimet, në të gjitha fakultete, si në ato private dhe publike dhe studentët të cilët ende i vijojnë studimet, po ashtu në të gjitha fakultetet, pa dallim, si ato private dhe publike. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë lëshuar: 8 vendime dhe 13 vërtetime të ndryshme nga përgjegjësia e drejtorisë, dhe 44 kërkesa dhe shkresa të ndryshme të komunikimit të brendshëm dhe komunikimit jashtë komunës.

*1. Menaxhimi dhe koordinimi i Sektorit për Shërbime të Përbashkëta*

- *Organizimi dhe koordinimi i punës së zyrtarëve të sektorit.*
- *Protokollimi i shkresave të Drejtoratit për Administratë.*
- *Shqyrtimi i kërkesave të cilat i janë drejtuar këtij drejtorati.*
- *Planifikimi dhe shpërndarja e detyrave sipas kompetencave dhe prioriteteve.*
- *Monitorimi i realizimit të detyrave dhe respektimit të afateve.*
- *Mbikëqyrja e punës së zyrtarëve për përkthim, logjistikë, teknologji informative (IT), menaxhim të veturave zyrtare, mirëmbajtje të objektit dhe stafit të pastrimit.*
- *Bashkëpunimi dhe koordinimi i vazhdueshëm me Drejtorinë për Administratë Komunale dhe drejtoritë e tjera komunale.*
- *Zgjidhja e çështjeve operative dhe administrative që kanë të bëjnë me funksionimin e sektorit.*
- *Sigurimi i funksionimit të pandërprerë të shërbimeve që ofron sektori për të gjitha njësitë organizative të Komunës.*

*2. Përkthimi i dokumenteve zyrtare*

*Zyrtarët për përkthim kanë realizuar përkthimin e dokumenteve dhe akteve zyrtare të përgatitura nga drejtoritë komunale, duke siguruar respektimin e legjislacionit për përdorimin e gjuhëve zyrtare.*
*Gjatë kësaj periudhe janë përkthyer:*

- *Vendime;*
- *Rregullore;*
- *Njoftime publike;*
- *Kontrata dhe marrëveshje;*
- *Dokumente administrative dhe materiale të tjera sipas kërkesave të drejtorive.*
- *Është ofruar përkthim simultan në mbledhjet e rregullta të Komiteteve Komunale, duke siguruar komunikim të barabartë në gjuhët zyrtare për të gjithë pjesëmarrësit.*
- *Është siguruar mbështetje gjuhësore për komunikim zyrtar.*

*Përkthimet janë realizuar brenda afateve të përcaktuara, duke siguruar cilësi dhe saktësi profesionale.*

*3. Logjistika*

*Në fushën e logjistikës janë realizuar aktivitetet në vijim:*

- *Është siguruar furnizimi i rregullt i drejtorive me material shpenzues dhe paisje pune.*
- *Evidentimi dhe administrimi i inventarit.*
- *Koordinimi i nevojave logjistike të njësive organizative.*
- *Kujdesi për shfrytëzimin racional të materialeve dhe pajisjeve komunale.*

*4. Teknologjia Informative (IT)*

*Gjatë periudhës raportuese janë realizuar:*

- *Mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike dhe pajisjeve përcjellëse.*
- *Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të reja.*
- *Ofrimi i mbështetjes teknike për të gjithë zyrtarët komunal.*

- *Mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik dhe pajisjeve të tjera teknologjike.*
- *Eliminimi i problemeve teknike dhe sigurimi i funksionimit të pandërprerë të sistemeve informatike.*

*5. Menaxhimi i veturave zyrtare*

*Gjatë periudhës janar – qershor 2026, zyrtari përgjegjës për menaxhimin e veturave zyrtare ka realizuar këto aktivitete:*

- *Administrimin dhe koordinimin e përdorimit të automjeteve zyrtare sipas kërkesave të drejtorive komunale.*
- *Mbajtjen e evidencave për shfrytëzimin e automjeteve, përfshirë kilometrat e përshkuara dhe konsumin e karburantit.*
- *Monitorimin e gjendjes teknike të automjeteve dhe koordinimin e servisimeve periodike, kontrollit teknik dhe regjistrimit të tyre.*
- *Bashkëpunimin me njësitë organizative për planifikimin dhe organizimin e transportit zyrtar.*

*6. Mirëmbajtja e objektit*

*Mirëmbajtësi i objektit ka realizuar:*

- *Kontrollin e vazhdueshëm të gjendjes së objektit komunal.*
- *Riparimet e nevojshme të inventarit dhe pajisjeve.*
- *Mirëmbajtjen e instalimeve elektrike, hidraulike dhe elementeve të tjera teknike sipas nevojës.*
- *Raportimin e dëmtimeve që kanë kërkuar ndërhyrje shtesë.*

*7. Shërbimet e pastrimit*

*Stafi i pastrimit ka siguruar:*

- *Pastrimin e përditshëm të zyrave dhe ambienteve të përbashkëta.*
- *Mirëmbajtjen e higjienës në hapësirat e administratës komunale.*
- *Furnizimin dhe përdorimin e materialeve higjienike sipas nevojës.*
- *Krijimin e një ambienti të pastër dhe të sigurt për punonjësit dhe qytetarët.*

*Po ashtu është bërë edhe arkivimi i dokumentacionit në formë fizike dhe elektronike përmes programit SMAED.*

*Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, konsiderojmë se Sektori për Shërbime të Përbashkëta ka përmbushur me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e tij, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për funksionimin e administratës komunale.*

*Edhe pse gjatë kësaj periudhe janë paraqitur sfida operative, falë bashkëpunimit të stafit dhe koordinimit të mirë të punëve, të gjitha detyrat janë realizuar me përgjegjësi dhe profesionalizëm gjithmonë duke lënë hapsirë për përmisim të ofrimit të shërbimeve.*

*Andaj në periudhën në vijim do të vazhdohet me angazhim për rritjen e efikasitetit, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet njësive organizative të Komunës.*

## ii. Arkivi komunal

| Institucioni | Departamenti | Numri i lëndeve të arkivuara | Numri i lëndeve të asgjësuara | Numri i dokumenteve |
|---|---|---|---|---|
| Komuna Istog | Drejtoria për Administratë dhe Personel | 196 | 0 | 263 |
| | Drejtoria për Administratë dhe Personel-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | Drejtoria për Arsim | 235 | 0 | 437 |
| | Drejtoria për Arsim Kulturdhe Shkencë-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural | 6 | 0 | 10 |
| | Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 61 | 0 | 60 |
| | Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim | 113 | 0 | 119 |
| | Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | Drejtoria për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë | 523 | 0 | 951 |
| | Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport | 0 | 0 | 0 |
| | Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis | 5 | 0 | 3 |
| | Drejtoria për Punë të Inspeksionit | 0 | 0 | 0 |
| | Drejtoria për Punë të Inspeksionit-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 165 | 0 | 328 |
| | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri | 221 | 0 | 443 |
| | Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | Drejtoria për Urbanizëm, Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | Kryetari i Komunes | 250 | 0 | 451 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Kryetari Komunes-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | Kuvendi Komunal | 0 | 0 | 0 |
| | Kuvendi Komunal-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | NUK EXISTON si DEPARTAMENT por ka Lende | 0 | 0 | 0 |
| | | 0 | 0 | 0 |
| | Zyra Lokale e Komuniteteve | 0 | 0 | 0 |
| | Zyra Lokale e Komuniteteve-joaktive | 0 | 0 | 0 |
| | Totali: | 1775 | 0 | 3065 |

| | |
|---|---|
| Protokollimi i shkresave | 43 |
| Shqyrtimi i kërkesave | 1 |
| Përkthimi i dokumenteve zyrtare | 160 |

iii. Qendra për shërbim të qytetarëve.

Raporti sipas departamenteve dhe statusit te zgjidhjes

04/01/2026 - 29/06/2026

| Shkurtesa | Pershkrimi | Pranuar | Ne Proces | Miratuar | Refuzuar | Hedhur Poshte | Pezulluar | Ceduar | Anuluar | Perfunduar | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| DAP | Drejtoria për | 12 | 316 | 913 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 14,755 | 16,00 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Administratë dhe Personel | | | | | | | | | | 0 |
| DBZHR | Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural | 0 | 6 | 36 | 8 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 51 |
| DEZH | Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim | 0 | 27 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 27 |
| DKRS | Drejtoria për Arsim | 3 | 478 | 1,403 | 43 | 0 | 0 | 0 | 39 | 0 | 1,966 |
| DPI | Drejtoria për Punë të Inspeksionit | 0 | 74 | 43 | 0 | 0 | 1 | 0 | 3 | 0 | 121 |
| DSHMS | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 0 | 286 | 366 | 3 | 0 | 0 | 0 | 5 | 0 | 660 |
| DSHPS | Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri | 0 | 113 | 201 | 6 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 323 |
| DGJKP | Drejtoria për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë | 0 | 31 | 1,271 | 3 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1,306 |
| KK | Kryetari i Komunes | 0 | 207 | 68 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 278 |
| ZLK | Zyra Lokale e Komuniteteve | 0 | 2 | 9 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 11 |
| DPUM | Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis | 1 | 182 | 125 | 1 | 0 | 0 | 0 | 9 | 0 | 318 |
| DKRS | Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport | 0 | 2 | 23 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 31 |
| DBF | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 0 | 45 | 94 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 139 |
| | | 16 | 1,769 | 4,552 | 70 | 0 | 2 | 0 | 67 | 14,755 | 21,231 |

Nr. i Kerkesave per drejtori

04/01/2026 - 29/06/2026

| Nr. | Pershkrimi | Nr. Kerkesave | Perqindja |
|---|---|---|---|
| 1 | Drejtoria për Administratë dhe Personel | 16,002 | 75.00 |
| 2 | Drejtoria për Arsim | 1,966 | 9.00 |
| 3 | Drejtoria për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë | 1,306 | 6.00 |
| 4 | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 660 | 3.00 |
| 5 | Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri | 323 | 1.00 |
| 6 | Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis | 318 | 1.00 |
| 7 | Kryetari i Komunes | 278 | 1.00 |
| 8 | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | 139 | 0.00 |
| 9 | Drejtoria për Punë të Inspeksionit | 121 | 0.00 |
| 10 | Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural | 51 | 0.00 |
| 11 | Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport | 31 | 0.00 |
| 12 | Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim | 27 | 0.00 |
| 13 | Zyra Lokale e Komuniteteve | 11 | 0.00 |
| | | 21,233 | |

### iv. Zyra e Prokurimit

*Ju njoftojmë për procedurat e zhvilluara të cilat janë të procesuara nga zyra e prokurimit: për të gjitha vlerat dhe llojet e procedurave për periudhën 01.01.2026 deri me 08.07.2026. Në këtë raport përfshihen: Njoftimet për kontratë, Njoftimet për dhënie të kontratës, Njoftimet për nënshkrim të kontratës, Kërkesat për rishqyrtim në AK dhe Ankesat ne OSHP.*

*Zyra e Prokurimit në Komunën e Istogut ka vazhduar të operojë në përputhje me ligjet dhe rregulloret vendore për administratën publike.*

*Prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve sipas nevojave nga njësitë - drejtoritë e ndryshme të komunës bazuar në Planifikimin e prokurimit për vitin 2026.*

| Lloji i njoftimit të publikuar | Numri i publikimeve |
|---|---|
| Njoftim për kontratë | 35 |
| Njoftim për dhënie të kontratës | 13 |
| Njoftim për nënshkrim të kontratës | 12 |
| Kërkesa për rishqyrtim në AK | 8 |
| Ankesa në OSHP | 3 |
| Aktivitetet e publikiara ne LOT-e | 6 |

*Nga 35 Njoftimet për kontratë të publikuara, 6 Njoftime për kontratë janë të publikuara me pjesë (lote), 35 Njoftimet për kontratë përmbajnë 88 aktivitete të prokurimit. Nga keto aktivitete të prokurimit të cilat janë furnizime, shërbime dhe punë të ndryshme si: vlerë e madhe, vlerë e mesme, vlerë e vogel dhe vlerë minimale në total numri i kontratave të nënshkruara për periudhen Janar – Qershor 2026 është 12 (përfshirë këtu disa kontrata në LOT-e).*

*Ky raport përfshinë një pasqyrë të qartë dhe të përgjegjshme të performancës së Zyrës së Prokurimit në Komunën e Istogut gjatë periudhës 01.01.2026 deri me 07.07.2026. Të gjitha proceset e prokurimit janë proceduar duke u bazuar në Ligjet dhe rregulloret vendore dhe qëndrore të prokurimit publik, duke siguruar transparencë dhe drejtësi në zgjedhjen operatorëve të kontraktuar.*

*Zyra e Prokurimit angazhohet për vazhdimin e përmirësimit të proceseve dhe për të përmbushur nevojat e përdoruesve të tij brenda standardeve të larta të qeverisjes dhe përgjegjshmërisë administrative.*

## v. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është mekanizëm komunal përgjegjës për promovimin, mbrojtjen dhe monitorimin e respektimit e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në nivel lokal . Ky sektor e vepron në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale.

Misioni i sektorit është avancimi i respektimit e të drejtave të njeriut, promovimi i barazisë dhe mos diskriminimit, mbrojtje e të drejtave të komuniteteve, fëmijëve, grave dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit dhe politikave që garantojnë këto të drejta. Gjithashtu, sektori kontribuon në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre përmes aktiviteteve informuese dhe vetëdijesuese.

Struktura e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete :

1. Udhëheqësja e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete;
2. Zyrtarja për Barazi Gjinore e caktuar edhe në detyrat: Zyrtare për Mbrojtje nga Diskriminimi;
3. Zyrtarja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim.

Për vitin 2026, për realizimin e aktiviteteve sektorit është planifikuar buxhet në vlerë prej 8,000 euro në kategorinë subvencione dhe transfere. Këto mjete janë destinuar për organizmin dhe mbështetjen e aktiviteteve vetëdijesuese, tryezave të diskutimit, fushatave informuese dhe aktivitete të tjera që lidhen me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Në pajtim me Rregulloren e Ministrisë së Financave, Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik, të OJQ-ve, gjatë periudhës raportuese janë mbështetur organizata të shoqërisë civile për realizimin e aktiviteve që lidhen më të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2026, nga programi buxhetor për barazi gjinore janë mbështetur këto OJQ: Qendra për Mirëqenie të Gruas, me vlerë 500 euro, për shënimin e 8 Marsit ‘’Ditës Ndërkombëtare të Gruas’’(Vendimi i Kryetarit të Komunës 01Nr.334/2026; datë 02.04.2026);

Shoqata‘’Handikos’’, me vlerë 500 euro, për shënimin e 21 Marsit ’’Dita Ndërkombëtare e Personave me Sindromën Down’’ (Vendimi i Kryetarit të Komunës 01Nr.239/2026; datë 13.03.2026) dhe OJQ ‘’Vision 02’’, me vlerë 500 euro, për shënimin e 24 Qershorit ‘’Dita e Egjiptianëve’’(Vendimi i Kryetarit të Komunës 01Nr.379/2026; Data 20.04.2026).

Në periudhën Janar-Qershor 2026 janë mbajtur këto tryeza/aktivitete të parapara me planin e punës së Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete:

Shënimi i 8 Marsit ‘’Dita Ndërkombëtare e Gruas’’

Tryezë diskutimi në bashkëpunim me OJQ ’’Qendren për Mirëqenien e Gruas’’, më rastin e shënimit të 8 Marsit ‘’Dita Ndërkombëtare e Gruas’’. Tema kryesore e kësaj tryeze ishte ’’Sfidat, vështirësitë dhe të arriturat e grave’’. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi lidhur më sfidat që kanë gratë, diskriminimi gjinor, mungesa e perfaqësimit si dhe fuqizimi i rolit të gruas në të ardhmen. Në këtë takim u prezentuan këto të dhëna për komunën tonë sa i perket përfaqësimit gjinor për vitin 2025:

Gratë e punësuara në institucione/administratën komunale

1. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucionet komunale është 1054

2. Numri i përgjithshëm i grave të punësuara në institucionet komunale është 590

Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive

1.Numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë udhëheqës në institucionet komunale të arsimit shëndetësisë kulturës dhe sportit është 37

2.Numri i zyrtarëve të lartë udhëheqës nga gjinia femërore është 16

Gratë e emëruara në pozita politike në komunë

1.Numri i përgjithshëm i grave të emëruara në poste politike në komunë është 5

2.Numri i përgjithshëm i zyrtarëve të emëruar në postet politike në komunë 20

Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale

1.Përqindja e grave në Komitetin Politikë dhe Financa është 45%

2.Përqindja e grave në Komitetin për Komunitete 45%

3.Përqindja e grave në komitetet tjera (Komiteti për Barazi Gjinore) 90%

4.Përqindja e grave në komisione të kuvendit komunal (komision për koordinimin e këshillave lokale komisione të aksionarëve të ndërmarrjeve publike etj) 45%

Barazia gjinore në përfitime të programeve dhe aktiviteteve të komunës

1.Buxheti total i ndarë për skema të punësimit dhe ndërmarrësisë subvencionet në bujqësi dhe zhvillim ekonomik është 19,559.86 euro

2.Buxheti i ndarë për skema të punësimit dhe ndërmarrësisë për gra dhe vajza subvencionet në bujqësi dhe zhvillim ekonomik 11,000.55 euro

3.Numri i përfituesve të përgjithshëm është 801

4.Numri i grave përfituese është 392

5.Numri i grave përfituese nga komunitetet pakicë është 23

Pjesëmarrja e grave në konsultime publike

1.Numri i përgjithshëm i pjesëmarrëseve në konsultime publike është 267

2.Numri i përgjithshëm i grave dhe vajzave pjesëmarrëse në konsultime publike 57

Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve

1.Numri i rrugëve në komunë të emërtuar pas personave është 325

2.Numri i rrugëve të emertuar pas personave të gjinisë femërore është 3

Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive

1.Numri i pronave të regjistruara në komunë është 1690

2.Numri i pronave të regjistruara në emër të dy apo më shumë personave dhe me gjini të ndryshme 127

3.Numri i përgjithshëm i pronave në emër të grave si prona individuale 80

Pjesë e këtaj tryeze ishin: asambleistet e kuvendit të komunës, drejtoreshat e drejtorive përkatëse, udhëheqëset e sektorëve, perfaqësuese të OJQ-ve dhe zyrtare komunale.

Në fund të takimit u dhuran lule për nderë të festës së 8 Marsit.

Në tryezën e diskutimit ishin prezente 15 pjesëmarrëse.



Takimi i parë i Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog

Takimi i parë i Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog, është  organizuar nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete.

Gjatë këtij takimi u trajtuan pikat e rendit të ditës, ku u miratua procesverbali nga takimi i fundit i Asamblesë si dhe u prezantua Raportit Vjetor 2025 i Asamblesë Komunale të Fëmijëve, duke reflektuar aktivitetet, arritjet dhe angazhimin e vazhdueshëm të fëmijëve në përfaqësimin e interesave të tyre. Takimi shërbeu si një hap i rëndësishëm në forcimin e rolit të fëmijëve në vendimmarrje dhe në promovimin e të drejtave të tyre në nivel lokal, duke dëshmuar përkushtimin e Komunës së Istogut për mbështetjen dhe fuqizimin e zërit të tyre.

Në takim ishin gjithsej 24 përfaqësues/e nga Asambleja prej tyre 8 M dhe 16 F.





Takimi  i parë i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është mbajtur më qëllim të konstituimit të mbledhjes se parë të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës duke shënuar një hap të rëndësishëm në forcimin e mekanizmave lokalë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Gjatë kësaj mbledhje është miratuar procesverbali nga mbledhja e fundit e vitit 2025, si dhe është prezantuar Raporti Vjetor 2025 i Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës Istog (2024 - 2026).

Një ndër pikat kyçe të rendit të ditës ishte edhe njoftimi i anëtarëve të Ekipit me vendimin për rikonstituimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, me qëllim vazhdimin e angazhimit institucional dhe ndërsektorial në këtë fushë me rëndësi të veçantë si dhe u mor vendim për themelimin e Sekretariatit të Ekipit, i cili do të shërbejë si strukturë mbështetëse për koordinimin dhe zbatimin e aktiviteteve.

Në fokus të diskutimeve ishte edhe organizimi i aktiviteteve të parapara në Planin e Punës 2024–2026, me synim avancimin e mirëqenies dhe të drejtave të fëmijëve në komunën tonë.

Në takim ishin prezentë gjithsej 10 pjesëmarrës/e prej tyre 4 M dhe 6 F.



Fushatë vetëdijesuese lidhur me temën '' E drejta në pronë dhe trashëgimi'' dhe ''Legalizimi i pronës''.

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete bazuar në Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026, në bashkëpunim me ORGANIKA në kuadër të projektit PIAKOS, të mbështetur nga Banka Botërore dhe i zbatuar në partneritet me ATRC organizoi dhe mbajti dy takime një muajin mars dhe prill më qellim të diskutimit, informimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve, veçantë grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë, regjistrimin dhe legalizimin e pronës. Vlen të theksohet se të gjitha shpenzimet për procedurat e regjistrimit të pronës mbulohen nga projekti dhe pjesëmarrësit në këto takime nuk kanë asnjë detyrim financiar.
Diskutime dhe pyetje lidhur më temën pati nga shumica e grave që ishin prezente.

Në takime ishin prezentë gjithsej 51 pjesëmarrës/e prej tyre 4M dhe 47 F.






12 Prill “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në Situatë Rruge”

Me rastin e shënimit të 12 – Prillit, “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në Situatë Rruge” nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale në SHFMU “Hysni Zajmi ” në Vrellë, është mbajtur një ligjëratë informuese më nxënës të klasave VI dhe VII.

Qëllimi i ligjëratës ishte informimi i nxënësve për parandalimin e dukurisë negative të kërkim-lëmoshës nga fëmijët si dhe shkaqet dhe pasojat që krijon dhënia e lëmoshës, me theks të veçantë tek fëmijët në situatë rruge.

Në ligjëratë informuese ishin prezentë 31 nxënës/e prej tyre 12 M dhe 19 F.





Rekomandime të dala nga ligjërata informuese me nxënës:

- Vetëdijesimi më i madh i fëmijëve dhe qytetarëve në përgjithësi për dukurinë negative të kërkim-lëmoshës, e cila po stimulon edhe me shumë që fëmijët të vazhdojnë të dëmtojnë të ardhmen dhe të mos i gëzojnë të drejtat e tyre ashtu si gjithë fëmijët tjerë;

- Raportimi i rasteve të fëmijëve në situatë rrugë në institucionin e Qendrës për Punë Sociale dhe Polici.

Panairi i Grave Fermere në Istog

Në bashkëpunim me FAO dhe UN Women, në kuadër të projektit të financuar nga Austrian Development Agency, u organizua Panairi i Grave Fermere në Istog. Në këtë aktivitet u prezantuan produkte të ndryshme vendore, gatime tradicionale, punime artizanale dhe veshje kombëtare, duke dëshmuar punën, kreativitetin dhe përkushtimin e grave fermere të komunës sonë. Të pranishëm në panair ishin edhe përfaqësues të komunës, të cilët vlerësuan rëndësinë e mbështetjes së grave në sektorin e bujqësisë dhe fuqizimin e tyre ekonomik. Ky panair shënoi përmbylljen e suksesshme të projektit, i cili përfshiu trajnime, nënshkrim kontratash dhe shpërndarje të pajisjeve bujqësore për përfitueset.



15 Maji "Dita Ndërkombëtare e Familjes"

Në kuadër të shënimit të 15 Majit – Ditës Ndërkombëtare të Familjes, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete, në bashkëpunim me Drejtorinë për Mirëqenie Sociale, ka realizuar vizitë tek familjet strehuese në komunën e Istogut.

Kjo vizitë kishte për qëllim vlerësimin dhe mbështetjen e rolit të jashtëzakonshëm që këto familje luajnë në kujdesin dhe mirëqenien e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, si dhe atyre që kanë përjetuar keqtrajtim apo neglizhencë. Gjatë vizitës, u diskutua për përvojat, sfidat dhe përkushtimin e familjeve strehuese, të cilat ofrojnë një ambient të sigurt, të dashur dhe mbështetës për fëmijët.

Në këtë vizitë u theksua së Komuna do të vazhdoj më subvencionimin e familjeve strehuese dhe ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për ta, duke synuar gjithmonë mbrojtjen dhe mirëqenien e çdo fëmijë.





5. Rekomandime / Kërkesa

Nga diskutimet me familjet strehuese dolën këto rekomandime dhe kërkesa:

- Rritja e mbështetjes institucionale për familjet strehuese;
- Ofrimi i aktiviteteve mbështetëse për fëmijët dhe familjet;
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve relevante dhe familjeve strehuese;

Takimi përmbyllës i Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog

Me rastin e shënimit të 1 Qershorit – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete - Drejtoria për Administratë Komunale, në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim dhe Ekipin për të Drejtat e Fëmijës, mbajti një takim përmbyllës me përfaqësuesit e Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog me rastin e përfundimit të mandatit të tyre dyvjeçar 2024-2026.

Në fund të takimit nga Znj. Merita Bytyçi - Zëvendëse kryesuese e Ekipit dhe Znj. Vlora Gjoci - Zyrtare për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim dhe anëtare e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës përfaqësueseve nga Asambleja Komunale e Fëmijëve në Istog iu ndanë MIRËNJOHJE për angazhimin, përkushtimin dhe kontributin e dhënë duke përfaqësuar me përgjegjësi zërin e fëmijëve, si dhe duke dhënë ide, mendime dhe iniciativa në funksion të përmirësimit të komunitetit gjatë mandatit të tyre për periudhën 2024 - 2026.

Në takim ishin gjithsej 24 përfaqësues/e nga Asambleja prej tyre 7 M dhe 17 F.



Shënimi i 24 Qershorit-Ditës së Egjiptianëve

Me rastin e 24 Qershorit-Ditës së Egjiptianëve, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në Komunën e Istogut, në bashkëpunim me OJQ-në ‘’Vision02’’, në Gjurakoc, organizoi aktivitet me moton: ’’Të prezantojmë identitetin, historinë dhe kulturën e komunitetit egjiptian’’. Në kuadër të këtij aktiviteti u prezantua një program kulturor-artistik gjithëpërfshirës, përmes të cilit u promovuan vlerat, traditat, historia dhe trashëgimia kulturore e komunitetit egjiptian. Në kwtw ditë përfaqësuesit e komunitetit kërkuan më shumë mbështetje ne arsim, punësim dhe shëndetësi. Gjithashtu, në shenjë vlerësimi për angazhimin dhe kontributin dhe bashkëpunimin, u ndanë mirënjohje për disa pjesëmarrës.





Udhëheqësja e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është caktuar zyrtare raportuese për performancën komunale në fushën e përfaqësimit gjinor. Gjithashtu sipas autorizimit të Drejtorit të Drejtorisë për Administratë Komunale , ushtron edhe detyrat administrative lidhur me menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit të programit buxhetor të Drejtorisë për Administratë Komunale.

Zyrtarja për Barazi Gjinore është anëtare e Mekanizmit Komunal Koordinues Kundër Dhunës në Familje, anëtare e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe anëtare e Këshilli Komunal për Personat e Riatdhesuar dhe anëtare e Këshillit Lokal për Moshat e Treta.

Gjatë periudhës Janar- Qershor 2026, Këshillit Komunal për Personat e Riatdhesuar ka mbajtur një takim të rregullt pune ndërsa Mekanizmi Komunal Koordinues Kundër Dhunës në Familje ka zhvilluar dy takime koordinues për trajtimin e çështjeve në kuadër të mandatit të tij. Këshilli për Mosha të Treta ka mbajtur dy takime.

Zyrtarja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Rintegrim është anëtare e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe në kuadër të këtij ekipi kryen punët tekniko dhe administrative. Gjatë periudhës raportuese, Ekipi për të

Drejtat e Fëmijës ka mbajtur dy takime pune për shqyrtimin e aktiviteteve dhe çështjeve që lidhen me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Po ashtu, Asambleja Komunale e Fëmijëve në Istog ka mbajtur dy takime gjatë periudhës Janar-Qershor 2026, ku janë diskutuar çështje me interes për fëmijët dhe të rinjtë e komunës.

Gjatë periudhës raportuese, stafi i sektorit ka monitoruar mbledhjet e Kuvendit Komunal, komiteteve obligative dhe trupave të tjerë komunalë, si dhe ka marrë pjesë në dëgjime publike , takime me qytetarë, trajnime, punëtori dhe tryeza të ndryshme të organizuara në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, mbrojtjes nga diskriminimi dhe përfshirjes sociale.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2026, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete ka realizuar aktivitetet e planifikuara në funksion të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtat e njeriut, barazisë gjinore, mbrojtjes së fëmijëve, të drejtat e komuniteteve dhe grupeve të cenueshme. Përmes bashkëpunimit me institucione komunale, organizatat e shoqërisë civile dhe mekanizmat lokalë, sektori ka kontribuar në avancimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe vetëdijes së qytetarëve të Komunës së Istogut.

## *DREJTORIA PËR INSPEKSION*
## *RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026*

Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Istogut, gjatë periudhës Janar–Qershor 2026, ka ushtruar kompetencat e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke u angazhuar në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e interesit publik dhe ofrimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të rregullt për qytetarët.

Aktivitetet e Drejtorisë janë realizuar përmes sektorëve përkatës:

1. Sektorit të Ndërtimit,
2. Sektorit të Mjedisit,
3. Sektorit Veterinar,
4. Sektorit të Transportit Rrugor dhe
5. Sektorit të Tregut ( i cili momentalisht sipas ligjit po kalon ne kopetenc te Ministris së Tregtis).

1. Sektorit të Ndërtimit,

Punët e Inspektorit te Ndertimit për periudhën raportuese janë zhvilluar në bazë të planit të punës janar-qershor 2026 të Zyrës së Inspeksionit dhe planit operacionale të hartuar nga bartësi i pozitës.
Aktiviteti inspektues ka qenë i fokusuar dhe i mbështetur ne bazë te kompetencave te akteve ligjore ne fuqi për pozitën e punës se lartëshënuar dhe ka qen i fokusuar ne :

- Inspektime për mbikëqyrje te zbatimit te dispozitave te" Ligjit për Ndertim"

Aktiviteti kryesor i Inspektorit të Ndërtimit ishte parandalimi i ndërtimeve jolegale,kontrollimi,evidentimi,inqizimi dhe ndërrmarrja e hapave konkret si në parandalim ashtu edhe në ndekjen e procedurave ligjore për objektet e ndërtuara si në pronë private ashtu edhe në pronë publike.

Aktiviteti i shtuar i Inspektorit të ndërtimit ka rezultuar me ndaljen e ndërtimeve pa leje, me theks të veqant në pjesët urbane të qytetit. Këto masa të inspektorit kanë ndikuar që të shtohen kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim të objekteve banesore dhe afariste.

Ku gjatë ketyre inspektimeve në teren nga ana e inspektorit të ndërtimit në katër qendrat urbane Istog, Gurakoc, Banjë dhe Vrellë janë bërë 63 inspektime dhe -- riinspektime , 36 procesverbale , 9 aktvendime .

Me aktvendim u është nderëprër puna 9 objekteve të ndertimit dhe atë:

- Istog...........7
- Bellopoj.......1
- Kashicë........1

Kemi pranuar 63 kerkesa nga qytetaret, prej të cilave :

- miratura.............. 51
- Pezulluar............ 1
- në proces............. 11
- gjoba mandatare...2

Ku në keto kerkesa perfshihen edhe kerkesat nga investitoret dhe punkryesit e punimeve të objekteve për të berë inspektimin dhe protokollin mbi përfundimin e të gjitha fazave gjatë ndertimit siq parashihet me ligj të ndertimit.
Po ashtu me 1 kërkesa u jam drejtuar Drejtoratit për Gjeodezi dhe Kadastere për dalje të gjeodetëve në terën për të bërë inqizimin e parcelave .

Ky sektor do të vazhdojë edhe në periudhën vijuse me realizimin e inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme, trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve si dhe ndermarrjen e masave ligjore më qëllim të garantimit të zbatimit të ligjit dhe ruajtjes së rendit ndërtimor në territorin e Komunës së Istogut.

## 2. Sektorit të Mjedisit

Ky raport gjashtëmujor paraqet aktivitetet dhe rezultatet e punës së Inspektoratit për Mbrojtjen e Mjedisit për periudhen Janar-Qershor 2026, në përputhje me kompetencat ligjore dhe detyrat institucionale.

2.1 Aktivitetet Inspektuese (Procesverbalet)

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar gjithsej 29 procesverbale, të ndara sipas fushave si më poshtë:

| Nr. | Lloji i Inspektimit | Numri i Inspektimeve |
|---|---|---|
| 1 | Menaxhimi i Mbeturinave | 14 |
| 2 | Ndotje e Lumenjve | 1 |
| 3 | Ndotje Fekale | 9 |
| 4 | Degradim Mjedisor | 3 |
| 5 | Bllokim kanali te ujitjes (delegim kompetence) | 1 |
| 6 | Inspektim per LMK | 1 |
| 7 | Gjithsej | 29 |

2.2 Masat Ndëshkuese

Si rezultat i aktiviteteve inspektuese të zhvilluara gjatë periudhës raportuese, në rastet kur janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit, janë ndërmarrë masat përkatëse ligjore. Janë shqiptuar gjithsej 6 gjoba ndaj subjekteve/personave përgjegjës për mosrespektim të kërkesave ligjore dhe detyrimeve mjedisore.

| Nr. | Lloji i Masës Administrative | Numëri |
|---|---|---|
| 1. | Gjoba të shqiptuara | 6 |

2.3 Ankesat e Qytetarëve

Gjatë këtij gjashtëmujori janë pranuar 10 ankesa/kërkesa nga qytetarët në lidhje me problemet qe lidhen me ndotjen e mjedisit. Prej tyre 5 janë miratuar, ndërsa 5 janë në proces. Gjithashtu,gjatë këtij gjashtëmujori janë shqyrtuar dhe 2 ankesa/kërkesa të muajit dhjetor të vitit 2025. Këto ankesa/kërkesa janë shqyrtuar paraprakisht dhe qytëtaret kanë marrë përgjigje.

| Nr. | Kërkesa / Ankesa | Numri |
|---|---|---|
| 1 | Miratuara | 5 ; +2 ( te vitit 2025) |
| 2 | Në Proces | 5 |
| Gjithsej | | 12 |

2.4 Bashkëpunim me institucione tjera

Gjatë periudhës raportuese është bashkëpunuar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera kompetente. Për rastet që nuk kanë qenë në kompetencë të Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit ne nivel komune, është njoftuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit

Hapësinor për ndërmarrjen e inspektimeve dhe veprimeve të nevojshme, në përputhje me kompetencat e saj ligjore.

2.5 Aktivitetet Parandaluese dhe Vetëdijësuese

Gjatë kësaj periudhe, Drejtoria e Inspekcionit-Inspektorati për Mbrojtje të Mjedisit ka ndërmarrë aktivitete vetëdijësuese dhe parandaluese me qëllim përmirësimin e gjendjes mjedisore në territorin e komunës. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë vendosur tabela informuese në lokacione të ndryshme publike, me qëllim ndalimin e hedhjes së mbeturinave në vende të palejuara dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit.

Vendosja e tabelave është bërë në zona ku më parë janë evidentuar raste të hedhjes së mbeturinave, duke synuar parandalimin e përsëritjes së këtyre dukurive. Këto aktivitete kanë për qëllim: rritjen e vetëdijes qytetare për ruajtjen e mjedisit, parandalimin e ndotjes së hapësirave publike, përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve








Fig 1. Vendosja e tabelës informuese për ndalimin e hedhjes së mbeturinave

2.6 Vështirësitë e Hasura

Gjatë këtij gjashtëmujori të punës, Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit ka hasur disa sfida që ndikojnë në efektivitetin e punës: Identifikimi i personave përgjegjës për hedhjen e mbeturinave

Për shkak të mungesës së kamerave dhe sistemeve të tjera të mbikëqyrjes, është e vështirë të identifikohen personat që hedhin mbeturina në vende të palejuara.

Një tjeter sfidë është bashkëpunimi i qytetarëve në raportimin e ndotjes. Raportimet nga qytetarët janë të kufizuara dhe jo gjithmonë të detajuara, gjë që ndikon në shpejtësinë dhe saktësinë e ndërhyrjeve inspektuese.

Përmirësimi i vetëdijes qytetare. Ka nevojë për veprime më të shumta edukative dhe vetëdijësuese për të rritur bashkëpunimin e qytetarve në mbrojtjen e mjedisit. Këto vështirësi nuk pengojnë aktivitetin inspektues, por tregojnë nevojën për masa shtesë parandaluese,duke përfshirë: vendosjen e tabelave informuese, përfshirjen e qytetarëve në monitorim, dhe përdorimin e teknologjisë për mbikëqyrje.

3. Sektorit Veterinar,

Punët e Sektorit të Inspektimit Veterinar gjatë periudhës raportuese Janar–Qershor 2026 janë zhvilluar në përputhje me planin e punës së Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Istogut dhe planin operacional të hartuar nga bartësi i sektorit. Aktiviteti inspektues është ushtruar në bazë të kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, me fokus të veçantë në mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit të Veterinarisë.

Gjatë kësaj periudhe, aktiviteti kryesor i sektorit ka qenë parandalimi i therjeve ilegale, kontrollimi dhe evidentimi i therjeve në të gjitha thertoret që operojnë në territorin e Komunës së Istogut. Inspektimet janë

zhvilluar në mënyrë të rregullt dhe sipas nevojës edhe në teren, me qëllim të garantimit të sigurisë ushqimore, mbrojtjes së shëndetit publik dhe respektimit të standardeve veterinare.

Në kuadër të aktiviteteve të realizuara, janë inspektuar gjithsej 755 therje të kafshëve në thertoret e komunës. Gjatë kontrolleve janë hartuar 18 procesverbale zyrtare, në të cilat janë evidentuar të gjitha të dhënat relevante lidhur me therjet dhe llojet e kafshëve të trajtuara, përfshirë peshqit, derrat, qentë dhe gjedhin, sipas rasteve të evidentuara gjatë procedurave inspektuese.

Sektori ka kryer monitorim të vazhdueshëm të kushteve higjieno-sanitare dhe veterinare në objektet e kontrolluara, duke ofruar udhëzime dhe rekomandime për respektimin e dispozitave ligjore dhe standardeve profesionale. Gjithashtu, janë ndërmarrë veprime administrative në rastet kur janë konstatuar parregullsi, me qëllim të eliminimit të tyre dhe parandalimit të përsëritjes së shkeljeve.

Gjatë periudhës raportuese është evidentuar një rast i anulimit të therjes dhe asgjësimit të saj, në përputhje me procedurat dhe dispozitat ligjore në fuqi. Ky veprim është ndërmarrë për të mbrojtur shëndetin publik dhe për të siguruar që produktet me origjinë shtazore të jenë në përputhje me kriteret veterinare dhe sanitare.

Përmes angazhimit të vazhdueshëm të inspektorëve veterinarë, sektori ka kontribuar në forcimin e kontrollit veterinar, rritjen e nivelit të zbatimit të legjislacionit dhe mbrojtjen e interesit publik në territorin e Komunës së Istogut. Sektori do të vazhdojë edhe në periudhën vijuese me realizimin e inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme, trajtimin e rasteve të paraqitura nga qytetarët dhe bashkëpunimin me institucionet kompetente për garantimin e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

## 4. Sektorit të Transportit Rrugor

Punët e Sektorit të Inspektimit të Transportit Rrugor gjatë periudhës raportuese Janar–Qershor 2026 janë zhvilluar në përputhje me planin e punës së Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Istogut dhe planin operacional të hartuar nga bartësi i sektorit. Aktiviteti inspektues është ushtruar duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, veçanërisht në Ligjin Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor.

Gjatë kësaj periudhe, sektori ka realizuar inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme në të gjithë territorin e Komunës së Istogut, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor. Aktiviteti inspektues ka qenë i fokusuar në kontrollin e transportit publik të udhëtarëve, përfshirë transportin urban dhe periferik, transportin taksi, transportin e veçantë të udhëtarëve, si dhe transportin e mallrave.

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive të sektorit, janë kryer kontrolle të vazhdueshme ndaj operatorëve ekonomik dhe mjeteve që ushtrojnë veprimtari transportuese në territorin e komunës. Gjatë inspektimeve është verifikuar posedimi i dokumentacionit të nevojshëm, respektimi i kushteve të përcaktuara me ligj, si dhe zbatimi i rregullave që kanë të bëjnë me zhvillimin e sigurt dhe të rregullt të transportit rrugor.

Sektori ka trajtuar edhe ankesat dhe kërkesat e përcjella nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, të cilat janë shqyrtuar dhe realizuar në terren sipas kompetencave ligjore. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë

ndërmarrë veprime për largimin e pengesave të ndryshme në rrugë, me qëllim të mundësimit të qarkullimit të lirë dhe rritjes së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion.

Gjatë periudhës raportuese është zhvilluar bashkëpunim i vazhdueshëm me sektorët e tjerë të Drejtorisë së Inspeksionit, përkatësisht me Inspektoratin e Ndërtimit, Inspektoratin e Mjedisit, Inspektoratin Veterinar dhe Sanitar, si dhe me Inspektoratin e Tregut, në rastet që kanë kërkuar koordinim institucional dhe veprime të përbashkëta në terren. Ky bashkëpunim ka ndikuar në rritjen e efikasitetit të punës dhe në trajtimin më të shpejtë të rasteve të paraqitura nga qytetarët dhe institucionet komunale.

Përmes aktiviteteve të realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Sektori i Inspektimit të Transportit Rrugor ka kontribuar në forcimin e rendit dhe disiplinës në komunikacion, në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe në përmirësimin e sigurisë së transportit rrugor në territorin e Komunës së Istogut. Sektori do të vazhdojë edhe në periudhën vijuese me realizimin e kontrolleve të rregullta dhe të jashtëzakonshme, trajtimin e ankesave të qytetarëve dhe ndërmarrjen e masave administrative në përputhje me kompetencat ligjore.

## 5. Sektori I Tregut

Punët e Sektorit të Inspektimit të Tregut gjatë periudhës raportuese janar–qershor 2026 janë zhvilluar në përputhje me planin e punës së Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Istogut dhe me kompetencat që sektori ka ushtruar deri në transferimin e tyre tek autoriteti qendror. Aktiviteti inspektues është bazuar në legjislacionin në fuqi dhe ka pasur për qëllim mbikëqyrjen e ushtrimit të veprimtarive afariste, respektimin e kushteve ligjore dhe mbrojtjen e interesit publik.

Gjatë periudhës raportuese janë hartuar gjithsej 8 procesverbale inspektuese të natyrave të ndryshme. Prej tyre, 1 procesverbal është hartuar lidhur me verifikimin e plotësimit të kushteve higjieno-sanitare dhe kushteve minimale teknike për subjektet që kanë filluar ose kanë vazhduar ushtrimin e veprimtarisë afariste. Gjithashtu, është nxjerrë 1 aktvendim për plotësimin e këtyre kushteve dhe për dhënien e pëlqimit për ushtrimin e aktivitetit afarist.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë realizuar edhe 6 kontrolle të jashtëzakonshme, për të cilat janë hartuar procesverbale përkatëse. Këto kontrolle kanë pasur për qëllim verifikimin e respektimit të orarit të punës së subjekteve afariste, identifikimin e aktiviteteve që zhvilloheshin në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe kontrollimin e ushtrimit të veprimtarive pa regjistrim në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK). Si rezultat i këtyre inspektimeve janë ndërmarrë masat administrative të parapara me ligj, përfshirë edhe mbylljen e përkohshme të dy lokaleve që ushtronin aktivitet pa dokumentacionin e nevojshëm.

Përveç aktiviteteve të lartcekura, sektori ka realizuar edhe kontrolle rutinore dhe vizita në terren, ka trajtuar kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, si dhe ka bashkëpunuar me institucionet e tjera relevante për zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e tregut.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-279 për Inspektimet, është përcaktuar korniza e re institucionale për organizimin dhe funksionimin e sistemit inspektues në Republikën e Kosovës. Në bazë të këtij ligji dhe dispozitave kalimtare të tij, kompetencat për inspektimin e tregut janë transferuar nga niveli lokal në nivelin qendror, përkatësisht në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përmes Inspektoratit Qendror të Tregut.

*Si rrjedhojë, Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Istogut ka ushtruar kompetencat e saj në këtë fushë deri në momentin e transferimit të tyre dhe ka realizuar koordinimin e nevojshëm institucional për dorëzimin e lëndëve, dokumentacionit dhe çështjeve në procedurë tek organet kompetente të MINT-it. Pas këtij transferimi, mbikëqyrja dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e tregut ushtrohen nga autoriteti qendror, ndërsa komuna vazhdon të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse sipas kompetencave të përcaktuara me ligj.*

Përmes aktiviteteve të realizuara deri në transferimin e kompetencave, Sektori i Inspektimit të Tregut ka kontribuar në forcimin e ligjshmërisë, mbrojtjen e konsumatorit, përmirësimin e disiplinës në ushtrimin e veprimtarive afariste dhe ruajtjen e rendit ekonomik në territorin e Komunës së Istogut.

“Aktivitet i veqantë I realizuar gjatë periudhës raportuese”

Gjatë periudhës raportuese, me rastin e festës së Kurban Bajramit, Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Istogut, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Ndërmarrjen K.R.M “Ambienti”, ka organizuar dhe koordinuar vendosjen e pikave grumbulluese për mbetjet e therjeve të kurbanëve në lokacione të ndryshme të territorit të komunës.
Qëllimi i këtij organizimi ka qenë sigurimi i grumbullimit dhe menaxhimit të rregullt të mbetjeve, ruajtja e pastërtisë së hapësirave publike, mbrojtja e mjedisit dhe parandalimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin publik. Përmes koordinimit ndërinstitucional dhe angazhimit të ekipeve në terren, qytetarëve u është mundësuar depozitimi i mbetjeve në pikat e caktuara, ndërsa është siguruar largimi dhe trajtimi i tyre në përputhje me procedurat dhe kompetencat përkatëse.
Ky aktivitet ka kontribuar në mirëmbajtjen e higjienës publike gjatë festës, në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për menaxhimin e duhur të mbetjeve dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet drejtorive komunale në funksion të ofrimit të shërbimeve sa më efikase për qytetarët.

Përfundim

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Istogut ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e saj me profesionalizëm dhe në bashkëpunim me institucionet kompetente, duke kontribuar në forcimin e ligjshmërisë, mbrojtjen e shëndetit publik, ruajtjen e mjedisit, përmirësimin e rendit urban dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

*DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA*

DREJTORIA PER ZHVILLIM EKONOMIK

*RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026*

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Zyrtari Kryesor Financiar, përkatësisht Sektori i Financave, ka zhvilluar aktivitetet e saj në përputhje me planin e punës, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe aktet nënligjore dhe rregulloret e tjera në fuqi.

**Gjatë kësaj periudhe janë realizuar këto aktivitete:**

- Është përgatitur Pasqyra Financiare për vitin 2025.
- Janë përgatitur raportet e tjera financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.
- Është përgatitur dokumentacioni dhe formularët për qasje në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) për vitin 2026.
- Janë përgatitur raportet e nevojshme për raportim në SMPK
- Është përgatitur plani i zotimeve dhe plani i shpenzimeve për secilën drejtori dhe kategori ekonomike.
- Janë shqyrtuar dhe aprovuar 43 deklarata për inicimin e procedurave të prokurimit.
- Është realizuar raportimi lidhur me financimin e Organizatave Joqeveritare (OJQ).
- Janë aprovuar zotimet dhe faturat në sistem, në përputhje me procedurat financiare në fuqi.
- Janë përgatitur raportet financiare mujore dhe tremujore.
- Është realizuar barazimi (rikonsilimi) mujor me Thesarin.
- Është bërë raportimi mujor i obligimeve të papaguara dhe obligimeve kontraktuale.
- Është realizuar bartja e mjeteve të pashpenzuara brenda tremujorit, si dhe bartja e mjeteve nga Tremujori I (TM1) në Tremujorin II (TM2), sipas nevojave dhe planifikimit buxhetor.
- Janë përgatitur dhe proceduar kërkesa të ndryshme për regjistrimin e furnitorëve, anulime dhe ndryshime të tjera në sistem.
- Është përgatitur Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027–2029.

Të gjitha aktivitetet janë realizuar në përputhje me afatet ligjore dhe procedurat e përcaktuara, duke siguruar menaxhim të rregullt, transparent dhe efikas të proceseve financiare të institucionit.

Në vijim është paraqitur Raporti Financiar për periudhën Janar –Qershor 2026, i cili bëhet në bazë të kërkesave për raportim bazuar në dispozitat e nenit 45, paragrafi 45.2 dhe 45.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 "Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë" dhe statutit Komunal.

Ky raport ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë

sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT JANAR –QERSHOR 2026

Buxheti Komunal sipas ligjit te Buxhetit Nr.10/L-001 në vlerë 16,687,746.00 € ka pësua ndryshime gjatë periudhes Janar – Qershor më një rritje prej 230,485.43 €: Buxheti pas rritjeve për këtë periudhe ka arrit në 16,918,231.43 € (Të hyrat dhe donacione të bartura nga vitet paraprake)

| PËRSHKRIMI | SHUMA € | |
|---|---|---|
| Grandi qeveritar | € | 15,087,472.00 |
| Te hyrat vetanake | € | 1,600,274.00 |
| Buxheti me ligjin e Buxhetit nr.10/L-001 | € | 16,687,746.00 |
| Mjetet e bartura nga viti paraprak | € | - |
| Donacione | € | 230,485.43 |
| Buxheti shtesë | € | 230,485.43 |
| TOTAL BUXHETI | € | 16,918,231.43 |

| RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT JANAR - QERSHOR 2026 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Buxheti fillestar | Alokimi | Shpenzimi | Progresi me plan |
| Përshkrimi | 10/L-001 | SIMFK | SIMFK | në, % |
| TOTALI | 16,687,746.00 | 12,037,585.13 | 9,151,672.24 | 76.03 |
| Granti i Përgjithshëm | 15,087,472.00 | 11,260,219.90 | 8,748,317.16 | 77.69 |
| Paga dhe Meditje | 9,207,173.00 | 5,379,920.90 | 5,379,920.90 | 100.00 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 2,881,489.00 | 2,881,489.00 | 1,312,180.23 | 45.54 |
| Shpenzimet Komunale | 337,600.00 | 337,600.00 | 149,378.71 | 44.25 |
| Investimet Kapitale | 2,661,210.00 | 2,661,210.00 | 1,906,837.32 | 71.65 |
| Të hyrat vetanake | 1,600,274.00 | 546,879.80 | 403,355.08 | 73.76 |
| Paga dhe Meditje | 40,000.00 | 10,000.00 | - | - |
| Mallrat dhe Shërbimet | 116,000.00 | 15,000.00 | 11,207.35 | 74.72 |
| Subvencione dhe Transferet | 523,000.00 | 226,576.92 | 131,655.00 | 58.11 |
| Investimet Kapitale | 921,274.00 | 295,302.88 | 260,492.73 | 88.21 |
| Mjetet e bartura | - | - | - | #DIV/0! |
| Mallrat dhe Shërbimet | - | - | - | #DIV/0! |
| Shpenzime Komunale | - | - | - | #DIV/0! |
| Subvencione dhe Transferet | - | - | - | #DIV/0! |
| Investimet Kapitale | - | - | - | #DIV/0! |
| Grantet - Donacionet | - | 230,485.43 | - | - |
| Subvencione dhe Transferet | | 1,174.00 | - | - |
| Investimet Kapitale | | 229,311.43 | - | - |
| Pagesat Direkte | 16,687,746.00 | 12,037,585.13 | 9,151,672.24 | 76.03 |




SHPENZIMET PËR TM2 2026-2024

Buxheti për tremujorin e parë (TM2) është 16,918,231.43 €. Gjatë kësaj periudhe buxhetore janë alokuar mjete në vlerë prej 12,037,585.13 €, ndërsa shpenzimet e realizuara arrijnë në 9,151,672.24 €, që përfaqësojnë 76.03% të buxhetit të alokuar. Ky nivel i shpenzimeve tregon një realizim të knaqëshem në raport me mjetet e alokuara.

Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve edhe gjatë kësaj periudhe ka vazhduar i bazuar edhe në bashkëpunim me institucione relevante që adresojnë çështjet e arsimit dhe ngritjes së kapaciteteve në arsim përmes bashkëpunimit me Fakultetin e Edukimit dhe organizata partnere – OJQ „TOKA" – trajnimi i një grupi të mësimdhënësve duke përfshirë edhe rolin e DKA-së respektivisht Komunës si në aspektin organizativ, teknik dhe material.

ORGANIZIMI I GARAVE TË DITURISË

Drejtoria Komunale e Arsimit në funksion të afirmimit të dijës ka organizuar garat në nivel shkolle dhe në nivel komunal në disa fusha si në fushën e Matematikës, Shkencat natyrës – Fizikë dhe Kimi, Gjuhët dhe Komunikimi – Gjuhë Shqipe dhe Gjuhë Angleze. Duhet vlerësuar pozitivisht dhe me admirim inkurajimin e drejtorëve mësimdhënësve dhe prindërve për pjesëmarrjen e nxënësve në gara sikurse për rezultatet e nxënësve e veçanërisht rezultatin e treguar në lëndën e fizikës ku nxënësja nga komuna e Istogut respektivisht nga shkolla ,,Bajram Curri" është renditur në vendin e parë në garën në nivel të republikës së Kosovës.

Aktivitete të shumta janë organizuar edhe në fushën sportet dhe shëndeti në nivel shkolle dhe në nivel komunal dhe jo vetëm.

PËRGATITJET PËR VITIN SHKOLLOR 2026-27

Në kontestin e planifikimit dhe përgatitjeve për vitin shkollor 2026-27 në ketë periudhë është zhvilluar procesi i përcaktimit dhe hartimit të programeve me zgjedhje sikurse përmbyllet ky proces me shqyrtimin në nivel komunal

Është planifikuar edhe numri i grupeve në kopshte dhe paraleleve në nivelin e klasave përgatitore dhe klasën e parë sikurse është planifikuar numri i nxënësve në gjitha klasat si dhe planifikimi për regjistrim në klasat e dhjeta në dy Institucionet e Arsimit të lartë në komunën e Istogut sipas drejtimeve dhe profileve të përcaktuara në bashkëpunim me Institucionet Arsimore, DKA-në dhe Ministrin e Arsimit e krahas këtij planifikimi ka përfunduar edhe faza e parë e regjistrimit dhe bazuar në këto premisa profesionale është analizuar edhe fondi i orëve sipas fushave kurrikulare dhe lëndëve në kuadër të fushave nga kushtëzohet edhe numrit i stafit të angazhuar duke analizuar kualifikimin e mësimdhënësve sipas fushave në raport me lëndët respektivisht kërkesat.

| PLANIFIKIMI PËR REXHISTRIM | KLASA PËRGATITORE | KLASA E PARË | GJIMNAZI HAXHI ZEKA | IAAP – MITHAT FRASHERI |
|---|---|---|---|---|
| | 309 | 408 | 250 | 242 |

Planifikimi në kopshte është harmonizuar numri në kuptim të ruajtjes së kapaciteteve të hapësirave fizike klasave/mësonjëtoreve.

VLERËSIMI I JASHTEM

Planifikimi, përgatitjet dhe realizimi për vlerësimin e jashtëm të nxënësve është realizuar sipas kërkesave dhe në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit, Drejtoria Komunale e Arsimit ka realizuar gjitha përgatitjet për testin e maturës/klasat e XII-ta dhe testin e klasave IX-ta edhe në funksion të angazhimit për sigurimin e hapësirave fizike të nevojshme si dhe stafin për menaxhimin dhe administrimin e këtij procesi në dy nivele dhe në bashkëpunim me institucionet e sigurisë/policinë e Kosovës dhe institucionin e kujdesit shëndetësor duke njoftuar për kohen dhe nivelet e premisat tjera teknike organizative.

Rezultatet e testit të maturës shtetërore 2025/26.

| REZULTATET E MATURËS SHTETËRORE | Numri i nxënësve të planifikuar për të marr pjesë | Numri i nxënësve që kanë marr pjesë | Numri i nxënësve që kanë kaluar testin | Numri i nxënësve nuk kanë kaluar testin | Kalueshmëria % |
|---|---|---|---|---|---|
| | 377 | 361 | 260 | 101 | 72.02 |

Rezultatet e testit të klasave të IX-ta - 2025/26.

| REZULTATET E TESTIT TË KLASAVE TË IX-ta | Numri i nxënësve të planifikuar për të marr pjesë | Numri i nxënësve që kanë marr pjesë | |
|---|---|---|---|
| | 457 | 445 | 46.68 |

ANALIZA E SUKSESIT TË GJYSMËVJETORIT TË DYTË TË VITIT SHKOLLOR 2025/26

Në pjesën e dytë të vitit shkollor 2025-26 respektivisht në gjysmë vjetorin e dytë në fund të muajit qershor janë raportuar të dhënat për suksesin përmes Sistemit për Menaxhimin e Informatave në Arsim për Arsimin Para universitar në Komunën e Istogut dhe në tabelor janë dhënë të dhënat për analizën e suksesit sipas niveleve dhe gjithsej në nivel komune nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë.

| Niveli 1-5 | Suksesi pozitiv | | Përcillen me nota negative | | Me një , dy dhe tri nota të dobëta | | Përsëritin klasën dhe të pa notuar | | Gjithsej numri i nxënësve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasat | Numri i nxënësve | % | Numri i nxënësve | % | Numri i nxënësve | % | Numri i nxënësve | % | |
| | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1-5 | 1957 | 97.36 | 29 | 1.44 | 19 | 0.95 | 5 | 0.25 | 2010 |
| 6-9 | 1632 | 92.52 | | | 98 | 5.56 | 34 | 1.93 | 1764 |
| 1-5 dhe 6-9 | 3589 | 95.10 | | | 117 | 3.10 | 39 | 1.03 | 3774 |
| 10-12 | 1008 | 88.03 | | | 99 | 8.65 | 31 | 2.71 | 1145 |
| Gjithsej Komuna | 4597 | 93.45 | | | 216 | 4.39 | 70 | 1.42 | 4919 |

<u>KOMUNA ISTOG - PLANI I VEPRIMIT PËR BRAKTISJE DHE REGIM NDAJ BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË FËMIJEVE NË SHKOLLA - RISHIKIMI 2025/2026 - 2028-2029</u>

Pas analizës së gjendjes dhe raundeve të konsultimit me akterët qendror dhe lokal, komuna duke ri analizuar praktikat sipas trendëve dhe përmes rishikimit të PLANIT TË VEPRIMIT PËR BRAKTISJE DHE REGIM NDAJ BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË FËMIJEVE NË SHKOLLA – PLANIT 2014 - në pjesën e dytë të vitit, dhjetor, 2025 ka përcaktuar objektivat e sajë primare për të cilat është hartuar një plan përkatës i veprimit përmes aktiviteteve të synuara. Nga Analiza e gjendjes dhe nivelet e konsultimit dhe mbi bazën e analizës së të dhënave/informatave për fushat në të cilat kërkohet ndërhyrje janë përshtatur ri dimensionuar objektivat të cilat gjithashtu janë në përputhje me dokumentet strategjike në sistemin e arsimit. Objektivat janë caktuar duke përdorur qasje sistematike në nevoja dhe janë nxjerrë në bazë të fushave specifike të cilat janë konsideruar të rëndësishme, koherente dhe të qëndrueshme. Në mënyrë që të arrijmë rezultate të qëndrueshme, qëllimi ishte të fokusohemi në dy apo tri fusha kryesore ku do të ruhen dhe aplikohen seriozisht standardet e nevojshme për tu siguruar se veprimet ruajnë standardet esenciale të sistemit të arsimit në funksion të gjithë përfshirjes , edhe pse nga analiza e gjendjes janë identifikuar edhe shumë çështje të tjera të cilat duhet të adresohen por në kuadër të aktiviteteve në qasjen analitike ndikohet pozitivisht gjithë sistemi i arsimit.

## <u>Objektivat prioritare të komunes:</u>

1. Funksionimi i Ekipeve Shkollore për Parandalim të Braktisjes dhe Mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla, përmes aplikimit të përgjegjësisë institucionale, planifikimit dhe veprimit sipas nevojës duke u bazuar në adresimin dhe raportimin standard koherent dhe të avancuar në menaxhimit të rasteve të identifikuara dhe adresimi te institucionet përgjegjëse në linjën e komunikimit institucional.

2. Identifikimi dhe Integrimi i fëmijëve jashtë shkollës përmes aplikimit të mekanizmave në kontestin human dhe ligjor në sistemin e arsimit të cilët adresojnë çështjet e braktisjes dhe mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla në bashkëpunim me ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve në shkolla, departamenteve institucionale relevante, prindërve dhe komunitetit në afërsi të shkollës.

3. Fuqizimi i kontestit profesional të komunitetit të Institucioneve në Arsimin para universitar duke aplikuar dhe zhvilluar kapacitetet profesionale në trajtimin e specifikave në procesin e mësimdhënies

dhe përkrahjes së nxënësve sipas nevojave të profilit social dhe akademik si dhe në përdorimin e gjuhës adekuate në raportet sociale brenda institucioneve dhe sigurimi personelit adekuat e të mjaftueshëm dhe infrastrukturës adekuate arsimore dhe hapësirave fizike bazuar në nevoja dhe trendët..

Infrastruktura si element i rëndësishëm në krijimin e ambientit të përshtatshëm për procesin arsimor ka pasur vëmendje dhe një trajtim tjetër me rendësi me angazhim në funksion të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së hapësirave të jashtme dhe të brendshme përmes rregullimit me bimë dekorative sikurse një rendësi tjetër i është kushtuar edhe mirëmbajtjes së objekteve arsimore dhe atyre përcjellëse.

.

## *DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT*
## *RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026*

Projektet Kapitale në fushën e infrastrukturës:
Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës dhe Parkut në Vrellë në fazën përgatitore.
Renovimi emergjent i hapësirave të brendshme të Palestrës së Sporteve në Istog, në fazën pritëse për tenderim.

Në Sektorin e Kulturës u realizuan këto aktivitete :

Më 7 Shkurt u mbajt Dita e Kulturës Japoneze në Istog, aty u shfaqën Kultura Japoneze dhe disa aktivitete kulturore dhe sportive nga ana jonë.
Për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, u mbajt koncerti festiv për fëmijë.
Për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, u mbajt turnir festiv në Pingpong.
Për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, u promovua libri “Përtej Shikimit”.
Për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, u promovua Katalogu Artistik me punime të nxënësve.
Për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, u shpallën dhe u shpërndanë mirënjohje për Lexuesit e Vitit 2025.
12 PRILLI – DITA E DËSHMORËVE TË ISTOGUT: Program kulturoro – artistik (këngë dhe valle popullore).

Më 12 prill - Xhirimi i filmit “Aroma e së Vërtetës”.
Për Ditën Ndërkombetare të Librit (23,24 dhe 25 prill), u mbajt aktivitet në Parkun e Qytetit.
Më 02 - 05 maj, u mbajt ekspozita “Sekretet Artistike të një qytetit të vogël”.
Më 10 maj, në kuadër të Turnirit në Futboll për Dëshmorin Demush Mavraj, u mbajt aktivitet kulturor në Stadiumin e Qytetit.
Më 30 maj, u bë promovimi i librit “Po ku je, Ibrahim Rugova?”.
Më 1 qershor për Ditën Ndërkombetare të Fëmijëve, u mbajt koncert me kënge dhe valle.
Për nder të Ditës së Çlirimit të Istogut, më 20 qershor, u mbajt program kulturoro - artistik me kënge dhe valle në Parkun e Qytetit.

Nga Sektori i Rinisë dhe Sportit janë këto aktivitete :
Gara në Hendboll për shkolla fillore për nder të “Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe”.
Më 28 shkurt - 01 mars, u mbajt për herë të parë ISTOGU CUP në Futboll për grupmoshat U9, U10, U11, U12 dhe U13.
Mbështetja e Sportit Shkollor për organizimin e garave ndërmjet shkollave të Komunës së Istogut.

Thirrje publike për Klubet Sportive të Komunës së Istogut.

12 PRILLI – DITA E DËSHMORËVE TË ISTOGUT - Aktivitete sportive: Turnir në futboll të vogël , ku morën pjesë shkollat fillore të Komunës.

12 Prill - u mbajt “Istogu Trail” në nderim të Dëshmorëve të Istogut, ky aktiviteti u financua nga Komuna e Istogut.

Më 18 prill, u mbajt turneu tashmë tradicional i shahut kushtuar “Tre dëshmorëve të Shkollës Shqipe” në Uçë.

Më 30 prill, në nderim të figurës dhe kontributit të z.Bedri Hajzeraj, u organizua turniri memorial në hendboll, në Uçë.

Më 7 maj, për nder të dëshmorit Demush Mavraj, në Saradran, u mbajt turnir në Volejboll në konkurencën e vajzave në mes shkollave fillore.

Më 10 maj, u mbajt Turniri Memorial në Futboll për dëshmorin Demush Mavraj, në Stadiumin e Qytetit “Demush Mavraj”.

Më 25 maj, në bashkëpunim me OSCE Mission in Kosovo, organizuam punëtorinë me temën “Formimi i Këshillave Lokale të Rinisë: Nga Korniza Ligjore deri te Zbatimi në Nivel Komunal”. Në këtë takim mori pjesë Drejtori i Qendrës Rajonale të OSBE-së në Pejë, Cristiano Barale.

Për nder të Ditës së Çlirimit të Istogut, më 20 qershor, u zhvillua ndeshja miqësore në futboll të madh, në mes të Veteranëve të FC Istogu dhe Komunës së Istogut.

Gjatë datave 13 – 14 qershor 2026, stadiumi "Demush Mavraj", mirëpriti turneun Rugby Europe Men's 7s Conference 2, ku morën pjesë tetë përfaqësuese kombëtare evropiane: Kosova, Estonia, Sllovakia, San Marino, Gjibraltari, Greqia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi.

Më 17 dhe 18 qershor, në Istog u mbajt edicioni e 8-të të Asamblesë Rinore të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, një ngjarje që bashkon të rinj liderë nga Kosova dhe vendet e Ballkanit Perëndimor.
Më datë 26,27 dhe 28 Qershor, u bë organizimi i Karvanit për Fëmijë, që u mbajt në Parkun e Qytetit, ku fëmijet patën rastin të realizojnë aktivitete dhe lojëra të ndryshme.

Krahas këtyre aktiviteteve të cilat janë bërë me financim të Drejtoratit, kemi realizuar edhe shumë vizita te klubet e sportit dhe kemi marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga vetë klubet e sportit në Istog si:
Liga e Senjorve në Pingpong.
Turnir në Karate për nder të Mësuesit Mustafë Blakaj.
Ceremonia e shpalljes Kampion i Ligës të tretë të Shkollës të Futbollit "Istogu 03"
Morëm pjesë edhe në hapjen e aktivitetit 'Hendbolli në Shkolla', në përbërje të projektit për mini-hendboll, i mbështetur nga Federata Evropiane e Hendbollit dhe Federata e Hendbollit të Kosovës.
Për Ditën e Tokës, bashkë me përfaqësuesit e OJQ "Forca e Gruas", kemi mbjellur lule në oborrin e Shtëpisë së Kulturës në Istog.
Takim me Kforin Italian, ku biseduam për projektet dhe aktivitetet e Drejtoratit Për Kulturë, Rini dhe Sport.
Takim me përfaqësuesit e OSBE-së për organizimin dhe formimin e KRL-së të Istogut.
Vizitë gjatë gërmimeve arkeologjike, në lokalitetin prehistorik të Pepajt-Lubozhdë.
Takim me përfaqësuesit të OJQ CED për organizimin e Karvanit për Fëmijë, që do të mbahet në Istog, për 3 ditë me radhë.
E shumë e shumë takime të tjera me krijues, shkrimtarë, nxënës e përfaqësues të Organizatave Jo Qeveritare.

BIBLIOTEKA E QYTETIT : "BREZI I RI"

Gjatë periudhës gjashtëmujore (janar - qershor) 2026, janë realizuar disa aktivitete:
Puna pandërprerë me lexues (anëtarësimi i lexuesve të ri).

Sistemimi i tërë materialit bibliotekar dhe mirëmbajtja e hapësirës e gjithë materialeve poseduese.
Zgjedhja e Lexuesve të Dalluar të vitit paraprak.
Pranimi i materialeve të reja nga donator të ndryshëm, përpunimi i tyre fizik, regjistrimi dhe sistemimi i tyre.
Përpilimi i listës së materialeve të kërkuara (librave), në bibliotekë për vitin 2026.
Biseda me lexues të vegjël, me qëllim stimulimi për lexim.
Biseda vetëdijësuese me lexues, për ruajtje dhe kthim në afat të caktuar kohor të librit.
Pranimi i vizitave nga nxënësit, në mënyrë të organizuar, së bashku me mësueset e tyre.
Vendosja e punimeve në bibliotekë për qëllime ndërgjegjësimi dhe stimulim për lexim.
Gjatë këtij gjashtëmujori, kemi të regjistruar: (20 lexues me pagesë, 70 lexues pa pagesë dhe 3 lexues me asistencë sociale dhe veteran).
Puna është zbatuar gjithnjë në bashkëpunim me drejtorin e Shtëpisë së Kulturës dhe DKRS-në.

BIBLIOTEKA: "BREZI I RI" DEGA NË GURRAKOC

Periudha tremujore: Janar – Shkurt – Mars 2026

Gjatë përiudhës së këtij tremujori, biblioteka "Brezi i Ri", ka vijuar punën me përkushtim, në mënyrë që çdo gjë të shkojë ashtu siç është paraparë me plan. Në mënyrë që komuniteti të ketë shërbim sa më cilësor, është vënë në vijë gjithë fondi librar dhe kemi bashkëpunuar me shkolla e mësimdhënës. Janë shikuar gjithashtu titujt e rinj që janë botuar, në mënyrë që të bëjmë pasurimin e fondit dhe janë rishikuar titujt e kërkuar që i mungojnë bibliotekës sonë.
Gjatë tremujorit në fjalë, është bërë pranimi i një numri të kënaqshëm lexuesish, veçmas nxënës të shkollave që janë regjistruar në bibliotekë dhe janë mjaft aktiv. Gjithashtu, kemi zhvilluar një numër aktivitetesh që kanë të bëjnë me librin dhe leximin, por edhe shënim datash të rëndësishme kombëtare, siç janë: 17 Shkurti - Dita e Pavarësisë së Kosovës, 22 Shkurt - Dita e Gjuhës Amtare, 7 Marsi - Dita e Mësuesit, 8 marsi - Festa e Gruas, 21 Mars - Dita e Poezisë etj. Kështu, kemi bërë përpjekje të mbajmë sa më afër lexuesit dhe besoj se ja kemi arritur qëllimit që fëmijët të jenë në kontakt të vazhdueshëm me librin.
Duke synuar të luajmë rolin që na takon si institucion i kulturës dhe tempull i dijes, jemi gjithnjë të hapur me komunitetin dhe kemi në fokus shërbim sa më cilësor, pasurimin e fondit si dhe një varg detyrash që kanë mbetur pa u shënuar në këtë raport.
Në këtë tremujor, nuk kemi pranuar asnjë titull të ri, por shpresojmë që së shpejti të pasurojmë fondin, me ç'rast është përpiluar lista e titujve që janë në interes të bibliotekës.
Me përkushtim të vazhdueshëm dhe zell, synohet përmirësimi i shërbimeve të bibliotekës dhe shtimi i numrit të lexuesve e veçmas kapërcimi i sfidave.

Periudha tremujore: Prill – Maj – Qershor 2026

Edhe gjatë këtij tremujori, biblioteka jonë ka vazhduar punën, duke u kujdesur që çdo gjë të shkojë mbarë dhe të plotësohen kërkesat e përdoruesve të librit në mënyrë korrekte. Në bazë të mundësive dhe për aq sa posedon fondi librar, u kemi ofruar atyre një qasje sa më të afërt dhe profesionale.
Kemi shënuar në mënyrë simbolike datat kombëtare dhe ato letrare, duke i mbajtur kështu të informuar dhe afër ata, e sidomos moshat shkollore.
Janë zhvilluar edhe diskutime e analiza rreth librave të ndryshëm.
Kemi bërë regjistrimin e anëtarëve të rinj në bibliotekë, të cilët janë njoftuar me rregullat e bibliotekës.
Është bërë pranimi i materialeve të reja, kryesisht dhuratë nga autorë të ndryshëm, të cilat janë inventarizuar dhe sistemuar.
Kemi shënuar kërkesat e reja të bibliotekës dhe gjatë tërë kohës, janë realizuar hulumtime rreth botimeve të reja që mund të jenë në interes të lexuesve.
Biblioteka jonë ofron shërbim të qasshëm çdoherë dhe vazhdimisht mbajmë kontakt me mësimdhënës, prind, autorë e lexues, në mënyrë që puna të zhvillohet me mbarësi dhe secili të shfrytëzojë materialet e nevojshme.

SEKTORI MUZE – ARKEOLOGJI

Janar 2026:
Në muajin janar, kemi pasur vizitorë dhe mysafirë të ndryshëm në muzeun tonë. Vizitorët kanë ardhur në grupe të vogla të përbërë nga dy-tre vizitorë, por gjithashtu ka pasur edhe vizita individuale.
Fillimisht, kanë ardhur Agim dhe Ylli Sylaj, duke u pasuar nga Valdet Alihajdaraj, Rinor Hoxhaj, Lendrit Januzaj, Xhevat Sylaj dhe Mimoza Mavraj. Vizitat janë realizuar në ditë të ndryshme gjatë këtij muaji. Vizitorët në përgjithësi kanë qenë të kënaqur me artefaktet e prezantuara dhe kanë shprehur dëshirën dhe vullnetin që ta ndihmojnë Muzeun edhe me artefakte të tjera, që disa prej tyre i ruajnë në shtëpitë e tyre.
Përveç punës me vizitorë, kemi bërë edhe pastrimin e artefakteve arkeologjike dhe hapësirave ku janë të vendosura këto artefakte.
Një kujdes të veçantë i kemi kushtuar edhe materialit të shkruar, ku kemi filluar të bëjmë klasifikimin e tij në mënyrë që ta kemi me të lehtë edhe përdorimin e tij në të ardhmën.

Shkurt 2026:
Muaji shkurt ka qenë shumë i frekuentuar me vizitorë të ndryshëm.
Fillimisht, më 7 shkurt, kemi pasur vizitorë nga Japonia, saktësisht ambasadorin japonez z. Hiroyaso Tanigak me stafin e tij dhe gjithashtu z. Yamashita Chigiru, përfaqësuesi kryesor i Zyrës së JICA (Agjensia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar) për Ballkan, bashkë me stafin e tij, të përbërë nga shqiptarë dhe japonezë. Përveç aktiviteteve të shumta që u mbajtën për nder të Ditës së Japonisë (Dita e Kulturës Japoneze), kishim gjithashtu edhe një vizitë në Muzeun Komunal. Vizitorëve ju shpjeguam se Muzeu ynë është mjaft i pasur me artefakte arkeologjike dhe etnologjike, duke theksuar se Komuna jonë

ka qenë e banuar që nga periudha e neolitit, prandaj edhe artefaktet i kemi që nga neoliti e deri në fund të shek. XX.
Më 13 shkurt, patëm për vizitë nxënësit e klasave të pesta dhe klasave të nënta të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Ismail Qemali" nga Saradrani. Nxënësit u informuan për së afërmi me Trashëgiminë tonë të pasur Kulturore. Vizita nga shkolla "Ismail Qemali", u realizua për nder të përvjetorit të 18-të të Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
Përveç grupeve të organizuara të vizitorëve, në muze kanë ardhur edhe individë të ndryshëm si p.sh., shkrimtari Muharrem Blakaj bashkë me Flamur Maxharraj e dashamirës të Trashëgimisë Kulturore të cilët u ndanë të kënaqur më punën e Muzeut.

Mars 2026:
Gjatë muajit Mars kemi pasur disa vizitorë.
Fillimisht për nder të përvjetorit të 28-të të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që mbahet tradicionalisht me datat 5,6 dhe 7 Mars, kemi pasur për vizitë në Muzeun tone, Shkollën e Mesme të Ulët "Ndre Mjeda" nga Rakoshi, më saktësisht nxënësit e klasës së pestë të kësaj shkolle, së bashku me mësuesen e tyre znj. Fitore Arifaj. Nxënësit kanë ardhur të shoqëruar edhe nga transportuesi i tyre z. Agim Sylaj.
Së pari nxënësit kanë pasur mundësinë që të njoftohen me artefaktet, të cilat janë në katin e parë të Shtëpisë së Kulturës e pastaj kemi kaluar në katin e dytë në sallën ku janë të ekspozuara edhe artefaktet tjera arkeologjike dhe etnologjike. Nxënësit u informuan gjerësisht për këto artefakte. Ligjerata ishte interaktive pasi që nxënësit shpeshherë bënin pytje rreth artefakteve, duke u interesuar për vjetërsinë dhe funksionin e atyre artefakteve. Pra, me fjalë të tjera, interesimi i nxënësve ishte shumë i madh. Për fund, u realizuan edhe disa fotografi që të mbahen si kujtim edhe për ne edhe për nxënësit. Vizita u realizua me datë 05 Mars 2026.
Më datë 26 mars, kemi pasur një vizitë tjetër nga z. Fidan Krasniqi, profesor i gjeografisë në Gjimnazin "Bedri Pejani" në Pejë, i cili ishte i interesuar për të realizuar disa foto të Muzeut.

Prill 2026:
Në Prill kemi pasur vizitorë të ndryshëm dhe gjithashtu kemi pasur vizita në terren.
Më 7 prill, Muzeun tonë e vizituan Anita Morina, Leonora Krasniqi dhe Blegina Rashiti, së bashku me fëmijët e tyre. Si dashamirëse të trashëgimisë, ato u interesuan për artefaktet e Muzeut dhe u ndanë shumë të kënaqura me numrin e madh të tyre.
Ndërsa, më 20 prill, na nderuan me vizitën e tyre Vanesa Nimanaj, muzikante dhe mësimdhënëse e muzikës dhe Bekë Zekaj, muzikant dhe instrumentist. Këta të dy u interesuan me së shumti për veshjen e Podgurit.
Më 24 prill, realizuam një vizitë në disa lokalitete arkeologjike të Komunës sonë. Fillimisht, vizituam fshatin Lubovë. Aty u njoftuam me praninë e një varri mesjetar, nje vendi që ka pasur varreza të tjera të vjetra dhe gjithashtu me toponimet "Lisi i Zojës" dhe "Kisha".
Vazhduam më pas në fshatin Studenicë, te Kompleksi kishtar i Studenicës, më pas në fshatin Vrellë te Bazilika Paleokristiane dhe te Burimi i Vrellës. Vizitën e përfunduam te Memoriali i Dëshmorëve në Vrellë.

Më 28 prill, patëm për vizitë Muhamet Osmanaj, Agron Osmanaj dhe Leon Osmanaj nga Prekalla. Përveç vizitës, Leoni pati edhe disa pyetje shtesë për ne, për ta ndihmuar në lidhje me një seminar që kishte ne fakultet.

Maj 2026:
Gjatë muajit maj muzeu ka mirëpritur një numër të konsiderueshëm vizitorësh.
Më 18 maj, në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve, na nderuan me vizitën e tyre nxënësit e klasave të II-ta të Shkollës së Mesme të Ulët "Bajram Curri" nga Istogu. Nxënësit kanë ardhur të shoqëruar nga mësueset e tyre znj. Egzona Fejza, znj. Fitnete Buleshkaj, znj. Adelina Zeqiraj, znj. Mimoza Bruqaj dhe znj. Shkëndije Podrimaj.
Nxënësit janë informuar për së afërmi më trashëgiminë tonë kulturore. Vizita është zhvilluar në dy ambiente: në katin e parë, ku i kemi të ekspozuara disa nga artefaktet arkeologjike dhe në katin e dytë ku janë të ekspozuara artefaktet e tjera arkeologjike dhe etnologjike.
Ligjerata ka qenë interaktive dhe nxënësit, por edhe mësueset, kanë pasur mundësi të bëjnë pyetje të ndryshme në lidhje me trashëgiminë tonë kulturore, muzeun etj.
Më 22 maj, muzeun tonë e ka vizituar z. Hajriz Sylaj nga Istogu, i cili që nga viti 1999 është me banim në Belgjikë. Artefaktet e ekspozuara në muzeun tone, i kanë bërë shumë përshtypje dhe është ndarë shumë i kënaqur.

Qershor 2026:
Fillimisht, më 3 qershor kemi pasur mysafirë në muzeun tonë, nxënësit e klasës së gjashtë të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Mehmet Akif" nga fshati Shushicë e Epërme. Së bashku me nxënësit, kanë qenë edhe dy mësuese, znj. Vlora Hasanaj - arsimtare e historisë dhe znj. Donjeta Hysenaj - mësuese e ciklit parashkollor.
Vizita filloi së pari në katin e parë, ku fëmijët patën rastin të vizitonin artefaktet e ekspozuara, me ç'rast u njoftuan për së afërmi me trashëgiminë tonë kulturore dhe më pas kaluam në katin e dytë, ku ndodhet pjesa kryesore e Muzeut.
Nxënësit u informuan hollësisht në lidhje me artefaktet e ekspozuara në Muze. Gjithsesi nxënësit kishin edhe pyetje të shumta, të cilat i dëgjuam me shumë kënaqësi dhe u dhamë përgjigje.
Të nesërmën, përkatësisht më 4 qershor, Muzeun tonë e vizituan nxënësit e klasës së katërt të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Ndre Mjeda" nga fshati Rakosh, së bashku me mësuesin e tyre z. Tafë Fekaj dhe me transportuesin e nxënësve, z. Agron Boletini.
Nxënësve ju mundësua njohja me trashëgiminë tonë etnologjike dhe arkeologjike dhe me historinë e komunës sonë. Ligjerata ishte inteaktive dhe nxënësit patën rastin të parashtrojnë pyetje të ndryshme. Pas ligjeratës, nxënësit realizuan edhe fotografi në Muze dhe u ndanë shumë të kënaqur.
Më 9 qershor, patëm rastin ta mirëpresim prapë Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Ndre Mjeda" nga fshati Rakosh, por kësaj radhe na erdhën për vizitë nxënësit e klasës së gjashtë, së bashku me dy arsimtarët e historisë, znj. Vlora Hasanaj dhe z. Sami Sadriaj, si dhe punëtorja teknike, znj. Fazile Arifaj. Gjatë vizitës, nxënësit patën mundësi të shihnin artefakte arkeologjike, armë të vjetra, veshje tradicionale, vegla pune dhe koleksionin me artefakte nga lufta e fundit në Kosovë. Nxënësit bënë shumë pyetje dhe ishin shumë kureshtarë për të kaluarën tonë historike.

Më datë 10 qershor, na nderuan me vizitën e tyre dy arkeologë, znj. Zhaneta Gjyshja, arkeologe nga Shqipëria dhe z. Eduart Abazi, student në nivelin master në Francë për arkeologji. Vizita e tyre ishte më shumë e përqendruar tek artefaktet e periudhës së neolitit, të cilat janë gjetur në lokalitetin “Krye” të fshatit Vrellë. Kjo për arsye se znj. Zhaneta Gjyshja së bashku me Michael Galaty nga Univerisiteti i Miçiganit, kanë filluar vitin e kaluar gërmimet në Fshatin Vrellë, me ç’rast kanë hasur në një vendbanim të periudhës së neolitit. Prandaj interesimi i tyre ishte më i fokusuar te këto artefakte, sigurisht për të bërë analogji me artefaktet tjera të vendbanimit neolitik të Vrellës.
Më 25 qershor, vizituam lokalitetin Pepaj në fshatin Lubozhdë, aty ku për rreth një muaj po vazhdojnë gërmimet arkeologjike. Lokaliteti Pepaj është zbuluar vitin e kaluar nga arkeologu amerikan Michael Galaty, me ç’rast kishte hapur vetëm një sondë provuese 1x1m dhe kishte zbuluar një vendbanim të periudhës së bronzit të hershëm.

SEKTORI I MUZIKËS

Janar 2026:
Gjatë muajit janar, në kuadër të Sektorit të Muzikës pranë Pallatit të Kulturës “Adem Jashari” në Istog, janë zhvilluar këto aktivitete:
Janë realizuar përgatitjet për konkursin e pranimit të anëtarëve të rinj në Sektorin e Muzikës.
Është vazhduar puna me korin e fëmijëve, ku janë përfshirë mbi 40 fëmijë – këngëtarë të rinj, si dhe puna me grupet e valltarëve të ndara sipas moshave:
Grupi i parë: nga klasa I deri në klasën V.
Grupi i dytë: nga klasa VI deri në klasën IX.
Janë zhvilluar përgatitjet për koncertin festiv të 17 Shkurtit 2026, ku fëmijët e Sektorit të Muzikës do të prezantojnë program artistik me këngë, valle dhe recitime.
Programi është udhëhequr nga zyrtari për muzikë dhe udhëheqësi artistik i programit, Prof. Dardan Demaj.
Shkurt 2026:
Sektori i Muzikës është pasuruar me anëtarë të rinj përmes konkursit të organizuar, ku janë regjistruar rreth 30 fëmijë të rinj.
Fëmijët kanë vazhduar aktivitetet e rregullta në:
Këndim,
Vallëzim,
Instrumente muzikore.
Më 17 Shkurt 2026, në orën 15:00, në Pallatin e Kulturës “Adem Jashari” në Istog, është mbajtur koncerti festiv për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës.
Koncerti është udhëhequr nga Dardan Demaj – zyrtar për muzikë dhe udhëheqës artistik i programit.
Janë vazhduar ushtrimet javore me grupet muzikore dhe folklorike për aktivitetet e muajve në vazhdim.
Mars 2026:

Janë realizuar ushtrime aktive ditore dhe javore me korin e fëmijëve dhe grupet e tjera muzikore e folklorike për përgatitjen e aktiviteteve të muajve mars dhe prill.
Janë zhvilluar ushtrime me grupin Aktiv për pjesëmarrje në manifestimin “Dita e Dëshmorëve të Istogut”, ku Sektori i Muzikës ka prezantuar program artistik nën udhëheqjen e Dardan Demajt.
Prill 2026:
Është vazhduar puna aktive me mbi 30 fëmijë të seleksionuar përmes konkursit në Sektorin e Muzikës pranë Pallatit të Kulturës “Adem Jashari” në Istog.
Është vazhduar puna me grupet folklorike dhe muzikore që funksionojnë në kuadër të Sektorit të Muzikës.
Janë zhvilluar ushtrime ditore me grupet e fëmijëve sipas orarit:
*Grupi i parë: 10:00 – 11:30 *Grupi i dytë: 13:30 – 15:30
Maj 2026:
Është realizuar punë aktive dy mujore me fëmijët e Sektorit të Muzikës për përgatitjen e koncertit të 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.
Qershor 2026:
Më 1 Qershor 2026, është realizuar koncerti për Ditën e Fëmijëve.
Aktiviteti është shënuar me një program të pasur artistik nga fëmijët e Sektorit të Muzikës.
Janë vazhduar ushtrimet ditore me grupet e fëmijëve sipas orarit:
*Grupi i parë: 10:00 – 11:30 *Grupi i dytë: 13:30 – 15:30
Është zhvilluar puna me grupin e rapsodëve të rinj që funksionojnë pranë Sektorit të Muzikës.

| Statusi | Numri | % | Diagrami |
|---|---|---|---|
| Ne process | 3 | 6.5 | |
| Miratuar | 25 | 74.2 | |
| Refuzuar | 6 | 19.4 | |
| Totali | 34 | | |

***DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL***
***RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026***

Përshkrimi

Aktivitetet në periudhën janar- qershor.......................................................................... 3
Lendet e pranuara dhe zgjidhja e tyre............................................................................3-4
Projektet kapitale dhe thirrjet publike............................................................................4-5

Hyrje

Bazuar në programin për bujqësi dhe zhvillim rural 2026 te Drejtorisë brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me organizatat e ndryshëm partnere qe fokus kanë me projekte te ndryshme bujqësinë dhe me ministrin e linjës për koordinim te aktiviteteve dhe te programeve te ndryshme për vitin 2026. Po ashtu gjatë kësaj periudhe kemi pasur një numër te takimeve me palë te ndryshme-fermer –biznese dhe institucione të ndryshme etj. Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në drejtorin sektorin e bujqësisë që kanë qenë të planifikuara në programin e punës.

Aktivitetet në periudhën, janar- qershor 2026

Ne kuadër te DBZHR-së-së nga muaji janar janë realizuar një mori aktivitetesh. Ndër me kryesorët do të paraqiten të specifikuara sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

Ne muajin janar janë përgatitur të gjitha kërkesat dhe lëndët e vitit paraprak, ku janë dorëzuar për arkivim tek zyrtari kompetente e arkivës komunale.

Po ashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje te stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 3 zyrtar te rinjë me kontrata për shërbime të veçanta, përmes ligjit të

prokurimit, të cilët janë trajnuar dhe te përgatitur për procedurat e aplikimit dhe digjitalizimit të parcelave dhe kanë punuar në aplikimin e fermerëve për pagesa direkte.

Janë bërë të gjitha përgatitjet e furnizimit me material shpenzues dhe pajisje teknologjike për mbarëvajtjen e procesit të aplikimit për pagesat direkte

Janë iniciuar procedurat e zotimit te mjeteve për projektet kapitale

Pranim dhe përgjigjeje në kërkesa të palëve

Shërbime të tjera ne kuadër te drejtorisë si; këshilla, ekspertiza vërtetime për fermer, etj

Vlerësimi i dëmeve të ndryshme, ne kulturat bujqësore dhe kafshë shtëpiake.

Raportime pran nivelit qendror për aktivitetet e ndryshme nga fushë veprimtaria e drejtorisë

Inicim i procedurës për projekte për investime kapitale, sipas ligjit për ndarjet buxhetore 2026

Nënshkrimi i kontratave dhe shpërndarja e pajisjeve dhe mjeteve te punës nga projekti i përbashkët i komunës, FAO-së dhe UN Women , “ Fuqizimi i Grave Rurale “

Koordinimi i aktivitetit për përgatitje te sezones se ujitjes se bashku me KRU “Drini i Bardhë”

Përgatitje dhe për sezonin e korrje shirjeve dhe përcjellje te këtij aktiviteti

Fillimi i procesit te aplikimit për pagesat drekte te fermerëve për kultura bujqësore dhe kafshë

Lëndët e pranuara dhe zgjidhja e tyre

2.1 Kërkesat drejtuar drejtorisë se bujqësisë

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar kërkesa te ndryshme të palëve, sipas përshkrimit te me poshtëm.

| Pranuar | Numri i kërkesave | Ne proces | Miratuara | Ceduara | Refuzuara | Pezulluar | Anuluar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kërkesa te rregullta | 56 | 11 | 36 | 2 | 8 | 1 | 0 |
| Aplikime për pagesa direkte-subvencione deri me detë 01.07.2026 | 533 | 00 | 533 | 00 | 00 | 00 | 00 |
| Aplikimi qumësht, majmëri, akuakultur | | | 128 | | | | |

Vlerësimi i dëmeve nga kafshët e egra ne kafshë shtëpiake 59

Totali i lendeve te trajtuara 589

Gjatë fazës se aplikimit te fermerëve për pagesa direket ne gjashtëmujorin e par te këtij viti dhe deri me datë 01.07.2026 janë pranuar dhe procedura 533 aplikime, për : kultura bujqësore, kafshë, qumësht, majmëri dhe akuakultur dhe 56 kërkesa te rregullta.

Totali i lëndëve;
Aplikim për subvencione- kultura bujqësore-kafshë, qumësht, majmëri, akuakultur, 533 copë
Kërkesa te palëve përmes arkivit, 56 copë
Shkresa dhe komunikim me institucione te ndryshme 59 copë
Vlerësimi i dëmeve ne bujqësi- 3

---

Totali i kërkesave te trajtuara; 651 kërkesa
Thirrjet publike

Gjatë kësaj periudhe raportuese është shpallur dhe thirrja për projektet e OJQ-ve ne organizimin e aktiviteteve “Te qethat 2026” dhe “Dita e Mollës 2026 “.

Projektet kapitale
Janë zotuar mjetet për projekte kapitale sipas listës se projekteve, me ligjin për ndarjet buxhetore 2026 dhe kanë filluar procedurat ne përgatitje te projekteve për shpallje te procesit te prokurimit;
Është shpallur tenderi dhe nënshkruar kontrata për projektin “ Mirëmbajtja e Rrugëve Malore, Lot 1 dhe Lot 2 “, ku deri tani kanë përfunduar 50 % et punimeve te kontraktuara
Ka vazhduar aktiviteti ne implementim te projektit dy vjeçar, Rehabilitimi i Kanalit te Gogës dhe ne projektin ,Ndërtimi i Kanalit te Ujitjes segmenti 4 dhe dega e Terezis.

## *DREJTORIA E SHËNDETËSISË*
## *RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026*

Gjat kësajë periudhe e terë puna dhe aktiviteti i Drejtoratit për Shëndetësi ka qenë e drejtuar në përmirësimin dhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës së Istogut. Rëndësi e veçantë i është kushtuar sidomos zbatimit të reformave në lëmin e Mjekësisë Familjare, përmirësimit të kushteve të punës dhe të infrastrukturës në objektet shëndetësore. Për kundër faktit se jemi duke punuar në hapësira të zvogëluara në QKMF për shkak se objekti i parë i QKMF është rrenuar i tëri dhe ka filluar ndërtimi i objektit të ri të QKMF, dhe shumica e shërbimeve janë bartur në objektin e dytë të QKMF, të gjitha shërbimet janë duke punur normalisht pa ndërpre duke ofruar shërbime sa më të mira në dobi të qytetarëve. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, në bashkpunim me menaxhmentin e QKMF kemi bërë vizita të vazhdueshme në QKMF dhe të gjitha qëndrat tjera shëndetësore (QMF dhe AMF), ku jemi njoftuar për së afërmi me kushtet dhe kemi identifikuar problemet dhe nevojat e këtyre njësive. Problemet e identifikuara janë kryesisht të natyrës teknike të mirëmbajtjës së hapsirave dhe parqeve.

Pastaj vëmendje i kemi kushtuar edhe shërbimit të diagnostikës (Rentëgenit dhe shërbimit të Labotatorit), kemi berë furnizime të pa ndërprera me reagenca për nevoja të shërbimit të Laboratorit dhe filma për shërbimin e Rentgenit. Në shërbimin e radiologjisë kemi angazhuar Radiologun si konsulent i jashtëm, i cili bënë leximin dhe punimin e raportëve për të gjith ata të cilët i nënshtrohen egzaminimit me Mamografi. Furnizimi me barna dhe material tjetër shpenzues nga lista esenciale i cili realizohet nga Ministria e Shëndetësisë, nuk ka qenë gjithmonë i mjaftueshëm ashtu siq ka qenë planifikimi, prandaj Drejtorati për Shëndetësi për mbulimin e mungesës nga lista esenciale dhe për furnizime me barna jashtë listës esenciale të cilat janë të domosdoshme, ka planifikuar një buxhet prej rreth 120,000.00€. Nga kjo shumë deri me tani janë shpenzuar rreth 35,000.00€

Gjatë kësajë periudhe, kemi përcjellë për së afërmi punimet të cilat janë duke vazhduar në ndërtimin e QKMF së re, punimet janë duke shkuar mirë dhe faza e parë e ndërtimin është afër përfundimit.

Në ketë vit, kemi qenë përfitues të një donacioni nga shteti i Katarit me ndërmjetësim të BIK-ut, është ndërtuar Qendra e re e Mjekësisë Familjare në Gjurakoc. Punimet kanë përfunduar dhe së shpejti pritet përurimi.

Shqyrtimi i kërkesave - Gjatë kësajë periudhe, këtij drejtorati i janë parashtruar një numër i madh i kërkesave të cilat kan të bejnë me kërkesa për ndihmë finaciare për sherim dhe blerje të medikamentëve. Deri me tani janë shqyrtuar dhe aprovuar rreth 105 prej tyre dhe për realizimin e tyre janë ndarë 22,200.00€ nga Kategorija Ekonomike Transfere dhe Subvencione. Po ashtu gjat kësajë periudhe janë paraqitur edhe një numër të madhë të kërkesave për kompenzimin e shpenzimeve të karburantëve për përsonat të cilët janë në Hemo-dializë dhe janë duke u trajtuar në repartin Hemodilektik në Spitalin Regjional në Pejë, të cilët janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe si mjet tansporti përdorin automjetet private, dhe për përsonat të cilët trajtohen me kemio-terapi dhe rrezatim në institutin Onkologjik pranë SHSKUK. Për grupin e parë kemi ndarë nga 0.08 lit. karburantn për një Km. ndërsa për grupin e dytë nga 15 lit. për një seancë. Për këto dy qëllime për periudhën janar-qershor janë dhënë reth 10804 litra karburantë në vlerë rreth 15,789.87€.

Me qëllim të përmisimit të shërbimeve shëndetësore edhe në ketë vit kemi vazhduar me aktivitetin“ Përkujdesja Shëndetësore Shtëpiake dhe Ambulator –Home Care 2026” i cili realizohet me vizita sistematike në shtëpi për përsonat dhe familjet me nevojë. Implementues i këtij projekti është Operatori i Ekonomik Kosova Med. Përmes këtijë projekti kemi realizuar punësimin e 60 punëtorëve kryesisht staf shëndetësorë dhe social. ndryshme mjekësore për njerëzit me nevojë.

Home-Care në Istog ka pasur mbështetje të vazhdueshme nga Qëndra Kryesore e Mjekësis Familjare, janë siguruar vizitat në teren nga mjekët, për përfituesit e projektit, është bërë sigurimi i medikamentëve esenciale nga barnatoria qendrore e QKMF-së në Istog, sigurimi i gazave, instrumentëve sterile, sigurimi i katetrave , qesëve për stomë etj.

## RAPORT I PUNËS SË QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE NË ISTOG PËR PERIUDHËN KOHORE JANAR-QERSHOR 2026

# HYRJE

Raporti vjetor i punës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) paraqet një pasqyrë të përgjithshme të veprimtarisë, organizimit dhe performancës së kësaj qendre gjatë periudhës janar-qershor 2026. Ky raport është hartuar në përputhje me obligimet institucionale dhe kërkesat e Drejtorisë së Shëndetësisë, me qëllim të dokumentimit të punës së realizuar, vlerësimit të shërbimeve të ofruara dhe identifikimit të fushave që kërkojnë përmirësim.

Gjatë vitit 2026, QKMF ka luajtur një rol kyç në ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor për popullatën, duke siguruar shërbime shëndetësore cilësore, të qasshme dhe gjithëpërfshirëse. Aktivitetet e QKMF-së janë përqendruar në diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve akute dhe kronike, ofrimin e shërbimeve preventive, realizimin e vaksinimeve, kujdesin shëndetësor për grupet e ndjeshme, si dhe në reagimin ndaj rasteve emergjente shëndetësore.

Në realizimin e këtyre shërbimeve, stafi shëndetësor dhe administrativ i QKMF-së ka treguar përkushtim dhe profesionalizëm të vazhdueshëm, pavarësisht sfidave të ndryshme, si rritja e kërkesës për shërbime, kufizimet infrastrukturore dhe nevoja për burime shtesë njerëzore dhe materiale. Përmes bashkëpunimit me institucionet relevante shëndetësore dhe partnerë të tjerë, QKMF ka kontribuar në përmirësimin e shëndetit publik dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit.

Ky raport synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të argumentuar mbi gjendjen aktuale të QKMF-së, duke u mbështetur në të dhëna statistikore, analiza të aktiviteteve dhe vlerësime profesionale, si bazë për planifikimin strategjik dhe përmirësimin e mëtejmë të shërbimeve shëndetësore në vitet në vijim.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë grumbulluar dhe përpunuar në bashkëpunim me zyrën e SISH-it, administratën dhe zyrën e financave. Informacioni është mbledhur nga evidencat dhe dokumentacioni zyrtar i këtyre njësive, duke shërbyer si bazë për hartimin e raportit.

Për periudhën kohore Janar-Qershor 2026, në QKMF-Istog janë ofruar këto vizita dhe shërbime shëndetësore:

Institucionet përbërëse të QKMF-së:

Institucionet përbërëse të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) janë njësi të kujdesit shëndetësor parësor që veprojnë në kuadër të QKMF-së dhe shtrihen në territorin e komunës. Ato funksionojnë si pjesë e integruar e sistemit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në nivel lokal.

| Reparti/Njësia | Nr. i pacientëve | Nr.vizitave | Nr. i shërbimeve |
|---|---|---|---|
| Emergjencë | 18816 | 18816 | 32440 |
| Gjinekologji | 158 | 158 | 615 |
| Internistika | 3465 | 3465 | 4957 |
| Këshillimore | 2132 | | 4294 |
| Kujdesi shtëpiak | 1783 | | 2970 |
| Laborator | 4318 | | 132453 |
| Mamografi | 49 | | 196 |
| Mjekësi familjare | 15508 | 15508 | 37292 |
| Pediatri | 1860 | 1860 | 4533 |
| Rentgen | 2533 | | 4718 |
| Stomatologji | 1655 | | 3856 |

1. Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF)
   Këto janë njësi më të vogla shëndetësore që veprojnë në fshatra dhe ofrojnë këto shërbime: të mjekësisë familjare, shërbime stomatologjike, vaksinimi dhe imunizimi dhe barnatorja. Në Komunën tonë janë 4 QMF dhe janë të shtrira në këto fshatra:

   QMF: Vrellë, Banjë, Gurrakoc dhe Rakosh

2. Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF)
   Ambulanca zakonisht janë njësi edhe më të vogla, që veprojnë në vendbanime rurale apo zona të largëta dhe ofrojnë shërbime bazë të mjekësisë familjare, AMF-të janë të shtrira në këto fshatra

   AMF: Shushicë, Uçë, Cërkolez, Veriq, Zallq, Dobrushë, Saradran, Kaliqan, Dubrave

## Qendra e Mjekësisë Familjare-BANJË

| Reparti/Njësia | Nr.vizitave mjekësore | Nr. i shërbimeve |
|---|---|---|
| Mjekësi familjare | 2176 | 7708 |
| Stomatologji | 153 | 431 |

## Qendra e Mjekësisë Familjare-VRELLË

| Reparti/Njësia | Nr.vizitave mjekësore | Nr. i shërbimeve |
|---|---|---|
| Mjekësi familjare | 1363 | 3790 |
| Stomatologji | 215 | 641 |

## Qendra e Mjekësisë Familjare-GURRAKOC

| Reparti/Njësia | Nr.vizitave mjekësore | Nr. i shërbimeve |
|---|---|---|
| Mjekësi familjare | 1795 | 3969 |
| Stomatologji | 147 | 381 |

## Qendra e Mjekësisë Familjare-RAKOSH

| Reparti/Njësia | Nr.vizitave mjekësore | Nr. i shërbimeve |
|---|---|---|
| Mjekësi familjare | 1645 | 3262 |
| Stomatologji | 146 | 427 |

## AMBULLANTAT E MJEKËSISË FAMILJARE

| | Nr.vizitave mjekësore | Nr. i shërbimeve |
|---|---|---|
| | | |
| AMF-CËRKOLEZ | 0 | 0 |
| AMF-DOBRUSHË | 0 | 0 |
| AMF-DUBRAVË | 0 | 280 |
| AMF-KALIQAN | 0 | 778 |
| AMF-SARADRAN | 0 | 1745 |
| AMF-SHUSHICË | 0 | 331 |

| | | |
|---|---|---|
| AMF-UÇË | 0 | 0 |
| AMF-VERIQ | 0 | 6 |
| AMF-ZALLQ | 0 | 999 |

## KUJDESI PALIATIV

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, shërbimet e kujdesit paliativ janë ofruar në mënyrë të vazhdueshme dhe të organizuar për pacientët me nevoja të veçanta shëndetësore. Kujdesi është realizuar nga dy ekipe profesionale, të cilat kanë funksionuar me orar 12-orësh, duke siguruar mbulim të rregullt të shërbimeve çdo ditë të javës.

Shërbimi i kujdesit shtëpiak ofron kujdes të vazhdueshëm shëndetësor për pacientët që, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore, moshës së shtyrë ose pamundësisë për lëvizje, nuk mund të paraqiten në institucionet shëndetësore. Ky shërbim realizohet përmes vizitave në shtëpi nga ekipet profesionale shëndetësore, duke siguruar kujdes të individualizuar sipas nevojave të pacientit.

Në kuadër të kujdesit shtëpiak ofrohen vlerësimi i gjendjes shëndetësore, monitorimi i parametrave vitalë, administrimi i terapisë së përshkruar, trajtimi dhe pastrami I plagëve, kujdesi për pacientët me sëmundje kronike, kujdesi paliativ, marrja e mostrave për analiza laboratorike sipas nevojës, si dhe edukimi dhe këshillimi i pacientëve dhe familjarëve të tyre. Përmes këtyre shërbimeve synohet ruajtja dhe përmirësimi i gjendjes shëndetësore të pacientëve, parandalimi i komplikimeve dhe rritja e cilësisë së jetës së tyre.

## VIZITAT PËR NËNA DHE FËMIJË (0-3 VJEÇ)

Programi i Vizitave në Shtëpi për Nënat dhe Fëmijët (0–3 vjeç) ka vazhduar zbatimin e aktiviteteve të planifikuara me qëllim promovimin e shëndetit të nënës dhe fëmijës, përmirësimin e kujdesit në periudhën pas lindjes dhe mbështetjen e zhvillimit të hershëm të fëmijës.

Përmes vizitave në shtëpi, ekipet profesionale kanë ofruar këshillim dhe edukim shëndetësor për nënat lidhur me ushqyerjen e fëmijës, vaksinimin, kujdesin higjienik, zhvillimin psiko-fizik të fëmijës, parandalimin e sëmundjeve dhe promovimin e stileve të shëndetshme të jetesës. Gjithashtu, është bërë identifikimi i hershëm i faktorëve të rrezikut dhe nevojave specifike të familjeve, duke siguruar referimin dhe mbështetjen e nevojshme kur ka qenë e nevojshme.

Ky program ka kontribuar në forcimin e kujdesit parësor shëndetësor dhe në përmirësimin e mirëqenies së nënave dhe fëmijëve në komunitet.

| Komuna - ISTOG | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç | 42 | 31 | 46 | 33 | 23 | 40 | | | | | | | **215** |
| Numri i vizitave në shtëpi për shtatzëna | 5 | 4 | 2 | 2 | 0 | 0 | | | | | | | **13** |
| Numri total i vizitave në shtëpi të kryera | 47 | 35 | 48 | 35 | 23 | 40 | | | | | | | **228** |
| Nr. i fëmijëve **vajza** 0-3 vjeç të cilat janë vizituar për herë të parë | 13 | 3 | 17 | 9 | 7 | 8 | | | | | | | **57** |
| Nr. i fëmijëve **djem** 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë | 7 | 2 | 9 | 12 | 7 | 18 | | | | | | | **55** |
| Nr. total i fëmijëve 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë | **20** | **5** | **26** | **21** | **14** | **26** | | | | | | | **112** |
| Numri i vizitave të dyta për fëmijët 0-3 vjeç | 14 | 10 | 14 | 7 | 5 | 11 | | | | | | | **61** |
| Numri i vizitave të treta për fëmijët 0-3 vjeç | 2 | 7 | 3 | 5 | 2 | 2 | | | | | | | **21** |
| Numri i vizitave të katërta për fëmijët 0-3 vjeç | 5 | 7 | 1 | 0 | 1 | 0 | | | | | | | **14** |
| Numri i vizitave të pesta për fëmijët 0-3 vjeç | 1 | 2 | 2 | 0 | 1 | 1 | | | | | | | **7** |
| Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes | 10 | 4 | 12 | 12 | 6 | 14 | | | | | | | **58** |
| Numri i shtatzënave që janë vizituar për herë të parë | 4 | 3 | 2 | 2 | 0 | 0 | | | | | | | **11** |
| Numri i shtatëzënave që kanë pranuar vizitën e dytë | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | **2** |
| Numri i fëmijëve 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë | 5 | 0 | 0 | 2 | 0 | 5 | | | | | | | **12** |
| Numri i grave shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë | 1 | 2 | 2 | 2 | 0 | 0 | | | | | | | **7** |
| Numri i fëmijëve të referuar tek specialistët mjekësor nga ekipi i mjekësisë familjare | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | | | | | | | **2** |
| Numri i vizitave shtesë për fëmijë dhe shtatzëna (Jashtë standardit të programit të vizitave në shtëpi) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | **0** |
| Numri i baballarëve të përfshirë gjatë vizitave në shtëpi | 6 | 9 | 4 | 6 | 3 | 9 | | | | | | | **22** |
| Numri i rasteve sociale të identifikuara dhe të referuar | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | **0** |
| Numri i rasteve të dhunës të identifikuar (nga obzervimi gjatë vizitës në shtëpi) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | **0** |
| Numri i fëmijëve të identifikuar me ngecje në zhvillim dhe të referuar (nga obzervimi gjatë vizitës në shtëpi) | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | | | | | | | **2** |
| Numri i infermierëve që janë angazhuar në zbatimin e vizitave në shtëpi | 7 | 4 | 5 | 6 | 3 | 5 | | | | | | | **30** |

Në muajin nëntor 2025, kemi filluar për herë të parë implementimin e programin GMCD, I cili është një udhëzues ndërkombëtar për monitorimin e zhvillimit të fëmijës (*Guide for Monitoring Child Development*). Ai përdoret si mjet i standardizuar për të ndjekur, vlerësuar dhe mbështetur zhvillimin e fëmijëve nga lindja deri në rreth 3 vjec.
GMCD ndihmon në monitorimin e hershëm të zhvillimit të fëmijës, që është thelbësor për identifikimin paraprak të çrregullimeve apo vonesave në zhvillim, dhe më pas për referimin dhe mbështetjen adekuate të çdo fëmije

| | Treguesi | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Numri total i vlerësimeve të monitorimit të zhvillimit (GMCD) të kryera. | 10 | 6 | 17 | 7 | 4 | 12 | | | | | | | **40** |
| 2 | Numri i vlerësimeve të monitorimit të zhvillimit (GMCD) të kryera (vajza). | 6 | 3 | 6 | 2 | 3 | 6 | | | | | | | **17** |
| 3 | Numri i vlerësimeve të monitorimit të zhvillimit (GMCD) të kryera me fëmijët nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian. | 1 | 0 | 6 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | **6** |
| 4 | Numri i fëmijëve të moshës 4-6 muajsh, zhvillimi i të cilëve është monitoruar përmes GMCD-së (vizita e dytë në shtëpi). | 1 | 0 | 5 | 3 | 0 | 2 | | | | | | | **10** |
| 5 | Numri i fëmijëve të moshës 11-12 muajsh, zhvillimi i të cilëve është monitoruar përmes GMCD-së (vizita e tretë në shtëpi). | 4 | 5 | 5 | 1 | 2 | 5 | | | | | | | **13** |
| 6 | Numri i fëmijëve të moshës 18 muajsh e lart zhvillimi i të cilëve është monitoruar përmes GMCD-së (vizita e 4-të në shtëpi). | 1 | 1 | 4 | 2 | 1 | 2 | | | | | | | **9** |
| 7 | Numri i fëmijëve të moshës 30-36 muajsh, zhvillimi i të cilëve është monitoruar përmes GMCD-së (vizita e 5-të në shtëpi). | 4 | 0 | 3 | 1 | 1 | 3 | | | | | | | **8** |
| 8 | Numri total i fëmijëve të identifikuar me ngecje në një ose më shumë domene të zhvillimit (gjuha, motorika, raportet, loja dhe vetëkujdesi). | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | | | | | | | **1** |
| 8a | Numri i fëmijëve që kërkojnë MBËSHTETJE SHTESË në fushën zhvillimore të gjuhës (shprehëse ose receptive). | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | | | | | | | **1** |
| 8b | Numri i fëmijëve që kërkojnë MBËSHTETJE SHTESË në fushën zhvillimore të motorikës (lëvizjeve) së madhe dhe fine. | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | **0** |
| 8c | Numri i fëmijëve që kërkojnë MBËSHTETJE SHTESË në fushën zhvillimore të raporteve (lidhjeve). | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | **0** |
| 8d | Numri i fëmijëve që kërkojnë MBËSHTETJE SHTESË në fushën zhvillimore të vetëndihmës. | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | **0** |
| 9 | Numri i familjeve të identifikuara me një ose më shumë rrezige shëndetësore. | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | **0** |
| 10 | Numri i familjeve të identifikuara me një ose më shumë rrezige psikosociale. | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | | | | **0** |
| 11 | Numri i fëmijëve të referuar tek mjeku familjar për vlerësim të mëtejshëm. | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | | | | | | | **1** |

## HEMODIALIZA

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) ofron shërbim të rregullt të transportit për qytetarët që marrin trajtim me hemodializë në Spitalin e Përgjithshëm të Pejës. Ky shërbim është organizuar me qëllim lehtësimin e qasjes në trajtim për pacientët me insuficiencë renale kronike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

Transporti ofrohet tri herë në javë, konkretisht në ditët:

- E martë,
- E enjte,
- E shtunë,

dhe realizohet në tri orare të ndryshme të nisjes, sipas nevojave të pacientëve që ndjekin seancat e hemodializës:

- Ora 06:00,
- Ora 11:30,
- Ora 16:00.

Ky shërbim organizohet në bashkëpunim me ekipin përkatës të transportit të QKMF-së dhe në koordinim me Spitalin e Pejës, duke siguruar një qasje të sigurt, të rregullt dhe të përshtatur me oraret e terapive për pacientët.

Aktualisht janë  6 pacientë, të cilëve iu sigurohet transporti për në Repartin e Hemodializës.

## BARNATORJA QËNDRORE E QKMF-së

Barnatorja qendrore e QKMF-së luan një rol kyç në funksionimin e shërbimeve shëndetësore, duke siguruar furnizimin e të gjitha njësive përbërëse (ambulancave, shërbimeve të mjekësisë familjare, urgjencës dhe patronazhës) me terapi medikamentoze dhe material shpenzues mjekësor të nevojshëm për ofrimin e kujdesit cilësor.

Përveç furnizimit të brendshëm, barnatorja ofron edhe:

- Terapi për pacientët që paraqiten në QKMF, sipas përshkrimeve mjekësore;
- Shpërndarje të insulinës për qytetarët me diabet, duke u siguruar që pacientët të kenë qasje të rregullt dhe të sigurt në këtë terapi jetike.

Furnizimi dhe shpërndarja kryhen në mënyrë të kontrolluar dhe të dokumentuar, në përputhje me protokollet standarde dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë, duke kontribuar në ruajtjen e vazhdimësisë së kujdesit dhe përdorimin racional të barnave.

| Janar-Shkurt | | Shkurt -Mars | | Mars-Prill | | Prill-Maj | | Maj-Qershor | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Barna | Material shpenzues | Barna | Material shpenzues | Barna | Material shpenzues | Barna | Material Shpenzues | Barna | Material Shpenzues |
| | | | | | | | | | |
| 49.6 % | 60.10% | 51.9 % | 80.0% | 53.48% | 83.33% | 52.17% | 79.31 % | 49.56 % | 75.86 % |

# RAPORTI I INSULINAVE

| Muajt | PACIENTAT | ANALOG INSULINE ME VEPRIM TE SHPEJT (Novorapid) | ANALOG INSULINE ME VEPRIM TE ZGJATUR (Levemir) | ANALOG INSULINE BIFAZIKE ME VEPRIM TE MESEM DHE TE SHPEJTE (Novomix) | INSULINE ME VEPRIM TE SHKURTER insuline e tretshme (Gensulin R) | INSULINE BIFAZIKE ISOPHANE 25-30/70-75 (insuline e tretshme25%- 30% + insuline isophane 70%-75%) (Gensulin M) | INSULINE ME VEPRIM TE NDERMJETEM insuline isophane (Bazal) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 241 | 257 | 173 | 915 | | | |
| Shkurt | 215 | 255 | 165 | 810 | | | |
| Mars | 236 | 283 | 188 | 872 | | | |
| Prill | 244 | 285 | 188 | 909 | | | |
| Maj | 224 | 242 | 158 | 825 | | | |
| Qershor | 240 | 283 | 181 | 892 | | | |
| Korrik | | | | | | | |
| Gusht | | | | | | | |
| Shtator | | | | | | | |
| Tetor | | | | | | | |
| Nëntor | | | | | | | |
| Dhjetor | | | | | | | |

## VAKSINIMI DHE IMUNIZIMI

Shërbimi i vaksinimit dhe imunizimit ka funksionuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës raportuese, në përputhje me kalendarin kombëtar të vaksinimit të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë. Ky shërbim është realizuar në kuadër të QKMF-së dhe ka përfshirë:

- Vaksinimin e fëmijëve sipas skemës së paraparë të imunizimit (0–18 vjeç), duke përfshirë vaksinat kundër sëmundjeve ngjitëse si tuberkulozi, poliomieliti, difteria, tetanusi, hepatiti B, fruthi, parotiti, rubeola, etj.;

- Vaksinimin e të rriturve në raste të veçanta, përfshirë gratë shtatzëna, të moshuarit, dhe persona me sëmundje kronike, në përputhje me udhëzimet përkatëse;
- Menaxhimin dhe ruajtjen e zinxhirit të ftohjes për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e vaksinave;
- Regjistrimin elektronik të vaksinimeve në sistemin e informacionit shëndetësor, si dhe ndjekjen e fëmijëve me vaksina të vonuara ose të paplotësuara.

Vaksinimi dhe imunizimi ofrohet në QKMF-Istog dhe në katër QMF-të.

| | Numri i vaksinave | Numri i shërbimeve |
|---|---|---|
| QKMF-Istog | 2707 | 5793 |
| QMF-Banjë | 476 | 936 |
| QMF-Vrellë | 521 | 1024 |
| QMF-Gurrakoc | 476 | 956 |
| QMF-Rakosh | 347 | 604 |
| GJITHSEJ | 4527 | 9313 |

Gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportojmë, janë aplikuar gjithsej:
64- Serum AntiTetanik -për parandalimin e tetanosit
1- Serume AntiViperik-aplikohet pas kafshimit nga gjarpinjët
8-Vaksina AntiRabike- për parandalimin e tërbimit (rabies), pas kafshimit nga kafshë të dyshuara për të qenë të infektuara

## SHËNDETI MENDOR

Në kuadër të QKMF-së, është funksional edhe shërbimi për shëndetin mendor, me qëllim të ofrimit të kujdesit për individët me çrregullime mendore, emocionale apo vështirësi të tjera psikologjike.

Në këtë kuadër, çdo të dytën javë viziton QKMF-në mjeku specialist neuropsikiatër, i cili ofron:

- Aplikim të psikoterapisë individuale, në varësi të gjendjes dhe nevojës së pacientit;
- Përshkrim të terapisë medikamentoze, si dhe përcjellje të rregullt të gjendjes së pacientëve.

Përmes buxhetit komunal është bërë furnizimi me ampulla Halldol (Haloperidol) dhe Moditen (Fluphenazine), të cilat përdoren në trajtimin e çrregullimeve të shëndetit mendor. Këto barna

antipsikotike ndihmojnë në stabilizimin e gjendjes psikike të pacientëve, duke ulur simptomat si halucinacionet, deluzionet dhe sjelljet e pakontrolluara. Në rastet kur përmes buxhetit komunal nuk jane siguruar këto injeksione, Qendra e Shëndetit Mendor në Pejë, i ka sjellë me vete nga stoku i tyre.

Gjatë periudhës janar–qershor 2026 në kuadër të shërbimeve të shëndetit mendor në QKMF, janë realizuar vizita specialistike sipas planifikimit vjetor. Mjeku specialist i shëndetit mendor (neuropsikiatër) vjen rregullisht çdo të tretën javë( cdo të tretën të marte), në cilësinë e konsulentit, ku kryhen vizita specialistike dhe aplikohen terapitë medikamentoze intramuskulare dhe ofrohen këshilla.

Në këtë periudhë, janë realizuar gjithsej 34 vizita specialistike nga mjeku neuropsikiatër Dr. Nysret Pepaj.

| Data e vizitës | Nr.pacientëve | Amp.Moditen | Amp.Haloperidol |
|---|---|---|---|
| 13.01.2026 | 20 | 3 | 17 |
| 24.02.2026 | 26 | 3 | 23 |
| 17.03.2026 | 11 | 2 | 9 |
| 28.04.2026 | 24 | 2 | 22 |
| 19.05.2026 | 13 | 3 | 10 |
| 09.06.2026 | 23 | 3 | 20 |
| 30.06.2026 | 23 | 2 | 21 |

## AKTIVITETET E SHËNUARA PËR PROMOVIM SHËNDETËSOR

Janar, 2026 -Java e Ndërgjegjësimit të kancerit të qafës së mitrës, kemi shenuar me aktivitete dhe ligjerata me stafin dhe grupe të ndryshme të shoqërisë, me qellim të vetëdijësimit për rëndësinë e prevenimit të hershëm të sëmundjes dhe rëndësinë e vaksinës HPV.
Mars, 2026- Java Botërore e Shëndetit Oral, është shënuar me aktivitete vetëdijesuese për fëmijët nga ekipet e stomatologjisë
Prill, 2026 -Java Botërore e Shëndetit, me aktivitete me nxënësit e shkollës në Istog, ata realizuan vizitë në repartin pediatrik, ku morën këshilla për ruajtjen e shëndetit.
Maj, 2026-Java Evropiane e Imunizimit, e shënua këtë javë me promovimin e vaksinimit si masë preventive e shumë sëmundjeve dhe vaksinimin e fëmijëve sipas vaksinave të kalendarit të rregullt.
12 Maj, 2026-Dita Botërore e Infermierisë, në qendrën e qytetit ishin ekipi me infemier nga QKMF, të cilët ofruan këshilla shëndetësore, matjen e glikemisë dhe tensionit arterial.
17 Maj, 2026-Dita Botërore e Hipërtenisonit, kemi organizuar aktivitet në qendren e qytetit, matjen e tensionit arterial, ofrimn e këshillave rreth ushqyerjes dhe aktivitetit fizik për menaxhim të tensionit arterial.
31 Maj, 2026-Karvani shëndetësor përSHËNDETje, ishte ne Istog, I organizuar falë bashkëpunimit mes QKMF-së dhe organizatave si AQH e Syri Vizion.

31 Maj, 2026- Dita Botërore Pa Duhan, kemi shënuar fushatë vetëdijësuese me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, shpërndarjen e broshurave informative.
Qershor, 2026 -Java Botërore kundër abuzimit dhe trafikimit të drogave, është shënuar me aktivitete vetëdijesue

## VIZITAT SISTEMATIKE NË SHKOLLAT

Gjatë periudhës 04.05.2026 – 29.05.2026 është realizuar me sukses Programi i Vizitave Sistematike Shëndetësore në të gjitha institucionet arsimore të Komunës së Istogut. Vizitat sistematike kanë për qëllim:

1. Zbulimin e hershëm të problemeve shëndetësore – identifikohen çrregullime fizike, shqisore (si dëgjimi dhe shikimi), rritja jonormale apo sëmundje kronike.
2. Monitorimin e rritjes dhe zhvillimit – mjekët dhe infermierët shikojnë parametrat si pesha, gjatësia, dhe zhvillimi pubertal për të siguruar që fëmijët po rriten normalisht.
3. Promovimin e shëndetit – fëmijët dhe prindërit marrin këshilla për ushqyerjen e shëndetshme, higjienën, aktivitetin fizik dhe mënyrën e jetesës pa rreziqe (si duhani, droga, etj.).
4. Edukimi dhe promovimi i shëndetit oral

Gjatë zbatimit të këtij programi janë përfshirë:

- 284 fëmijë të institucioneve parashkollore;
- 2,282 nxënës të klasave I–V të shkollave fillore.

Për realizimin me sukses të këtij procesi me rëndësi të veçantë për shëndetin publik janë angazhuar gjithsej 43 profesionistë shëndetësorë, përkatësisht:

- 5 specialistë të mjekësisë familjare;
- 6 doktorë të mjekësisë;
- 6 stomatologë;
- 19 infermierë;
- 7 asistentë dentarë.

Stafi mjekësor ka evidentuar dhe diagnostikuar një numër fëmijësh me probleme të ndryshme shëndetësore, ndër të cilat kanë dominuar infeksionet dhe sëmundjet e traktit respirator, rastet me anemi,

gjendjet febrile (temperaturë të ngritur), çrregullimet e qëndrimit trupor me dyshime për deformime të boshtit kurrizor, si dhe raste me pedikulozë (prani të morrave të kokës).Nga ekzaminimet stomatologjike është konstatuar një prevalencë e lartë e kariesit dentar, si dhe mungesë e higjienës së rregullt orale te një numër i konsiderueshëm i fëmijëve.

Gjetjet nga këto vizita tregojnë nevojën për vazhdimin e aktiviteteve parandaluese, edukimit shëndetësor dhe bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet QKMF-së, institucioneve arsimore dhe prindërve. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet promovimit të higjienës personale dhe orale, përmirësimit të zakoneve të shëndetshme, zbulimit të hershëm të deformimeve të sistemit muskuloskeletal, si dhe trajtimit në kohë të sëmundjeve dhe çrregullimeve të evidentuara.

## PARTICIPIMI

Gjatë periudhës gjashtëmujore, në QKMF është zbatuar në mënyrë të rregullt procesi i arkëtimit të participimit, në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet në fuqi. Pagesat e participimit janë realizuar për shërbimet shëndetësore për të cilat parashihet pagesë, ndërsa kategoritë e qytetarëve të liruara nga participimi kanë përfituar shërbimet sipas kritereve të përcaktuara me aktet përkatëse.

Të hyrat nga participimi janë evidentuar dhe raportuar në mënyrë të rregullt, duke respektuar procedurat financiare dhe administrative.

Pasqyra e të hyrave financiare te QKMF-së

| | Pershkrimi sherb. | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Sporteli I M.F.Istog | 556 | 395 | 426 | 359 | 243 | | | | | | | | 1979.0 |
| 2 | Sporteli I M.F.-Pasdite | | 38 | | 196 | 338 | | | | | | | | 572.0 |
| 3 | Lidhtorja | 458 | 65 | 261.5 | 135.5 | 165 | | | | | | | | 1085.0 |
| 4 | R.T.G. Istog | 322 | 205 | 282 | 297 | 226 | | | | | | | | 1332.0 |
| 5 | Laboratori | 366 | 336 | 214 | 252 | 186 | | | | | | | | 1354.0 |
| 6 | Kujdestaria -Albin Osmanaj | 413 | 370 | 167 | 366 | 465 | | | | | | | | 1781.0 |
| 7 | Kujdestaria -Edin Halilovic | 620.5 | 372.9 | 626 | 487 | 377.5 | | | | | | | | 2483.9 |
| 8 | Kujdestaria -Flamur Nikqi | 733 | 451 | 496 | 324 | 334 | | | | | | | | 2338.0 |
| 9 | Kujdestaria -Tahir Tafilaj | 893 | 538 | 471.5 | 525 | 404 | | | | | | | | 2831.5 |
| 10 | Gjinekologjia | | | | | 122 | | | | | | | | 122.0 |
| 11 | Interno Dr.Xhevati | 278 | 240 | 325 | 226 | 74 | | | | | | | | 1143.0 |
| 12 | Lidhtorja | | | | | | | | | | | | | 0.0 |
| 13 | Farmaci | | | | | | | | | | | | | 0.0 |
| | **Totali QKMF** | | | | | | | | | | | | | 0.0 |
| 1 | QMF.Banjë | 158 | 89 | 114 | 128 | | | | | | | | | 489.0 |
| 2 | Lidhtorja | 100 | 65.5 | 31.5 | 66 | 32.5 | | | | | | | | 295.5 |
| 3 | QMF.Rakosh | 60 | 96 | 63 | 46 | | | | | | | | | 265.0 |
| 4 | Lidhtorja | 33 | 33 | 33 | 66 | 39 | | | | | | | | 204.0 |
| 5 | QMF.Vrellë | 68 | 43 | 45 | 41 | 60 | | | | | | | | 257.0 |
| 6 | Lidhtorja | 33 | 33 | 33 | 65.5 | 68 | | | | | | | | 232.5 |
| 7 | QMF.Gurrakoc | 71 | 131 | 64 | 49 | 51 | | | | | | | | 366.0 |
| 8 | Lidhtorja | | 37 | 65 | | | | | | | | | | 102.0 |
| | **Totali QMF& AMF** | | | | | | | | | | | | | 0.0 |
| 1 | Stomatologji - Dr Hyrije | 48 | 37 | 47 | 51 | 28 | | | | | | | | 211.0 |
| 2 | Stomatologji - Dr.Fahrija | 44 | | 11 | 48 | 11 | | | | | | | | 114.0 |
| 3 | Stomatologjia Banjë | | | 5 | 5 | | | | | | | | | 10.0 |
| 4 | Stomatologjia Rakosh | | 12 | | 14 | 12 | | | | | | | | 38.0 |
| 5 | Stomatologjia Gurrakoc | 4 | 9 | | 10 | 15 | | | | | | | | 38.0 |
| 6 | Stomatologjia Vrellë | | 7 | 17 | 8 | 14 | | | | | | | | 46.0 |
| | **Totali Stomatolgji** | | | | | | | | | | | | | 0.0 |
| 3 | Qertifikata Shënd & Pagesa tjera | 540 | 215.0 | 235.0 | 255.0 | 195 | | | | | | | | 1440.0 |
| | **Gjithsejt te Hyrat** | **5798.5** | **3818.4** | **4032.5** | **4020** | **3460** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **21129.4** |

## Sfidat e QKMF-së

1. Mungesa e infrastrukturës në QKMF Istog
   Hapësirat ekzistuese nuk i plotësojnë nevojat për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Me fillimin e sezonit veror vërehet rritje e numrit të pacientëve që kanë nevojë për terapi intravenoze, gjë që kërkon shtim të kapaciteteve, përkatësisht rritje të numrit të shtretërve për trajtimin dhe monitorimin e pacientëve.
2. Riorganizimi i ofrimit të shërbimeve sipas zonës së banimit
   Nevojitet zbatimi i sistemit të zonimit, në mënyrë që secili pacient t'i marrë shërbimet shëndetësore në qendrën që mbulon zonën e tij/saj të banimit. Kjo do të mundësonte shpërndarje më të barabartë të fluksit të pacientëve ndërmjet qendrave, ulje të mbingarkesës në QKMF Istog, shfrytëzim më efikas të kapaciteteve ekzistuese dhe përmirësim të qasjes së pacientëve në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor.
3. Nevoja për shtimin e stafit teknik dhe mbështetës
   Për shkak të rritjes së vëllimit të punës dhe nevojës për mirëmbajtje efikase të objekteve dhe shërbimeve, kërkohet shtimi i stafit teknik dhe mbështetës, përfshirë mirëmbajtës, pastrues dhe shoferë.
4. Nevoja për ofrimin e shërbimeve gjinekologjike
   Ka kërkesë të vazhdueshme nga pacientet për shërbime gjinekologjike në kuadër të QKMF-së. Sigurimi i këtij shërbimi do të zvogëlonte nevojën për referime në institucione të tjera.
5. Nevoja për shtimin e autoambulancave
   Për shkak të rritjes së kërkesave për transport dhe ofrimin e shërbimeve shëndetësore në terren, ekziston nevoja për sigurimin e të paktën edhe dy autoambulancave.

***DREJTORIA PER PUNE DHE MIREQENIE SOCIALE***
***RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026***

*Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka vazhduar angazhimin e saj në ofrimin e shërbimeve sociale për qytetarët, duke trajtuar me përgjegjësi dhe efikasitet kërkesat e paraqitura nga qytetarët. Në këtë periudhë janë adresuar gjithsej 340 kërkesa të natyrës sociale, të cilat janë shqyrtuar dhe trajtuar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kompetencat e drejtorisë. Ky raport paraqet aktivitetet kryesore të realizuara gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë pranimin dhe trajtimin e kërkesave, ofrimin e mbështetjes për kategoritë në nevojë, bashkëpunimin me institucionet përkatëse, si dhe zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive që i takojnë Drejtorisë së Mirëqenies Sociale. Përmes këtyre aktiviteteve është synuar përmirësimi i mirëqenies sociale të qytetarëve, garantimi i qasjes së barabartë në shërbime dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme për familjet dhe individët që kanë nevojë për asistencë sociale.*
*Në vazhdim të këtij raporti paraqiten në mënyrë të detajuar aktivitetet dhe punët kryesore të realizuara nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale gjatë periudhës janar–qershor 2026. Gjatë kësaj periudhe, drejtoria ka zhvilluar një sërë aktivitetesh në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e saj ligjore, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve sociale cilësore, mbështetjen e kategorive në nevojë, trajtimin e kërkesave të qytetarëve, bashkëpunimin me institucionet relevante, si dhe zbatimin e programeve dhe projekteve me karakter social. Aktivitetet e paraqitura më poshtë pasqyrojnë angazhimin e vazhdueshëm të Drejtorisë në përmbushjen e misionit të saj dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të Komunës së Istogut.*

- *Ofrimi i shërbimeve logopedike, psikologjike dhe sociale për fëmijët me nevoja të veçanta*

*Ofrimi i shërbimeve logopedike , psikologjike dhe sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta është një proces gjithëpërfshirës dhe shumëdimensional që synon mbështetjen e zhvillimit të tyre dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Drejtoria e Mirëqenies Sociale në Komunën e Istogut vazhdon angazhimin e saj në ofrimin e shërbimeve profesionale për fëmijët me nevoja të veçanta, duke përfshirë shërbime logopedike, psikologjike dhe sociale. Këto shërbime kanë për qëllim mbështetjen e zhvillimit të hershëm të fëmijëve, përmirësimin e aftësive të tyre komunikuese, emocionale dhe sociale, si dhe lehtësimin e integrimit të tyre në jetën e përditshme dhe në mjedisin shkollor. Aktualisht, 15 fëmijë nga Komuna e Istogut përfitojnë shërbime të rregullta ditore logopedike, psikologjike dhe sociale, të cilat ofrohen falas nga profesionistët e fushave përkatëse*

- *Qendra e qendrimit ditor për pensionistët në Istog*

*Qendra e qëndrimit ditor për pensionistët në Istog ofron një hapësirë të dedikuar për të moshuarit, ku organizohen aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe rekreative. Aty ofrohen falas proukte si qaji kafja dhe embelsira per te moshuarit tanë. Kjo qendër ka një rëndësi të veçantë për komunitetin, pasi u mundëson pensionistëve të kalojnë kohën në mënyrë aktive, të shoqërohen me njëri-tjetrin dhe të ndihen të vlerësuar. Aktivitetet e organizuara ndihmojnë në ruajtjen e shëndetit mendor dhe fizik të pjesëmarrësve, duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.*

- *Subvencionimi i Shtepisë së Sigurtë ne vlerë prej 4.000 euro.*

*Femrat që përjetojnë dhunë në familje strehohen për një periudhë të caktuar në strehimoren në Pejë. Drejtoria e Mirëqenies Sociale siguron subvencion vjetor në vlerë prej 4,000 €, me qëllim mbështetjen dhe sigurimin e kushteve të nevojshme për qëndrimin e tyre.*

- *Subvencionimi i Familjeve Strehuse në vlerë prej 1500 euro*

*Me qëllim ruajtjen dhe trajtimin adekuat të familjeve strehuse, Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka katër familje strehuse. Këto familje kanë qenë gjithashtu me prioritet në mbështetjet e tjera që kemi ofruar për qytetarët e komunës së Istogut.*

- *Subvencionimi i nënave vetëushqyese në vleren prej 500€*

*Qëllimi kryesor i subvencionimit është përmirësimi i kushteve ekonomike dhe sociale, si dhe fuqizimi i këtyre nënave për t'u përballur më mirë me sfidat e përditshme.*

- *Realizimi i pagesave të qerasë*

*Aktualisht, kemi mbi 10 pagesa qeraje për familjet në kushte të rënda ekonomike, duke iu dhënë përparësi femrave që përjetojnë dhunë në familje, në përputhje me Planin Trevjeçar të Banimit Social.*

- *Shpërndarja e pakove ushqimore*

*Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka shpërndarë rreth 400 pako ushqimore dhe higjienike për familjet që gjenden në kushte të vështira ekonomike, me qëllim mbështetjen e tyre në përballimin e nevojave bazë.*

- *Inspektimet javore në Shtepinë e të Moshuarve në Gurrakoc.*

*Një praktikë shumë e rëndësishme për të siguruar cilësinë e kujdesit dhe mirëqenien e rezidentëve janë inspektimet javore në shtëpinë e të moshuarve. Këto inspektime synojnë që të mbikqyrin standartet e shërbimeve, të adresojnë sfidat dhe të promovojnë një mjedis të sigurtë dhe të përshtatshëm për të moshuarit.*

- *Sigurimi i ambientit më miqësor dhe të përshtatshem për femijet në dhomen e kontaktimeve në Qendren për Punë Sociale.*

*Dhoma e kontaktimeve në Qendren për Punë Sociale është rregulluar dhe pershtatur për të ofruar një ambient të sigurt, të rehatshem dhe miqësor për fëmijet gjatë kontaktimit me prinderit e tyre. Kjo dhomë është paisur me mjete didaktike , lodra dhe paisje tjera rekreative për të siguruar një ambient me miqësor per femijet.*

- *Aktitvitete periodike me të moshuarit në shtëpinë për Komunitete në Gurakoc.*

*Drejtoria e Mirëqenies Sociale vazhdon të jetë e përkushtuar në sigurimin e kushteve sa më të mira dhe të favorshme për rezidentet në Shtëpinë e Komuniteteve në Gurakoc. Me qëllim të promovimit të mirëqenies fizike, emocionale dhe sociale të tyre, organizohen vazhdimisht aktivitete periodike, si: shëtitje rekreative, dreka të përbashkëta, piknike në natyrë dhe aktivitete të ndryshme sociale.*

*Po ashtu, realizohen aktivitete ndërbrezore, të cilat krijojnë mundësi për bashkëpunim dhe ndërveprim mes të moshuarve dhe gjeneratave të reja, duke nxitur respektin e ndërsjellë, përfshirjen sociale dhe forcimin e lidhjeve në komunitet.*

Qëndra Për Punë Sociale – Istog

| | Lloji i shërbimit | Nr i rasteve | Përshkrimi Shërbimeve të ofruara në Sektorin e Shërbimeve Sociale |
|---|---|---|---|
| 1. | Fëmijë të braktisur | 1 | Përcaktimi i kujdestarit ligjor, vendosja në strehim familjar, ndihmat e përgjithshme për familjet strehuese dhe për fëmijë, puna me familjen biologjike, regjistrimi i fëmijës në LAL, puna me familjen potenciale adoptuese, etj. |
| 2. | Adoptim | 0 | Adoptimi është një aspekt i mbrojtjes së fëmijës, vlerësimi i familjes për adoptim dhe monitorimi i fazës para adoptuese |
| 3. | Keqtrajtim i fëmijës | 5 | Këshillim psiko-social me familje |
| 4. | Strehim familjar në familje strehuese | 1 | Ofrimi i strehimit fëmijëve të braktisur dhe të lënë pas dore dhe përcjellja e trajtimit të fëmijëve në familje strehuese |
| 5. | Strehim familjar tek të afërmit | 0 | Ofrimi i strehimit tek familja e gjerë dhe përcjellja e zhvillimit dhe trajtimit të tyre |
| 6. | Kujdestaria për të mitur | 1 | Fëmijës pa kujdes prindëror i caktohet kujdestari ligjor |
| 7. | Fëmijë me aftësi të kufizuar të plotë | 12 | Kompletimi i dokumentacionit, pas vlerësimit të komisionit mjekësor pozitivisht për kërkesën ofrohet pagesa përkatëse si dhe monitorimi i Qendrës Ditore për FAKP dhe udhëzimet e nevojshme |
| 8. | Braktisje e shkollës | 0 | Bashkëpunimi shkollë – prind – fëmijë si dhe këshillime për të gjitha këto në interes më të mirë të fëmijëve |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 9. | Fëmijë me vështirësi në sjellje | 12 | Këshillime psiko-sociale për të mitur |
| 10. | Të mitur në konflikt me ligjin | 18 | Këshillim dhe ofrim i shërbimit përkatës për referim në institucionet relevante |
| 11. | Martesa e të miturve | 1 | Vlerësimi i pjekurisë emocionale të të miturve të cilët dëshirojnë të hyjnë në martesë si dhe referimi në institucionet tjera. |
| 12. | Ikje nga shtëpia | 1 | Këshillim psiko-social, rikthim në familje dhe përcjellja e zhvillimit të përgjithshëm të të miturit |
| 13. | Besim i fëmijës | 16 | Besimi i fëmijës kërkohet nga Gjykata që Organi i Kujdestarisë të jap mendimin se cili është interesi më i mirë i fëmijës, se cilit t'i besohet, realizohen vizita në familje rreth identifikimit të kushteve ekonomike dhe sociale të të dy prindërve. |
| 14. | Kontaktime | 8 | Me vendim të Gjykatës ku specifikohet që kontaktimet të mbahen dhe përcillen në QPS. |

Komuna e Istogut ka përmbushur standardet minimale dhe ka arritur të ketë gjithsej 4 familje strehuese të cilat që për momentin kanë 18 fëmijë të strehuar. Gjatë këtij gjashtëmujori kemi pasur një fëmijë te braktisur si dhe një familje strehuese të re.
Në vazhdimësi kemi realizuar vizita në familje për të monitoruar kujdesin që i'u ofrohet fëmijëve të strehuar aty.
Për nder të ditës së Familjes kemi vizituar familjet me që rast të gjithë fëmijët kanë përfituar dhurata si dhe është mbajtur Tryeza në bashkëpunim me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, Drejtorinë e Administratës Publike - Sektorin e Barazisë Gjinore dhe Familjet Strehuese.
Nga Komuna e Istogut, familjet strehuese kanë përkrahje të vazhdueshme në forma të ndryshme.

RAPORT PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2026 NË SHËRBIMET SOCIALE

Institucioni i Qendrës për Punë Sociale në kuadër të Drejtoratit për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut, gjegjësisht sektori i Shërbimeve Sociale ka ofruar shërbime për qytetarë të kategorive të ndryshme, drejtëpërdrejtë si dhe me aktivitete të shumta duke bashkëpunuar me zingjirin e institucioneve, të cilat e kanë objektiv mirëqenien e fëmijëve, të rriturve si dhe të moshuarve.

| | Lloji i shërbimit | Numri i rasteve | Përshkrimi i Shërbimeve të ofruara në sektorin e Shërbimeve Sociale |
|---|---|---|---|
| 1 | Fëmijë të braktisur | 1 | *Përcaktimi i kujdestarit ligjor, vendosja ne strehim familjar, ndihmat e pergjithshme per familjet strehuese dhe per femijet.* |
| 2 | Adoptim | 0 | *Adoptimi është një aspekt i mbrojtjes së femijës, vlerësimi i familjës për adoptim dhe monitorimi fazës paraadoptuese.* |
| 3 | Keqtrajtim i fëmijës | 5 | *Keshillim psiko-social me familje* |
| 4 | Strehim familjar tek familja strehuese | 1 | *Ofrimi i strehimit femijëve të braktisur dhe të lënë pas dore dhe percjellja e trajtimit të fëmijëve në familje strehuese.* |
| 5 | Strehim familjar tek të afërmit | 0 | *Ofrim i strehimit tek familja e gjerë dhe percjellja e zhvillimit dhe trajtimit të tyre.* |
| 6 | Kujdestaria për të mitur | 1 | *Fëmija pa kujdes prindëror duhet të* |

Pergjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2026 llojet e shërbimeve që janë ofruar nga sektori i Sherbimeve Sociale janë të shumta dhe ne gjithmonë jemi në dispozicion, duke përfshirë edhe Organin e Kujdestarisë i cili është 24 orë nën shërbimin e qytetarëve në nevojë.
Në tabelën në vijim janë të paraqitura shërbimet dhe numri total për secilën nga to si dhe përshkrimi i Shërbimeve të ofruara.

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | *ketë një kujdestar ligjor.* |
| 7 | Fëmijë me aftësi të kufizuar të plotë ( FAKP) | 12 | *Kompletimi i dokumentacionit, pas vleresimit të komisionit mjekësor percjellet mundesimi i marrjes së pagesës perkatëse si dhe monitorimi i Qendrës Ditore për FAKP dhe udhëzimet e nevojshme.* |
| 8 | Braktisje e shkollës | 0 | *Bashkëpunimi me shkolla, me prindër me fëmijë si dhe këshillime për të gjitha keto ne interes me të mirë të fëmijëve.* |
| 9 | Fëmijë me vështirësi ne sjellje | 12 | *Keshillime psiko-sociale, të miturit gjithashtu.* |
| 10 | Të miturit në konflikt me ligjin | 16 | *Këshillim dhe ofrim i shërbimit perkatës për referim në institucionet relevante.* |
| 11 | Martesa e të miturëve | 1 | *Vleresimi i pjekurisë emocionale të të mitureve të cilët deshirojnë të hyjnë në martesë si dhe referimi në institucionet tjera.* |
| 12 | Ikje nga shtëpia | 1 | *Këshillim psiko-social dhe bashkim familjar dhe përcjellja e zhvillimit të pergjithshëm të të miturit.* |
| 13 | Këshilla martesore | 24 | *Organizimi i seancave të pajtimit të bashkeshorteve me objektiv të pajtimit të tyre.* |
| 14 | Besimi i fëmijës | 16 | *Besimi i femijëve bëhet pasi pajtimi bashkëshortor nuk është arritur dhe vlerësohet lidhja e fëmijës me prindin si dhe kujdesi i prindit ndaj fëmijës. Vizita në terren me qellim të identifikimit të kushteve ekonomike dhe sociale të dy prindërve dhe të përcaktohet cili është interesi më i mirë i fëmijës dhe të jepet mendimi me cilin prind fëmiu ambientohet me mirë.* |
| 15 | Kontaktime | 8 | *Me vendim të gjykatës ku specifikohet që kontaktimi të mbahet në lokalet e QPS- së, ne i percjellim që keto kontaktime të realizohen në rrethana sa me të mira.* |
| 16 | Pjesëmarrja gjatë intervistimit ne polici | 91 | *Ne si Organ i Kujdestarisë jemi të obliguar që t'i mbrojmë interesat e fëmijës gjatë interevisimit të tyre në polici. Gjithashtu gjatë intervistimit të* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | *viktimave të dhunës, ne marrim pjesë për mbeshtetje dhe këshillim të viktimës për me tutje.* |
| 17 | Viktimat e dhunës ne familje | 13 | *Pasi jemi njoftuar me viktimën i ndërmarrim hapat si ne vijim: vendosja në strehimore (sipas nevojës), pjesëmarrja gjatë marrjes së rrobave në shtëpi me shoqerimin e policisë, organizojmë bashkimin e nënës me fëmijën në rast se fëmija ka mbetur i ndarë nga nëna, këshillim psiko- social, ofrojmë pagesë për banim social të vktimave të dhunës, i ndihmojmë rreth punësimit të viktimës, i ndihmojmë rreth perfshirjës së fëmijëve në institucionet parashkollore, si dhe ofrimi i pakove ushqimore.* |
| 18 | Konflikt familjar | 4 | *Këshillim psikosocial për zgjidhje të konflikteve mes antarëve të familjes.* |
| 19 | Ngacmim seksual | 2 | *Prezenca në seanca gjygjësore dhe këshillim si dhe percjellja e viktimës.* |
| 20 | Caktim i kujdestarit te përkohshëm | 1 | *Për nevojat gjygjësore me intervistimin e antarëve të familjes caktohet një kujdestar.* |
| 21 | Person me problem te shendetit mendor | 0 | *Ndihmë e përgjithshme për klientin si dhe vendosja në strehim rezidencial.* |
| 22 | Strehim rezidencial | 1 | *Kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe sipas pranimit të antarëve të komisionit të rregullorës bazë, vizitat e rregullta në shtëpi.* |
| 23 | Vertetim per zotesi te veprimit | 115 | *Në bazë të dëshmise të siguruar nga Gjykata. Ne i lëshojmë vërtetimin që nuk i'u ka marrë zotësia e veprimit për armëmbajtje.* |
| 24 | Konstatim per lirim nga shtetesia | 7 | *Ne bazë të dokumentacionit që posedon QPS, e që nuk ka të caktuar alimentacion për fëmijët e tij e lëshojmë vërtetimin për lirim nga shtëtësia* |
| 25 | Vertetim per marrje shtetësie | 49 | *Ne bazë të dokumentacionit që posedon QPS, vërteton që pala posedon mjete të mjaftueshme materiale për jetesë.* |
| 26 | Qertifikatë per punësim | 26 | *Në bazë të dëshmise të siguruar nga* |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | *Gjykata. Ne i lëshojmë vërtetimin që nuk i'u ka marrë zotësia e veprimit për punësim.* |
| 27 | Konstatime të ndryshme | 5 | *Qendra për punë Sociale sipas nevojave të ndryshme lëshon edhe konstatime të ndryshme.* |

*ASISTENCA SO C I A L E*

RAPORTI GJASHTËMUJOR 2026 NE ASISTENCEN SOCIALE

*Raporti për gjashtëmujorin e parë*

*Ky raport prezanton raportin e punëve të kryera gjatë periudhes Janar-Qershor nga sektori i Asistencës Sociale.*

Gjatë periudhës Janar–Qershor 2026, Qendra për Punë Sociale ka luajtur rol të rëndësishëm në trajtimin e rasteve sociale dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe familjet në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale. Në këtë periudhë është punuar me përkushtim në identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rasteve sociale, me qëllim ofrimin e mbështetjes së nevojshme për kategoritë më të cenueshme të shoqërisë.

Ky raport pasqyron punën e realizuar gjatë kësaj periudhe, si dhe angazhimin e vazhdueshëm të stafit në trajtimin e rasteve sociale, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe mandatet institucionale.

Aktivitetet e realizuara

Gjatë periudhës raportuese është bërë pranimi, shqyrtimi dhe administrimi i kërkesave të qytetarëve për përfitim nga Skema e Asistencës Sociale. Çdo kërkesë është trajtuar në përputhje me kriteret ligjore dhe procedurat administrative, duke siguruar trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë aplikuesit.

Janë kryer verifikime të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesit, është bërë evidentimi dhe plotësimi i dosjeve individuale dhe familjare, si dhe përditësimi i vazhdueshëm i të dhënave në sistemet përkatëse.Një pjesë e rëndësishme e punës ka qenë realizimi i vizitave në terren për vlerësimin e gjendjes sociale dhe ekonomike të familjeve. Gjatë këtyre vizitave është konstatuar gjendja faktike e përfituesve, janë identifikuar nevojat reale dhe janë hartuar raporte sociale, të cilat kanë shërbyer si bazë për vendimmarrje.Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur raporte sociale, rekomandime profesionale, vërtetime,vendime dhe dokumente të tjera zyrtare, sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve kompetente.

Është ofruar informim dhe këshillim për qytetarët lidhur me procedurat e aplikimit, kriteret e përfitimit, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Skema e Asistencës Sociale dhe shërbimet e tjera sociale.

Bashkëpunimi me organizatat donatore

Përveç punës së përditshme në administrimin e skemave sociale, Qendra për Punë Sociale, në bashkëpunim me Komunën dhe Drejtorinë për Mirëqenie Sociale, si dhe në koordinim me organizata humanitare dhe donatorë, të cilët kanë ofruar mbështetje për familjet në gjendje të rënduar sociale.

Në bashkëpunim me këto institucione dhe organizata është punuar me rastet aktive, sipas nevojave dhe kritereve të përcaktuara, është bërë përgatitja e listave të përfituesve, koordinimi i procesit të shpërndarjes dhe monitorimi i pranimit të ndihmave.
Në kuadër të kësaj mbështetjeje, si asistencë sociale është arritur që të mbulohen të gjitha rastet aktive, duke u ofruar familjeve përkatëse mbështetjen e nevojshme në formë të pakove ushqimore dhe higjienike, sipas planifikimeve dhe kapaciteteve të donatorëve.
Mbështetje gjatë kësaj periudhe kanë ofruar:

- Fondacioni Freskia, me shpërndarjen e ndihmave ushqimore dhe materiale për familjet në nevojë.
- Ambasada e Katarit në Tiranë, e cila ka mbështetur familjet me pako ushqimore dhe ndihma humanitare.
- Qatar Charity Kosova,në kuadër të kësaj mbështetjeje janë përfshirë të gjitha rastet aktive, duke u ofruar ndihmë në formë të pakove ushqimore dhe higjienike.
- Islamic Relief Kosova, e cila ka mbështetur familjet përfituese me ndihma ushqimore dhe materiale gjatë periudhës raportuese.
- Fondacioni Bereqeti

Falë këtij bashkëpunimi është arritur të mbështeten një numër i konsiderueshëm i familjeve në kushte të vështira ekonomike, duke kontribuar në përmirësimin e mirëqenies së tyre dhe në përmbushjen e nevojave bazë jetësore.

- Vërtetimet për nevoja personale....................................................20
- Marrje e fletë informacionit për ndihmë sociale...........................80
- Kartela të lëshuara për familjet shfrytëzuese të SNS-së...............157
- Vizitë rutinore tek rastet sociale....................................................200
- Rastet e larguara nga krasimi përmes ATK.................................8
- Raste që kanë aplikuar përmes pilotimit në QPS..........................120
- Gjithsej raste aktive .......................................................................370

***DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, EMERGJENCA, MBROJTJE DHE SHPETIM***
***RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026***

Në kuadër te Drejtoratit për Shërbime Publike, gjatë periudhës Janar-Qershor-2026 nga ana e palëve gjegjësisht nga qytetarët na janë parashtruar kërkesa të ndryshme:gjithsejtë 331kërkesa nga ato kërkesajanë :

- Të miratuara 203
- Të refuzuara 6
- Anuluar 5
- Në Proces 117

Kërkesat e parashtruara nga palët, gjegjësisht qytetaret janë të natyrave të ndryshme dhe atë për:
Kërkesa për furnizim me gypa te ujësjellësit dhe kanalizimit,
Kërkesa nga lëmia e komunikacionit (transport, sinjalizim),
Kërkesa për furnizim me Zhavor për rrugët lokale te pa asfaltuara,
Kërkesë për prerje Asfalti,
Kërkesa për shpenzime të varrimit,
Licencë Auto-Taxi,
, etj.

SEKTORI I SHERBIMEVE PUBLIKE:

Gjatë kësaj periudhe bazuar ne kërkesat e qytetareve kemi dal në teren duke shqyrtuar dhe analizuar te gjitha rastet varësisht prej mundësive buxhetore ju kemi dal në ndihmë duke u bazuar në kontratat e aktiviteteve të ndryshme të cilat përmbushin edhe kërkesat e qytetareve qofshin ato furnizim me zhavorr, furnizim me gypa te ujësjellësit dhe kanalizimit etj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore është përgatitur dokumentacioni me kohë për shpalljen të tenderëve të paraparë në planin buxhetor, deri me tani i janë në proces të realizimit këto projekte:

- Mirëmbajtja dhe sanimi i pusetave,
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik,
- Blerja dhe furnizimi me gypa te kanalizimit dhe ujësjellësit,

- Riparimii rrugëve lokale te rendit të IV-të dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet,
- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale të asfaltuara,
- Eleminimi i mbeturinave nga Hapësirat Publike
- Ndërtimi i Urave-Vazhdim projekti dy vjeqar
- Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal

Po ashtu edhe ne ketë 6 mujor është vazhduar me subvencionimin e palëve për raste te varrimit për familjaret e tyre te vdekur,ku numri i tyre u subvencionuar deri ne ketë fazë duke përfshirë edhe disa nga viti paraprak janë realizuar 98 subvencionime për raste mortore

Ndërsa në procedura te tenderimit dhe vlerësimit janë këto projekte:

- Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Imerovit në Tomoc,Selmanovit dhe lagja Bregu
- Ndërtimi i kanalizimit në Llukavc të begut,-Lluga(lagjaRugova,Visoqi,Blakaj etj)
- Ndërtimi i kanalizimit në Lluga të Saradranit-Projekt 2 vjeqar

  Po ashtu ne si Drejtori jemi ne procedurën e e përgatitjes së Specifikimeve teknike edhe për projektet e planifikuara për realizim ne ketë vit buxhetor

Ne aspektin profesional ne si sektor kemi qenë të kyçur në kryerjen e shumë projekteve-paramasa dhe parallogarit, gjithashtu kemi qenë të kyçur në komisione për vlerësimin e tenderëve tjerë, mbikëqyrje të projekteve të ndryshme dhe në verifikime të punimeve për projekte të ndryshme.

Gjatë periudhës Janar –Qershor, në bashkëpunim me konsulentët e Gizit Gjerman dhe komisioneve ndëkomunale për rajonin e Dukagjinit, për Komunat Pejë, Istog, Klinë , Deqan dhe Junik pas hartimit të Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave – PNMIM dhe kalimit ne vitin paraprak ne Asamblenë komunal dhe rekomandimeve për ndryshime nga Ministria përkatëse i kemi bërë ndryshimet ne Draft dhe e kemi dërguar ne Asamble për Aprovim.

Nga Drejtoria jonë është dërguar rekomandimi për anëtar të Komisionit për hartimin e Planit të Mobilitetit
.

***ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM***
***RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2026***

Gjatë peridhës së lartëcekur, ZKKK-ja në Komunën e Istogut ka pranuar gjithsej 11 lëndë.
Kemi realizuar vizita në terren, kemi pasur takime me organizta të huaja dhe vendore lidhur me realizimin e projekteve që ka ZKKK-ja.

Në kuadër të punëve të rregullta, ZKKK kryen edhe punë të tjera si në vijim:
Angazhohet për integrimin e të gjitha komuniteteve në komunë tonë, duke iniciuar çështjen e bashkëjetesës së komuniteteve pakicë me atë shumicë;
Merrë pjesë në mbledhjet e Komiteteve, si: Komitetin për Komunitete, dhe në këtë Komitetë kontribonë dhe mbronë interesat e të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë dhe punojnë në Komunën e Istogut.
Bashkëpunon me Ministrin për Komunitete dhe Kthim me qëllim të realizimit të shumë projekteve në të mirë të të gjitha bashkësive minoritare etnike dhe bashkësive të tjera;
Viziton familjet të cilat janë kthyer nga shtetet fqinjë dhe vendet tjera, me qëllim që të njihet me problemet e tyre në të cilat ata hasin dhe integrimin e tyre në shoqërinë Kosovare. Gjithashtu viziton edhe familjet që ende gjenden në hapësirat e shteteve fqinje, ku bisedon me ata persona të shpërngulur dhe njëkohësisht i njofton me mundësinë e kthimit dhe mënyrën si mund të kthehen ata.
Bashkëpunon me organizatat joqeveritare të cilat merren me kthimin e personave të kthyer siç janë: UNHCR, IOM, USAID, MercyCorps, OSCE, DRC etj.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA (Në kuadër të Planit të Punës së ZKKK-së)

ZKKK-ja, duke u bazuar në kompetencat e saj, ka planin e punës, në të cilin përfshihen planifiket për aktivitet të cilat presin që të realizohen gjatë vitit. Planifikonë dhe menaxhon me të gjitha kodet buxhetore, me përjashtime të shpenzimeve komunale. Me poshtë i gjeni të listuara aktivitetet e planifikuara:

Ndertimi I rruges Kamer Loshi ne Veriq
Ndërtimi i rrugës "Shaban Hajrezaj" në Llukafc te Thatë
Ndertimi I rruges ne lagjen Gerguri dhe Berishaj ne Llukafc
Ndërtimi i rrugës në Llukafc të Thatë
Ndertimi I rruges ne Saradran- Lugu i Drinit

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Ndërtimi i rrugës "Shaban Hajrezaj" në Llukafc te Thatë
Ndertimi I rruges Kamer Loshi ne Veriq
Ndertimi I rruges ne Saradran- Lugu i Drinit

AKTIVITETET NË BASHKËPUNIM ME OJQ

ZKKK aktualisht ka 12 këerkesa për shqyrtimin që I plotësojne kushtet dhe pritet të shqyrtohen së shpejti nga Komisioni Qendror.
Nga 19 shtëpitë e miratuara bga Komisioni Qendror për vitin 2025, deri më tani janë realizuar 3, ndërsa 16 të tjerat janë në pritje realizimit
Po ashtu, 2 shtëpi të miratuara në vitin 2024 mbeten në pritje të realizimit gjatë këtij viti.
.
PROCESI I RIATDHESIMIT

Të riatdhesuar siapas SMR

Kërkesa të parashtruara pranë ZKKK-së

Kemi gjithsej 2 kërkesa të parashtruara pranë ZKKK-së për ndihmë në Programi, të cilat KKR-ja do t’i shqyrtojë, të dy kërkesat janë nga individë dhe kanë të bëjnë me dru zjarri.

Përmbyllje:

- Raportimi i të dhënave nga të gjitha drejtoritë dhe nga Zyra e Kryetarit për periudhën Janar-Qershor 2026, i punuar nga Kabineti i Kryetarit në bashkëpunim me drejtoritë dhe sektoret e Komunës së Istogut.

***Kryetari i Komunës***
***z. Ilir FERATI***

***Komuna Istog***
***Datë; 29.06.2026***

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Istogut**
**Opština Istok – Municipality of Istog**

**Nr.Br.01 - 902 / 2026**
**Data: 14.07.2026**

http://kk.rks-gov.net/istog/

# RAPORTI I ZBATIMIT TË PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT

# PËR BARAZINË GJINORE JANAR – QERSHOR 2026

Korrik 2026

# Hyrje

Grupi Monitorues për Zbatimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026 bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.Br.01-940/2024, të datës, 30.10.2024 ka mbledhur të dhënat e raportuara lidhur me zbatimin e planit lokal të veprimit për barazi gjinore për periudhën Janar- Qershor të vitit 2026. Bazuar në aktivitetet e planifikuara në Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026 përmes komunikimit zyrtar ka kërkuar nga drejtoritë përkatëse të dhëna lidhur me zbatimin e aktiviteteve të planifikuara për periudhën Janar-Qershor 2026, siç është e specifikuar në Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026 (zbatimi, afati kohor, kostot, burimi i financimit, treguesit).
Pas pranimit te të dhënave të prezantuara lidhur me aktivitetet e realizuara grupi monitorues ka hartuar Raportin për Zbatimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për periudhën Janar- Qershor të vitit 2026
Në raport janë paraqitur:

- Aktivitetet e planifikuara;
- Zbatimin, nga drejtoria / zyra përgjegjëse, drejtoritë/ institucionet mbështetëse;
- Afati Kohor;
- Treguesit;
- Monitorimi.

Të dhënat e raportuara janë bashkangjitur në formë tabelare bazuar në renditjen e paraqitur në matricën e Planit Lokal të veprimit për Barazinë Gjinore
2024-2026.
Grupi monitorues ka konstatuar se për periudhën Janar- Qershor të vitit 2026 në kuadër të Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026 janë raportuar Aktivitetet si me poshtë.

Grupi monitorues raportin për Zbatimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026
e ka hartuar duke u bazuar në materialin e pranuar nga drejtoritë përkatëse në kopje fizike dhe përmes emalit zyrtar.

## VII. MATRICA E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2024 - 2026

| OBJEKTIVI STRATEGJIK: | 1. PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE, TË REJAVE DHE VAJZAVE NË TË GJITHË SHUMËLLOJSHMËRIA E TYRE. | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| AKTIVITETET | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | KOSTO (€) | | | BURIMI I FINANCIMIT | TREGUESIT | MONITORMI |
| | Drejtoria / zyra përgjegjëse | Drejtoritë/ institucionet mbështetëse | | 2024 | 2025 | 2026 | | | |
| 1.1.2. Aktivitete informuese në kuadër të javës së "8 Marsit – Dita Ndërkombëtare e Gruas".<br>Raportimi:<br><br>**Shënimi i 8 Marsit ''Dita Ndërkombëtare e Gruas''**<br><br>Tryezë diskutimi në bashkëpunim me OJQ ''Qendrën për Mirëqenien e Gruas'', më rastin e shënimit të 8 Marsit ''Dita Ndërkombëtare e Gruas''. Tema kryesore e kësaj tryeze ishte ''Sfidat, vështirësitë dhe të arriturat e grave''. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi lidhur më sfidat që kanë gratë, diskriminimi gjinor, mungesa e përfaqësimit si dhe fuqizimi i rolit të gruas në të ardhmen. Në këtë takim u prezantuan | ZBGJMD | SDNJK<br><br>DAK<br><br>GGA<br><br>OJQ<br><br>ON | 2024<br>-<br>2026 | 788 €<br><br>(nga të cilat 398 € komuna dhe 390 € hendek financiar) | 788 €<br><br>(nga të cilat 398 € komuna dhe 390 € hendek financiar) | 788 €<br><br>(nga të cilat 398 € komuna dhe 390 € hendek financiar) | SDNJK<br><br>Donatorët | - 3 takime të zhvilluara (1 në vit)<br><br>- 60 gra të informuara (20 në vit) ndarë sipas moshës, etnisë, vendbanimit, etj. | ZK<br><br>GM |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| këto të dhëna për komunën tonë sa i përket përfaqësimit gjinor për vitin 2025:<br><br>Gratë e punësuara në institucione/administratën komunale<br>1. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucionet komunale është 1054<br><br>2. Numri i përgjithshëm i grave të punësuara në institucionet komunale është 590.<br>Gratë në pozita udhëheqëse në institucionet arsimore, shëndetësore e kulturore/sportive<br>1.Numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë udhëheqës në institucionet komunale të arsimit shëndetësisë kulturës dhe sportit është 37<br>2.Numri i zyrtarëve të lartë udhëheqës nga gjinia femërore është 16.<br>Gratë e emëruara në pozita politike në komunë<br>1.Numri i përgjithshëm i grave të emëruara në poste politike në komunë është 5<br><br>2.Numri i përgjithshëm i zyrtarëve të emëruar në postet politike në komunë | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 20.Barazia gjinore tek anëtarët e komiteteve komunale:<br><br>1.Përqindja e grave në Komitetin Politikë dhe Financa është 45%<br><br>2.Përqindja e grave në Komitetin për Komunitete 45%<br><br>3.Përqindja e grave në komitetet tjera (Komiteti për Barazi Gjinore) 90%<br><br>4.Përqindja e grave në komisione të kuvendit komunal (komision për koordinimin e këshillave lokale komisione të aksionarëve të ndërmarrjeve publike etj.) 45%<br><br>Barazia gjinore në përfitime të programeve dhe aktiviteteve të komunës<br><br>1.Buxheti total i ndarë për skema të punësimit dhe ndërmarrësisë subvencionet në bujqësi dhe zhvillim ekonomik është 19,559.86 euro<br><br>2.Buxheti i ndarë për skema të punësimit dhe ndërmarrësisë për gra dhe vajza subvencionet në bujqësi | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| dhe zhvillim ekonomik 11,000.55 euro<br><br>3.Numri i përfituesve të përgjithshëm është 801<br><br>4.Numri i grave përfituese është 392<br><br>5.Numri i grave përfituese nga komunitetet pakicë është 23.<br><br>Pjesëmarrja e grave në konsultime publike<br>1.Numri i përgjithshëm i pjesëmarrëseve në konsultime publike është 267<br>2.Numri i përgjithshëm i grave dhe vajzave pjesëmarrëse në konsultime publike 57<br><br>Përfaqësimi gjinor tek emërtimet e rrugëve<br><br>1.Numri i rrugëve në komunë të emërtuar pas personave është 325<br><br>2.Numri i rrugëve të emertuar pas personave të gjinisë femërore është 3 | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Regjistrimi i pronësisë në emër të dy gjinive<br>1.Numri i pronave të regjistruara në komunë është 1690<br>2.Numri i pronave të regjistruara në emër të dy apo më shumë personave dhe me gjini të ndryshme 127<br>3.Numri i përgjithshëm i pronave në emër të grave si prona individuale 80.<br>Pjesë e kësaj tryeze ishin: asamblistët e kuvendit të komunës, drejtoreshat e drejtorive përkatëse, udhëheqëset e sektorëve, përfaqësuese të OJQ-ve dhe zyrtare komunale. Në fund të takimit u dhuranë lule për nderë të festës së 8 Marsit. Në tryezën e diskutimit ishin prezentë 15 pjesëmarrëse. | | | | | | | | | |
| 1.1.3. Aktivitete vetëdijesuese për shënimin e ditës botërore kundër punës së fëmijëve vajza dhe djem (12 Qershori).<br>Raport:<br>Në kuadër të Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete - Drejtoria për Administratë Komunale me rastin | SDNJK | ZBGJMD<br>DKA<br>OJQ<br>ON | 2024<br>-<br>2026 | 209 €<br>(komun a) | 209 €<br>(komun a) | 209 €<br>(komuna) | SDNJK<br>Donatorët | - 3 takime të zhvilluara (1 në vit)<br>- 90 persona të informuar (30 në vit) ndarë sipas | ZK<br>GM |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| e shënimit të 12 Qershorit "Dita Ndërkombëtare kundër Punës së Rëndë të Fëmijëve" në FSHMU "Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe" në Uçë, nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Ri integrim është mbajtur takim ndërgjegjësues më nxënës/e më temën "Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda dhe shfrytëzimi''.<br>Takimi kishte si qëllim ndërgjegjësimin e fëmijëve, për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda, kuptimin e punës se lejuar dhe jo të lejuar të punës së fëmijëve, format më të rënda të punës së fëmijëve, shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve, korniza ligjore dhe institucionale në Kosovë, të autorizuar për të vepruar dhe bashkëpunuar në identifikimin, tërheqjen, rehabilitimin dhe ri integrimin e fëmijëve të angazhuar, procesi i menaxhimit të rasteve dhe raportimi i rasteve të fëmijëve të cilët janë të përfshirë në punë të rënda.<br>Në këtë takim ishin prezentë **29** pjesëmarrës/e prej tyre **11 M** dhe **18 F**. | | | | | | | | seksit,<br>moshës,<br>etnisë,<br>vendbanimit,<br>etj. | |

| AKTIVITETET | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | KOSTO (€) | | | BURIMI I FINANCIMIT | TREGUESIT | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Drejtoria / zyra përgjegjëse | Drejtoritë/ institucionet mbështetëse | | 2024 | 2025 | 2026 | | | |
| 1.2.10. Publikimi në faqen e komunës i gjeteve kryesore nga monitorimi i zbatimit të këtij Plani Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore.<br>Raportimi: Janë të publikuara raportet e zbatimit për periudhat e kaluara të raportimit. | ZTI | ZBGJMD<br><br>Drejtoritë komunale | 2024 - 2026 | 2,650 € (komuna) | 2,650 € (komuna) | 2,650 € (komuna) | ZK | - Linku me gjetjet e publikuara çdo vit | ZK<br><br>GM |
| **OBJEKTIVI STRATEGJIK:** | **2. FUQIZIMI EKONOMIK DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË, PËR GRATË, TË REJAT DHE VAJZAT** | | | | | | | | |
| **AKTIVITETET** | **ZBATIMI** | | **AFATI KOHOR** | **KOSTO (€)** | | | **BURIMI I FINANCIMIT** | **TREGUESIT** | **MONITORIMI** |
| | **Drejtoria / zyra përgjegjëse** | **Drejtoritë/ zyrat mbështetëse** | | | | | | | |
| 2.1.4. Ngritja e kapaciteteve të fermerëve dhe fermerëve përmes trajnimeve në çështje të ndryshme të bujqësisë dhe të organizimi i trajnimeve për vajzat dhe gratë në fushën e ndërmarrësisë dhe për aftësitë biznesore etj.<br>Raportimi: Janë mbajtur dy trajnime, ku janë trajnuar 32 persona për tema të ndryshme në bujqësi 27M, 6F. | DBHP | MBZHR<br><br>OJQ<br><br>ON | 2025 - 2026 | 1,990 €<br><br>(nga të cilat 1,240 € komuna dhe 750 € donatori[1]) | 1,990 €<br><br>(nga të cilat 1,240 € komuna dhe 750 € donatori[2]) | 1,990 €<br><br>(nga të cilat 1,240 € komuna dhe 750 €) | DBHP<br><br>MBZHR<br><br>Donatorët | - 15 trajnime të zhvilluara (5 në vit)<br><br>- 225 persona të trajnuar (75 në vit), ndarë sipas seksit, | ZK<br><br>GM |

[1] Ekspert/ja nga MBZHR
[2] Ekspert/ja nga MBZHR

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | donatori [3]) | | moshës, etnisë, etj. | |
| 2.1.5. Promovimi i produkteve lokale, veçanërisht atyre të përgatitura nga gratë, përmes aktiviteteve lokale si dhe sigurimi i tregut pa pagesë, i përhershëm apo për një periudhë të caktuar të vitit, ku do të bëhet shitja e produkteve të prodhuara nga vajzat dhe gratë.<br>Raport:<br>Në bashkëpunim me **FAO** dhe **UN Women**, në kuadër të projektit të financuar nga Austrian Development Agency, u organizua Panairi i Grave Fermere në Istog. Në këtë aktivitet u prezantuan produkte të ndryshme vendore, gatime tradicionale, punime artizanale dhe veshje kombëtare, duke dëshmuar punën, kreativitetin dhe përkushtimin e grave fermere të komunës sonë. Të pranishëm në panair ishin edhe përfaqësues të komunës, të cilët vlerësuan rëndësinë e mbështetjes së grave në sektorin e bujqësisë dhe fuqizimin e tyre ekonomik. Ky panair shënoi përmbylljen e suksesshme të projektit, i cili përfshiu trajnime, | DBHP | ZK<br>SDNJK<br>OJQ<br>ON | 2024 - 2026 | 9,625 € (komuna) | 13,625 € (komuna) | 9,625 € (komuna) | DBHP<br>SDNJK<br>Donatorët | - 7 aktivitete lokale të zhvilluara (në 2 vite 4 takime si dhe 1 vit 3 takime në vit)<br>- Numri i produkteve lokale të prodhuara nga gratë i promovuar në çdo aktivitet | ZK<br>GM |

[3] Ekspert/ja nga MBZHR

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| nënshkrim kontratash dhe shpërndarje të pajisjeve bujqësore për përfitueset. | | | | | | | | | |
| 2.1.6. Takime informuese mbi vazhdimin e masës afirmative për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve, pa pagesë.<br>Raport:<br><br>**Fushatë vetëdijesuese lidhur me temën " E drejta në pronë dhe trashëgimi" dhe "Legalizimi i pronës".**<br><br>Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete bazuar në Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026, në bashkëpunim me ORGANIKA në kuadër të projektit PIAKOS, të mbështetur nga Banka Botërore dhe i zbatuar në partneritet me ATRC organizoi dhe mbajti dy takime një muajin mars dhe prill më qellim të diskutimit, informimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve, veçantë grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë, regjistrimin dhe legalizimin e pronës. Vlen të theksohet se të gjitha | Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi (DKGJ) | ZK<br><br>SDNJK<br><br>OJQ<br><br>ON | 2024<br>-<br>2026 | 1,288 €<br><br>(nga të cilat 708 € komuna dhe 580 € donatori[4]) | 1,288 €<br><br>(nga të cilat 708 € komuna dhe 580 € donatori[5]) | 1,288 €<br><br>(nga të cilat 708 € komuna dhe 580 € donatori[6]) | DKGJ<br><br>SDNJK<br><br>Donatorët | - 6 takime informuese të zhvilluara (2 në vit)<br><br>-150 persona të informuar (50 në vit), ndarë sipas seksit, moshës, profesionit, etj.<br>- Numri i pronave të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve dhe / ose në emër të gruas në vit | ZK<br><br>GM |

[4] OSBE
[5] OSBE
[6] OSBE

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| shpenzimet për procedurat e regjistrimit të pronës mbulohen nga projekti dhe pjesëmarrësit në këto takime nuk kanë asnjë detyrim financiar. Diskutime dhe pyetje lidhur më temën pati nga shumica e grave që ishin prezente.<br><br>Në takime ishin prezentë gjithsej **51** pjesëmarrës/e prej tyre **4M** dhe **47 F.** | | | | | | | | | |

| AKTIVITETET | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | KOSTO (€) | | | BURIMI I FINANCIMIT | TREGUESIT | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Drejtoria / zyra përgjegjëse | Drejtoritë/ zyrat mbështetëse | | 2024 | 2025 | 2026 | | | |
| 2.2.2. Hulumtimi i respektimit të së drejtës për marrjen e pushimit prindëror në institucionet publike.<br>RAPORTIM: Përfillet në maksimum nga njësia e burimeve njerëzore këtë të drejtë për pushim prindëror. | ZBNJ | ZBGJMD<br>DKA<br>DSH | 2024 - 2026 | 200 € (komuna) | 200 € (komuna) | 200 € (komuna) | ZK<br>DKA | 3 raporte të përgatitura me gjetjet nga ky hulumtim (1 në vit) | ZK<br>GM |
| 2.2.5. Ndihmë financiare për familjet në nevojë, me fokus nënat vetushqyese, gratë viktima të dhunës me bazë gjinore, etj. | Drejtoria për Mirëqenie Sociale (DMS) | Ministritë relevante<br>ZK | 2024 - 2026 | 7, 000 € (komuna) | 12,000 € (komuna) | 15,000 € (komuna) | DMS<br>ZK<br>Donatorët | - 25 familje me kryefamiljare gra, të ndihmuara | ZK<br>GM |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Raportim: Drejtoria e Mirëqenies Sociale vazhdon të mbetet e përkushtuar në ofrimin e mbështetjes për kategoritë e cenueshme të shoqërisë sonë. Aktualisht, jemi duke subvencionuar nënat vetushqyese me një mbështetje financiare në vlerë prej 500 euro. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit kemi subvencionuar 32 nëna vetushqyese, të cilat kanë qenë në kushte të rënda ekonomike. Një tjetër mbështetje e rëndësishme që ofron Drejtoria e Mirëqenies Sociale është subvencionimi i pagesës së qirasë për viktimat e dhunës në familje. Në bazë të rekomandimeve të Komisionit për Strehim Social dhe në përputhje me Planin Trevjeçar të Banimit Social, çdo viktimë e dhunës në familje, , përfiton mbulimin e pagesës së qirasë deri në përmirësimin e gjendjes së saj socio-ekonomike. Gjatë këtij gjashtëmujori, kemi pasur vetëm një rast të rekomanduar nga Qendra për Punë Sociale për mbulimin e pagesës së qirasë, ndera te gjitha pagesat e qeras të realizuara për gjatë 6 mujorit te para nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale janë gjithsej 10 familje përfituese ne kushte të renda socio-ekonomike. | | QPS<br><br>OJQ<br><br>ON | | | | | | financiarisht (ndarë sipas grupit social, numrit të anëtarëve të familjes, etnisë, vendbanimit, etj. | |

| AKTIVITETET | ZBATIMI | | AFATI KOHOR | KOSTO (€) | | | BURIMI I FINANCIMIT | TREGUESIT | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Drejtoria / zyra përgjegjëse | Drejtoritë/ institucionet mbështetëse | | 2024 | 2025 | 2026 | | | |
| 3.2.2. Mbështetja e vazhdueshme e klubeve sportive përmes thirrjes publike, me fokus të veçantë klubet sportive të të rejave e vajzave.<br><br>Raportimi: Në bazë të këtij aktiviteti janë mbështetur klubet: Klubi i Hendbollit të Femrave KHF.ISTOGU, Klubi i Futbollit të Femrave KFF.ISTOGU, klubet që përfshijnë femra dhe meshkuj: Klubi i Pingpongut KPP.ISTOGU, Klubi i Karatesë "Liria" dhe Klubi "E&E Wazari",Sporti Shkollor,Klubi I Basketbollit KB.ISTOGU" dhe Klubi i Notit "K.N ONIX-ISTOGU". Dhe dy OJQ Kulturore OJQ – "Folklori I Podgurit" dhe "Vision 02"Shuma totale e këtyre klubeve sportive – OJQ-ve të mbështetura nga thirrjet publike është **45,000.00.** | DKRS | OJQ<br><br>ON | 2024<br>-<br>2026 | 12,485 € (komuna) | 12,485 € (komuna) | 3,485 € (komuna) | DKRS<br><br>Donatorët | - 6 klube sportive të mbështetura të grave, të rejave për 3 vite<br>(2 klube në vitin 2024, 3 klube në vitin 2025 si dhe 1 klub në vitin 2026) | ZK<br><br>GM |
| 3.2.4. Investime në hapësirat sportive për ofrimin e kushteve sa më të mira | DKRS | DKA | 2024<br>- | 263,000 € | 150,000 € | 100,000 € | DKRS | - Investimet e realizuara çdo | ZK |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| për zhvillime në sport, duke respektuar parimet e qasjes dhe të barazisë gjinore.<br><br>Raportimi: Investimet në hapësirat sportive për ofrimin e kushteve më të mira për zhvillimin e sportit kanë vazhduar edhe në vitin 2026. Investimet janë si më poshtë:<br><br>1. Palestra e sporteve, Punët kane përfunduar në fund të vitit 2025.Vlera totale e projektit 548,364.05 Euro.<br>2. Pas përfundimit të punimeve në renovim të qetisë, në pjesën e dyte të vitit pritet të fillojnë punimet në sanimin e brendshëm të Palestrës. Në vlerë fillestare nga Drejtoria prej 130.000.00 Euro, kurse nga Ministria nuk na është bërë e ditur ende se sa do të jetë përkrahja për këtë projekt.<br>3. Po ashtu në fillim të gjysmëvitit të dytë 2026, pritet të fillojnë punimet në ndërtimin e shtëpisë të kulturës dhe parkut në vrellë. Në vlerën totalë 590.000 Euro. | | OJQ<br><br>ON | 2026 | (komuna ) | (komuna ) | (komuna ) | Donatorët | vit respektojnë standardet e qasjes dhe të barazisë gjinore.<br>6 aktivitete të realizuara (2 në vit) | GM |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | |
| 3.2.5. Mbështetje e organizatave-shoqëritë kulturore artistike të vajzave dhe të të rejave.<br>Raportimi: Janë mbështetur edhe nxënës për promovimin e librit. Aktivitetet tjetër është ekspozita artisitke 3 ditore që është mbajtur në Shtëpinë e Kulturës "Adem Jashari" nga Diellza Kamberaj". Po ashtu për nder të ditës të Çlirimit të Istogut u mbajt program artistik në parkun e qytetit. Ku aty përformuan vajza dhe djem të ri të dy OJQ-ve Ansambli "Selman Kadria dhe "Vullkani i Istogut". | DKRS | OJQ<br>ON | 2024 - 2026 | 3,000 € (komuna ) | 3,000 € (komuna ) | 3,000 € (komuna ) | DKRS<br>Donatorët | - 12 aktivitete me organizatën shoqërore kulturore – artistike (4 aktivitete në vit). | ZK<br>GM |

**Ky raport është hartuar në tri(3) kopje Identike, me nga një kopje te njoftohen:**

1. **Kryetari i Komunës;**
2. **Grupi Jo Formal i Grave Asambleiste dhe;**
3. **Komiteti për Barazi Gjinore.**

**Grupi Monitorues:**

**Afrim Metaj, kryesues i grupit;** ______________

**Servete Haxhijaj, anëtare ;** ______________

**Albert Hasanaj, anëtar.** ______________

**Arta Fetahu, anëtare;** ______________

**Alketa Bujupaj, anëtare;** ______________

| Republika e Kosovës<br>Republika Kosova<br>Republic of Kosovo | Komna e Istogut<br>Opstina Istok<br>Municipality Istog |
|---|---|

## Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi

| | |
|---|---|
| **DATË/A:** | 09.07.2026 |
| **REFERENCË:** | Nr.1246/2026 |
| **PËR/ZA/TO:** | **z.Ilir Ferati, Kryetar i Komunës së Istogut** |
| **CC:** | |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **z.Agon Dreshaj, Drejtor për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi** |
| **NGA/OD/FROM:** | Blerim Ukaj, Zyrtar ligjor për çështje pronësore |
| **TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:** | Lënda: Raporti i monitorimit të Kontratave të Pronave me Qera për 6 mujorin e parë të vitit 2026 |

Në mbështetje të ninit 22 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi ka përgatitur këtë raport gjashtëmujor mbi monitorimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunale. Qëllimi i këtij raporti është informimi i Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit Komunal lidhur me gjendjen faktike të kontratave aktive, respektimin e kushteve kontraktuale nga shfrytëzuesit e pronave komunale, përmbushjen e qëllimit për të cilin prona është dhënë në shfrytëzim, si dhe vlerësimin e ndikimit që kanë këto kontrata në zhvillimin ekonomik lokal dhe menagjimin racional të pronës komunale.

Monitorimi është realizuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe kontrakuale, përmes verifikimeve në terren, shqyrtimit të dokumentacionit administrativ dhe financiar, si dhe kontrollit të përmbushjes së obligimeve të përcaktuara në kontratat përkatëse. Nga monitorimi i realizuar gjatë kësaj periudhe nuk janë evidentuar raste të ndryshimit të destinimit të pronës, mosshfrytëzimit të saj apo mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale nga operatorët ekonomikë që kanë marrë në shfrytëzim prona komunale.

Komuna e Istogut, në mandatin paraprak qeverisës ka realizuar procedurat për dhënien në shfrytëzim të një numri të konsiderueshëm të pronave bujqësore përmes ankandit publik, duke respektuar procedurat ligjore dhe parimet e transparencës, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Qëllimi kryesor i dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave ka qenë: rritja e prodhimit bujqësor, shfrytëzimi racional i tokës bujqësore komunale, mbështetja e fermerëve dhe operatorëve ekonomikë, sigurimi i të hyrave të rregullta për buxhetin komunal.

Gjatë periudhës raportuese janë monitoruar të gjitha kontratat aktive për pronat bujqësore të dhëna me qira. Monitorimi ka përfshirë verifikimin nëse këto parcela shfrytëzohen për kultivimin e kulturave bujqësore , respektimin e kushteve të kontratës dhe përmbushjen e obligimeve financiare ndaj Komunës. Nga monitorimi në terren është konstatuar se të gjitha parcelat janë duke u shfrytëzuar për destinimin për të cilin janë dhënë, përkatësisht për kultivimin e kulturave bujqësore, pa u evidentuar raste të ndryshimit të destinimit, mosshfrytëzimit apo keqpërdorimit të pronës komunale. Po ashtu, është konstatuar se të gjithë operatorët ekonomikë dhe personat fizikë kanë qenë të rregullt në pagesën e qirasë vjetore, duke përmbushur obligimet financiare të përcaktuara në kontratat përkatëse.

Këto prona bujqësore janë dhënë në shfrytëzim në afat prej 15 viteve dhe tani ka kaluar mbi një vit që këto prona janë në shfrytëzim nga personat fizik apo juridik të cilët i kanë marrë në shfrytëzim përmes ankandit publik. Po ashtu, pronat janë të mirëmbajtura dhe janë duke u shfrytëzuar në mënyrë aktive, duke kontribuar në ruajtjen e karakterit bujqësor të tokës komunale dhe rritjen e aktivitetit ekonomik në sektorin e bujqësisë.

Komuna, në kuadër të kompetencave të saj, do të vazhdojë monitorimin periodik të këtyre pronave, me qëllim të zbatimit të plotë të kontratave, respektimin e destinimit të tokës, si dhe mbrojtjes së interesit publik dhe pasurisë komunale.

Në përfundim, vlerësohet se dhënia e këtyre pronave në shfrytëzim ka rezultuar në një menaxhim më efikas të pronës komunale, duke mundësuar aktivizimin e sipërfaqeve të papërdorura, krijimin e kushteve për zhvillimin e prodhimit bujqësor dhe sigurimin e të hyrave të rregullta për buxhetin e Komunës.

Më poshtë paraqitet në formë tabelare edhe shfrytëzuesit e pronës bujqësore të Komunës së Istogut, parcelat, zona kadastrale, sipërfaqja dhe çmimi i qirasë:

| Emri dhe Mbiemri | Parcela Kadastrale | ZK. | m² | Çmimi/m² | Totali për siperfaqe |
|---|---|---|---|---|---|
| Ahmet Metaj | 01430-0 | Shushicë | 328724 | 0.0257 | € 8,448.21 |
| Blerina Kajtazaj | 00587-0 | Kovragë | 13799 | 0.009 | € 124.19 |
| Blerina Kajtazaj | 00586-0 | Kovragë | 13174 | 0.009 | € |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 118.57 |
| Ferma Balaj sh.p.k. | 00553-2 | Veriq | 348905 | 0.011152 | € 3,890.99 |
| Millky Way Farm sh.p.k. | 00508-0 | Llukac I Thatë | 73958 | 0.008005 | € 592.03 |
| Millky Way Farm sh.p.k. | 00509-0 | Llukac I Thatë | 43045 | 0.00755 | € 324.99 |
| Millky Way Farm sh.p.k. | 00510-0 | Llukac I Thatë | 16563 | 0.00855 | € 141.61 |
| Millky Way Farm sh.p.k. | 01182-0 | Gjurakoc | 548541 | 0.01102 | € 6,044.92 |
| Visar Krasniqi | 00325-0 | Dubravë | 31515 | 0.022222 | € 700.33 |
| Dardan Salihaj | 01433-0 | Shushicë | 132471 | 0.0253 | € 3,351.52 |
| Ferma Green sh.p.k. | 00234-80 | Rakosh | 78580 | 0.008 | € 628.64 |
| Agro Ibrahimaj sh.p.k. | 00504-0 | Bellopojë | 69862 | 0.01116 | € 779.66 |
| Agro Ibrahimaj sh.p.k. | 00550-0 | Veriq | 246622 | 0.014535 | € 3,584.65 |
| Vëllezerit Salihaj sh.p.k | 00333-0 | Rakosh | 57961 | 0.00826 | € 478.76 |
| Agro Gusari sh.p.k. | 00506-0 | Llukac I Thatë | 85936 | 0.008519 | € 732.09 |
| Agro Gusari sh.p.k. | 00505-0 | Llukac I Thatë | 43667 | 0.008519 | € 372.00 |
| Agro Gusari sh.p.k. | 00507-0 | Llukac I Thatë | 40860 | 0.008519 | € 348.09 |
| **Realizimi per vitin 2025** | | | | | **€ 30,661.24 euro** |
| | | | | | |

Përveq dhënies në shfrytëzim të pronave komunale për qëllime bujqësore, në kuadër të zbatimit të politikave për zhvillim ekonomik lokal dhe menaxhim efikas të pronës komunale, gjatë mandatit të kaluar Komuna e Istogut ka dhënë në shfrytëzim një numër të pronave komunale përmes procedurës së negocimit me investitorë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimet përkatëse të organeve komunale.

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave ka qenë realizimi i investimeve për ndërtimin e objekteve prodhuese, përpunuese, tregtare dhe multifunksionale, të cilat pritet

të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të Komunës së Istogu, rritjen e kapaciteteve prodhuese, krijimin e vendeve të reja të punës dhe zgjerimin e bazës ekonomike të Komunës.

Bazuar në monitorimin e realizuar gjatë periudhës raportuese, është konstatuar se secili investitor ndodhet në fazën e paraparë sipas kontratës së nënshkruar dhe afateve dinamike të përcaktuara për realizimin e investimeve.

Më poshtë janë të paraqitura në mënyrë tabelare investitorë të cilë i kanë marrë këto prona në shfrytëzim, parcelat, sipërfaqja, qiraja vjetore si dhe periudha kohore e dhenies në shfrytëzim:

| **(Investitori)** | **Vendi Zona Kadastrale Nr.i parcelës.** | **Sipërfaqja në shfrytëzim.** | **Qiraja vjetore.** | **Periudha e Shfrytëzimit :** |
|---|---|---|---|---|
| **"Rina Comerc" Sh.P.K** | Nr.67 - 1, Nr.69 - 1<br>Gurrakoc | 40000m² | 1800 Euro | 40 vite |
| **2."Shija " B.I** | Gurrakoc<br>Nr.34 - 4, 34 - 3, 34 - 2, 29-21. | 915m² | 1200 Euro | 30 vite |
| **3."Dritoni Plast"** | Nr.213 - 0<br>Sinajë | 4858m² | 600 Euro | 30 vite |
| **4."Agro Produkt" Sh.P.K** | Sinajë<br>Nr.896 - 0 | 16942m² | 1080 Euro | 40 vite |

Operatori "Rina Comerc" sh.p.k, ka marrë në shfrytëzim parcelat nr.67-1 dhe 69-1 Zona Kadastrale Gurrakoc me sipërfaqe të përgjithshme prej 40,000m$^2$, për një periudhë kohore pre 40 vitesh me qira vjetore në vlerë 1,800.00 euro.
Nga monitorimi i realizuar rezulton se investitori është në fazën përfundimtare të procedurave administrative dhe përgatitore për fillimin e realizimit të investimit. Po ashtu konstatohet që investitori ndodhet brenda afatit dinamik prej 3-4 vite të përcaktuar me kontratë dhe deri në periudhën raportuese nuk janë konstatuar tejkalime të afateve apo shkelje të obligimeve kontraktuale. Pritet që pas përfundimit të procedurave administrative të filloj realizimi i investimit, i cili do të ndikojë në rritjen e aktivitetit ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës në territorin e Komunës së Isotgut.

Operatori "Shija" B.I ka marrë në shfrytëzim parcelat 34-4, 34-3, 34-2, 29-21, Zona Kadastrale Gurrakoc me sipërfaqe të përgjithshme prej 915 m$^2$, për një periudhë prej 30 vitesh, me qira vjetore prej 1,200.00 euro.

Gjatë periudhës raportuese është konstatuar se investitori është në proces të përfundimit të procedurave administrative dhe teknike të nevojshme për fillimin e investimit. Deri në momentin e hartimit të këtij raporti nuk ka filluar realizimi fizik i projektit, megjithatë investitori ndodhet brenda afatit dinamik prej 3-4 vite të përcaktuar në kontratën e shfrytëzimit. Për rrjedhojë, nuk ekziston bazë për të konstatuar mospërmbushje të obligimeve kontraktuale, ndërsa komuna do të vazhdojë monitorimin e vazhdueshëm të realizimit të projektit sipas afateve të parapara në kontratë.

Operatori "Dritoni Plast" ka marrë në shfrytëzim parcelën nr.213-0, Zona Kadastrale Sinajë, me sipërfaqe 4,858m$^2$, për një periudhë prej 30 vitesh, me qira vjetore në vlerë prej 600.00 euro.
Nga monitorimi i realizuar rezulton se investitori ka filluar realizimin e veprimtarisë për të cilën është lidhur kontrata e shfrytëzimit dhe prona është duke u përdorur sipas destinimit të miratuar. Aktiviteti ekonomik është në zhvillim dhe investimi po realizohet në përputhje me obligimet kontraktual, duke kontribuar në zgjerimin e veprimtarive prodhuese dhe në zhvillim ekonomik lokal.

Operatori ekonomik "Agro Produkt" sh.p.k ka marrë në shfrytëzim parcelën 896-0, Zona vjetore në vlerë prej 1,080.00 euro.
Sipas monitorimit të realizuar, investitori ka filluar shfrytëzimin e pronës në përputhje me qëllimin për të cilin i është dhënë në shfrytëzim dhe është duke zhvilluar veprimtarinë e planifikuar. Deri në periudhën raportuese nuk janë evidentuar devijime nga kushtet kontraktuale, ndërsa aktiviteti i zhvilluar në këtë pronë paraqet një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit ekonomik dhe krijimin e mundësive të reja për punësim.

**Pronat komunale të planifikuar për zhvillimin e projekteve të energjisë së ripërtritshme.**

Në kuadër të politikave për zhvillim të qëndrueshëm dhe promovimin e investimeve në sektorin e energjisë së ripërtritshme, Komuna gjatë mandatit të kaluar ka zhvilluar procedurat për dhënien në shfrytëzim të një numri të konsiderueshëm të pronave komunale për realizimin e projekteve fotovoltaike (panele solare).

Qëllimi i këtyre investimeve është shfrytëzimi racional i pronës komunale për prodhimin e energjisë së ripërtritshme, tërheqja e investitorëve, krijimin e vendeve të reja të punës, rritja e aktivitetit ekonomik dhe kontributi në tranzicion drejt burimeve të pastra të energjisë në përputhje me objektivat kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm.

Edhe pse procedurat për dhënien në shfrytëzim janë përfunduar nga ana e Komunës, procesi i nënshkrimit të kontratave është shtyrë për shkak të pritjes së konfirmimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), si pjesë e procedurave të parapara ligjore për hyrjen në fuqi të vendimeve përkatëse.

Gjatë periudhës raportuese është pranuar konfirmimi i ligjshmërisë nga MAPL, duke u krijuar kështu baza ligjore për vazhdimin e procedurave administrative dhe finalizimin e procesit të kontraktimit me operatorët ekonomikë të përzgjedhur.
Pas pranimit të konfirmimit të ligjshmërisë Komuna ka përgatitur njoftimet zyrtare për operatorët ekonomikë, të cilët do të ftohen për nënshkrimin e kontratave të shfrytëzimit. Nënshkrimi i kontratave pritet të realizohet në një afat shumë të shkurtër, duke i hapur rrugë fillimit të investimeve në terren.
Realizimi i këtyre projekteve pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Komunës, duke mundësuar aktivizimin e pronave komunale që nuk janë shfrytëzuar më parë, rritjen e investimeve, krijimin e vendeve të reja të punës, zhvillimin e kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë së ripërtritshme dhe realizimin e interesit publik.

Në periudhën e ardhshme raportuese, fokusi i Komunës do të jetë në përfundimin e procesit të nënshkrimit të kontratave, monitorimin e fillimit të investimeve dhe mbikqyrjen e zbatimit të obligimeve kontraktuale nga operatorët ekonomikë, me qëllim që projektet të realizohen sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.

Përveq pronave për të cilat ekziston obligimi ligjor i raportimit sipas nenit 22 të Ligjit Nr.06/L-092, gjatë periudhës raportuese Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi ka zhvilluar aktivitet të vazhdueshëm edhe në monitorimin e realizimit të obligimeve kontraktuale që rrjedhin nga kontratat e tjera të shfrytëzimit të pronës komunale, të lidhura në periudha të mëhershme.

Fokusi i këtij monitorimi ka qenë mbrojtja e interesit publik dhe sigurimi ni realizimit të të hyrave komunale nga qiraja e pronave të paluajtshme. Në këtë drejtim është bërë verifikimi i gjendjes së pagesave për secilin shfrytëzues, evidntimi i detyrimeve të papaguara, si dhe ndërmarrja e veprimeve administrative dhe juridike për inkasimin e obligimeve të prapambetura.

Gjatë kësaj periudhe janë përgatitur dhe dërguar njoftime zyrtare për subjektet dhe personat fizikë dhe juridik që kanë në shfrytëzim prona komunale, me të cilat janë rikujtuar për obligimet kontraktuale dhe janë ftuar që ti bëjnë pagesat e qirasë brenda afateve të përcaktuara. Këto njoftime kanë pasur si synim përmbushjen vullnetare të detyrimeve dhe shmangien e procedurave të mëtejshme ligjore.

Në rastet kur edhe pas njoftimeve, shfrytëzuesit nuk kanë përmbushur obligimet e tyre financiare, Komuna ka ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore për mbrojtjen e interesit të saj pasuror. Për një numër rastesh është inicuar procedura përmbarimore për realizimin e detyrimeve të papaguara, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Njëkohësisht, pas analizimit të gjendjes së secilit rast dhe evidentimit të shkeljeve të vazhdueshme të obligimeve kontraktuale, Drejtoria është në fazën fillestare të shqyrtimit të modaliteteve për përgatitjen e padive civile ndaj të gjithë shfrytëzuesve që, pavarësisht njoftimeve dhe mundësive të ofruara për përmbushjen vullnetare, vazhdojnë të mos i respektojnë detyrimet e tyre kontraktuale ndaj Komunës.

Këto veprime nuk kanë vetëm karakter inkasues, por synojnë gjithashtu forcimin e disiplinës kontraktuale, garantimin e trajtimit të barabartë të të gjithë shfrytëzuesve të pronës komunale dhe mbrojtjen e pasurisë publike. Zbatimi i kontratave dhe pagesa e rregullt e qirasë janë elemente thelbësore për menaxhimin e përgjegjshëm të pronës komunale dhe për sigurimin e të hyrave të qëndrueshme në buxhetin e Komunës.

Në periudhën vijuese do të vazhdohetme monitorimin sistematik të realizimit të obligimeve kontraktuale, ndërmarrjen e masave administrative dhe ligjore ndaj rasteve të mospërmbushjes së detyrimeve, si dhe njekjen e procedurave përmbarimore dhe gjyqësore deri në realizimin e plotë të të drejtave të Komunës. Kjo qasje synon jo vetëm rritjen e efikasitetit në meaxhimin e pronës komunale, por edhe forcimin e përgjegjshmërisë së të gjithë shfrytëzuesve ndaj obligimeve që burojnë nga kontratat e nënshkruara.

REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

# KOMUNA E ISTOGUT

OPSTINE ISTOK / MUNICIPALITY OF ISTOG

# RAPORTI FINANCIAR JANAR – QERSHOR

## Për vitin fiskal 2026

The picture can't be displayed.

## Përmbajtja

1. INFORMATA FINANCIARE ........................................ 3

2. RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT JANAR – QERSHOR 2026 ........................................ 3

2.1 PRANIMET (ALOKIMET) BUXHETORE PËR TM2 2026-2024 ........................................ 5

2.2 STRUKTURA E PRANIMEVE PERIODIKE NGA GRANTI I QEVERISË ........................................ 6

3. TË HYRAT VETANAKE PËR TM2 2026-2024 ........................................ 6

3.1 PASQYRAT E TË HYRAVE VETANAKE SIPAS KODEVE EKONOMIKE DHE DREJTORIVE PËR TM2 2026 ........................................ 8

3.2 TË HYRAT E REALIZUARA SIPAS DREJTORIVE PËR TM2 2026-2024 ........................................ 9

3.3 TË HYRAT E RREGULLTA TË PLANIFIKUARA DHE REALIZUARA NË BAZA MUJORE DHE KRAHASIMI I TYRE ........................................ 10

4. SHPENZIMET PËR TM2 2026-2024 ........................................ 11

4.1 SHPENZIMET SIPAS DREJTORIVE DHE KRAHASIMET PËR TM2 2026 - 2024 ........................................ 13

4.2 SHPENZIMET TOTAL NË ANALITIK PËR TM2 2026 - 2024 ........................................ 14

4.3 PLANIFIKIMI DHE SHPENZIMI I PROJEKTEVE KAPITALE PËR TM2-2026 ........................................ 16

5. RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE ........................................ 19

# 1. INFORMATA FINANCIARE

Informata Financiare Komunale për periudhën Janar – Qershor 2026, bëhet në bazë të kërkesave për raportim bazuar në dispozitat e nenit 45, paragrafi 45.2 dhe 45.4 të Ligjit Nr. 03/L-048 "Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë" dhe statutit Komunal.

Informata Financiare Komunale ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

### TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PËR TM2

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP të bazuar në para të gatshme (Standardet Ndërkombëtarë të Kontabilitetit në Sektorin Publik.

Komuna e Istogut nuk operon me llogarinë e vet bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar. Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Istogut janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vet me të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të Parave të Gatshme.

# 2. RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT JANAR –QERSHOR 2026

Buxheti Komunal sipas ligjit te Buxhetit Nr.10/L-001 në vlerë 16,687,746.00 € ka pësua ndryshime gjatë periudhes Janar – Qershor më një rritje prej 230,485.43 €: Buxheti pas rritjeve për këtë periudhe ka arrit në 16,918,231.43 € (Të hyrat dhe donacione të bartura nga vitet paraprake)

shiko tabelën:

| PËRSHKRIMI | | SHUMA € |
|---|---|---|
| Grandi qeveritar | € | 15,087,472.00 |
| Te hyrat vetanake | € | 1,600,274.00 |
| **Buxheti me ligjin e Buxhetit nr.10/L-001** | **€** | **16,687,746.00** |
| Mjetet e bartura nga viti paraprak | € | - |
| Donacione | € | 230,485.43 |
| **Buxheti shtesë** | **€** | **230,485.43** |
| **TOTAL BUXHETI** | **€** | **16,918,231.43** |

| RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT JANAR - QERSHOR 2026 | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Buxheti fillestar** | **Alokimi** | **Shpenzimi** | **Progresi me mjetet e alokuara** |
| **Përshkrimi** | **10/L-001** | **SIMFK** | **SIMFK** | në, % |
| **TOTALI** | **16,687,746.00** | **12,037,585.13** | **9,151,672.24** | **76.03** |
| **Granti i Përgjithshëm** | **15,087,472.00** | **11,260,219.90** | **8,748,317.16** | **77.69** |
| Paga dhe Meditje | 9,207,173.00 | 5,379,920.90 | 5,379,920.90 | **100.00** |
| Mallrat dhe Shërbimet | 2,881,489.00 | 2,881,489.00 | 1,312,180.23 | **45.54** |
| Shpenzimet Komunale | 337,600.00 | 337,600.00 | 149,378.71 | **44.25** |
| Investimet Kapitale | 2,661,210.00 | 2,661,210.00 | 1,906,837.32 | **71.65** |
| **Të hyrat vetanake** | **1,600,274.00** | **546,879.80** | **403,355.08** | **73.76** |
| Paga dhe Meditje | 40,000.00 | 10,000.00 | - | **-** |
| Mallrat dhe Shërbimet | 116,000.00 | 15,000.00 | 11,207.35 | **74.72** |
| Subvencione dhe Transferet | 523,000.00 | 226,576.92 | 131,655.00 | **58.11** |
| Investimet Kapitale | 921,274.00 | 295,302.88 | 260,492.73 | **88.21** |
| **Mjetet e bartura** | **-** | **-** | **-** | **#DIV/0!** |
| Mallrat dhe Shërbimet | - | - | - | **#DIV/0!** |
| Shpenzime Komunale | - | - | - | **#DIV/0!** |
| Subvencione dhe Transferet | - | - | - | **#DIV/0!** |
| Investimet Kapitale | - | - | - | **#DIV/0!** |
| **Grantet - Donacionet** | - | 230,485.43 | - | **-** |
| Subvencione dhe Transferet | | 1,174.00 | - | **-** |
| Investimet Kapitale | | 229,311.43 | - | **-** |
| **Pagesat Direkte** | **16,687,746.00** | **12,037,585.13** | **9,151,672.24** | **76.03** |




| | Granti I Përgjithshem | Të hyrat Vetanake | Mjetet e Bartura nga vitet paraprake | Donacionet |
|---|---|---|---|---|
| Alokimi | € 11,260,219.9 | € 546,879.80 | € - | € 230,485.43 |
| Shpenzimi | € 8,748,317.16 | € 403,355.08 | € - | € - |

## 2.1 PRANIMET (ALOKIMET) BUXHETORE PËR TM2 2026-2024

| Burimi i mjeteve | Pranimet Periodike TM2 2026 | Pranimet Periodike TM2 2025 | Pranimet Periodike TM2 2024 | Progresi - 1 vitë | Progresi - 2 vitë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | 2 | 3 | 6=2/3 | 7=2/4 |
| Grandi Qeveritar | 11,260,219.90 | 10,540,402.77 | 10,687,144.26 | -1.37% | 6.24% |
| Të hyrat vetanake | 546,879.80 | 697,847.75 | 655,493.40 | 6.46% | 6.26% |
| Mjetet e Bartura | 0 | 950,352.50 | 528,369.28 | 79.87% | 138.79% |
| Huamarrja | 0 | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Financimi Huamarres per klauz. Invest. | | - | 144,804.00 | -100.00% | #DIV/0! |
| Donacionet | 230,485.43 | 19,151.50 | 45,255.54 | -57.68% | -29.31% |
| **Gjithsej** | **12,037,585.13** | **12,207,754.52** | **12,061,066.48** | **1.22%** | **10.95%** |




Për TM2 të vitit fiskal 2026 % e pranimeve financiare (Alokimeve) duket si vijon:

- Të hyrat nga Grandi përbëjnë 93 % të totalit mjeteve financiare,
- Të hyrat Komunale 5 % të totalit mjeteve financiare
- Të hyrat nga donacionet 0.16 % të totalit mjeteve financiare

Gjithashtu, mos-alokimi i një pjese të konsiderueshme të të hyrave të mujait qershor ndikon në pasqyrën reale të disponueshme të mjeteve financiare për periudhën raportuese.

**Vërejtje:** *Nuk janë alokuar dhe shpërndarë vlera 186,040.81 € pjesa e të hyrave të grumbulluara të muajit Qershor si dhe 111,232.00 € Gjobat e TM2 po ashtu nuk jan alokuar Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti paraprak në vlerë prej 1,173,970.29 €*

## 2.2 STRUKTURA E PRANIMEVE PERIODIKE NGA GRANTI I QEVERISË

| | ALOKIMI TM2 2026 | ALOKIMI TM2 2025 | ALOKIMI TM2 2024 |
|---|---|---|---|
| **Klasifikimi ekonomik** | | **€ '** | **€ '** |
| Pagat dhe Meditje | 5,379,920.90 | 4,307,148.37 | 4,943,665.26 |
| Mallra dhe Shërbime | 2,881,489.00 | 2,576,763.00 | 2,314,230.00 |
| Shpenzime Komunale | 337,600.00 | 310,000.00 | 232,000.00 |
| Pasuri Jofinanciare | 2,661,210.00 | 3,346,491.40 | 3,197,249.00 |
| **TOTALI** | **11,260,219.90** | **10,540,402.77** | **10,687,144.26** |




## 3. TË HYRAT VETANAKE PËR TM2 2026-2024

| Te Hyrat nga: | Realizimi TM2 2026 | Realizimi TM2 2025 | Realizimi TM2 2024 | Progresi me -1 vit | Progresi me -2 vite | % në total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4=1/2 | 5=1/3 | 6=1/total |
| Të hyrat e rregullta | 646,582.91 | 730,427.45 | 693,965.76 | -11.48% | 93.17% | 80.02% |
| Gjobat e trafikut | 170,516.00 | 157,781.00 | 99,069.00 | 8.07% | 172.12% | 17.29% |
| Gjobat e Gjykatave | 19,035.00 | 24,580.00 | 24,420.00 | -22.56% | 77.95% | 2.69% |
| Exploatimi I pyjeve - APK | 8,103.38 | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! | 0.00% |
| Donacionet | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! | 0.00% |
| **Totali** | **844,237.29** | **912,788.45** | **817,454.76** | **-7.51%** | **103.28%** | **100.00%** |




Përveç Grandeve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka grumbulluar edhe të hyra vetanake sipas rregulloreve: Rregullorja mbi Taksa Ngarkesa dhe Gjoba. Të hyrat kryesore komunale janë: tatimi në pronë, lejet ndertimore dhe mjedisore, taksa për ndërrim të destinimit të pronës, shërbimet e kadastrave etj.

Periudha Janar-Qershor 2026 karakterizohet me një realizim i të hyrave në total 844,237.29 € apo 52.75 % në raport me planifikimin ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi përqindje me të ulët për 7.51 %.



## 3.1 PASQYRAT E TË HYRAVE VETANAKE SIPAS KODEVE EKONOMIKE DHE DREJTORIVE PËR TM2 2026

| PËRSHKRIMI | Realizimi TM2 2026 | Realizimi TM2 2025 | Realizimi TM2 2024 | Prog.me -1 vit | Prog.me -2 vite |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4=1/2 | 5=2/3 |
| 50013 - TAKSA PËR CERTIFIKATAT E LINDJES | 2,747.00 | 2,323.00 | 1,567.00 | 18.3% | 75.3% |
| 50014 - TAKSA PËR CERTIF. E KURORËZIMIT | 244.00 | 284.00 | 219.00 | -14.1% | 11.4% |
| 50015 - TAKSA PËR CERTIFIKATAT E VDEKJES | 3,505.00 | 2,853.00 | 2,121.50 | 22.9% | 65.2% |
| 50016 - TAKSA PËR CERTIFIKATA TJERA | 21,291.00 | 19,462.00 | 17,988.00 | 9.4% | 18.4% |
| 50017 - TAKSA PËR VERIFIKIMIN E DOKUM. | 90.00 | 59.00 | 67.00 | 52.5% | 34.3% |
| **ADMINISTRATA E PERGJITHSHME** | **27,877.00** | **24,981.00** | **21,962.50** | **11.6%** | **26.9%** |
| 50104 - GJOBAT NGA INSPEKTORATI | 1,236.00 | 1,100.00 | 3,752.50 | 12.4% | -67.1% |
| 50505 - LICENCA PËR PRANIM TEKNIK TE LOKALIT | 2,067.50 | 2,625.00 | 1,315.00 | -21.2% | 57.2% |
| 50505 - INSPEKTIMI VETERINAR BRENDA VENDIT | 4,636.00 | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **INSPEKCIONI** | **7,939.50** | **3,725.00** | **5,067.50** | **113.1%** | **56.7%** |
| 40110 - TATIMI NË PRONË | 325,922.40 | 399,068.72 | 264,796.60 | -18.3% | 23.1% |
| 50001 - TAKSA - REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE | 61,035.00 | 57,000.00 | 52,980.00 | 7.1% | 15.2% |
| 50019 - TAKSA TJERA ADMINISTRATIVE | | 36.00 | 32.00 | -100.0% | -100.0% |
| 50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **BUXHET E FINANCA** | **386,957.40** | **456,104.72** | **317,808.60** | **-15.2%** | **21.8%** |
| 50019 - TAKSA TJERA ADMINISTRATIVE | 136.00 | 161.00 | 129.00 | -15.5% | 5.4% |
| 50290 - LICENCA TJERA PËR AFARIZEM | | - | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **SHERBIMET PUBLIKE** | **136.00** | **161.00** | **129.00** | **-15.5%** | **5.4%** |
| 50012 - TAKSA PËR NDËRRIM TË DESTINIMIT TË PRONËS | 2,000.00 | - | 5.50 | #DIV/0! | 36263.6% |
| 50290 - LICENCA TJERA PËR AFARIZEM | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50019 - TAKSA TJERA ADMINISTRATIVE | 31.00 | 2,004.00 | 2,212.00 | -98.5% | -98.6% |
| **BUJQËSIA** | **2,031.00** | **2,004.00** | **2,217.50** | **1.3%** | **-8.4%** |
| 50202 - LICENCA - SHTIJE NË RRUGË - KIOSKË | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50290 - LICENCA TJERA PËR AFARIZËM | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50211 - LICENCA PËR SHËRBIME TË PIJEVE ALKOOLIKE | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **ZHVILLIMI EKONOMIK** | | **-** | **-** | **#DIV/0!** | **#DIV/0!** |
| 50032 - TAKSA PËR CERTIFIKATA TË PRONËSISË DHE KOPJE PLANI | 17,169.00 | 7,798.00 | 6,625.00 | 120.2% | 159.2% |
| 50405 - SHFRYTËZIMI I PRONËS PUBLIKE | | 4,610.00 | - | -100.0% | #DIV/0! |
| 50504 - TAKSA PËR MATJEN E TOKËS NË TEREN | 39,342.55 | 35,809.00 | 68,609.00 | 9.9% | -42.7% |
| **KADASTRA** | **56,511.55** | **48,217.00** | **75,234.00** | **17.2%** | **-24.9%** |
| 50009 - TAKSA PËR LEJE NDËRTIMI | 36,584.72 | 74,410.79 | 154,714.91 | -50.8% | -76.4% |
| 50012 - TAKSA PËR NDRRIMIN E DESTINIMIT TOKËS | 24,375.25 | 16,710.75 | 13,832.25 | 45.9% | 76.2% |
| 50026 - TAKSA PËR LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE | 15,004.77 | 8,150.84 | 12,255.01 | 84.1% | 22.4% |
| 50045 - LEJE MJEDISORE KOMUNALE | 4,547.32 | 8,262.84 | 7,707.87 | -45.0% | -41.0% |
| 50290 - LICENCA TJERA PËR AFARIZEM | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| 50405 - SHFRYTËZIMI I PRONËS PUBLIKE | | - | 1.00 | #DIV/0! | -100.0% |
| **URBANIZMI** | **80,512.06** | **107,535.22** | **188,511.04** | **-25.1%** | **-57.3%** |
| SHENDETESIA | 26,612.90 | 29,131.80 | 28,623.80 | -8.6% | -7.0% |
| KULTURA | | 224.00 | 1,315.82 | -100.0% | -100.0% |
| ARSIMI | 58005.5 | 58,343.71 | 53,096.00 | -0.6% | 9.2% |
| **TE HYRAT DIREKTE** | **646,582.91** | **730,427.45** | **693,965.76** | **-11.5%** | **-6.8%** |
| TE HYRAT NGA TRAFIKU | 170,516.00 | 157,781.00 | 99,069.00 | 8.1% | 72.1% |
| TE HYRAT NGA GJYKATA | 19,035.00 | 24,580.00 | 24,420.00 | -22.6% | -22.1% |
| EXPLOATIMI I PYJEVE - APK | 8,103.38 | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **TE HYRAT INDIREKTE** | **197,654.38** | **182,361.00** | **123,489.00** | **8.4%** | **60.1%** |
| **DONACIONET** | **0** | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **TOTALI I TE HYRAVE** | **844,237.29** | **912,788.45** | **817,454.76** | **-7.5%** | **3.3%** |

## 3.2 TË HYRAT E REALIZUARA SIPAS DREJTORIVE PËR TM2 2026-2024

| PËRSHKRIMI | Realizimi TM2 2026 | Realizimi TM2 2025 | Realizimi TM2 2024 | Progresi me Totalin e THV | Progresi - 1 vitë |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4=1/Total | 5=1/2 |
| Administrata | 27,877.00 | 24,981.00 | 21,962.50 | 3.3% | 12% |
| Inspekcioni | 7,939.50 | 3,725.00 | 5,067.50 | 0.9% | 113% |
| Buxhet e Financa | 386,957.40 | 456,104.72 | 317,808.60 | 45.8% | -15% |
| Sherbimet Publike | 136.00 | 161.00 | 129.00 | 0.0% | -16% |
| Bujqësia | 2,031.00 | 2,004.00 | 2,217.50 | 0.2% | 1% |
| Zhvillimi Ekonomik | | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| Kadastri | 56,511.55 | 48,217.00 | 75,234.00 | 6.7% | 17% |
| Urbanizmi | 80,512.06 | 107,535.22 | 188,511.04 | 9.5% | -25% |
| Shendetësia | 26,612.90 | 29,131.80 | 28,623.80 | 3.2% | -9% |
| Kultura | - | 224.00 | 1,315.82 | 0.0% | -100% |
| Arsimi | 58,005.50 | 58,343.71 | 53,096.00 | 6.9% | -1% |
| Denimet ne trafik | 170,516.00 | 157,781.00 | 99,069.00 | 20.2% | 8% |
| Te hyrat nga Gjykata | 19,035.00 | 24,580.00 | 24,420.00 | 2.3% | -23% |
| Exploatimi I pyjeve | 8,103.38 | - | - | 1.0% | #DIV/0! |
| **TOTALI I TE HYRAVE** | **844,237.29** | **912,788.45** | **817,454.76** | **100.0%** | **-8%** |
| Donacionet | - | - | - | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **Gjithsej me Participime** | **844,237.29** | **912,788.45** | **817,454.76** | **100.0%** | **-8%** |




Siç shihet nga tabela, Drejtoritë që grumbulluan më së shumti të hyra janë: Buxhet e Financa 53 %, Kadastra 6.7 %, Urbanizmi 9.5 %, Arsimi 6.9 %, Shëndetësia 3.2 % poashtu të hyrat indirekte Dënimet në trafik 20.2 %, etj.

### 3.3 TË HYRAT E RREGULLTA TË PLANIFIKUARA DHE REALIZUARA NË BAZA MUJORE DHE KRAHASIMI I TYRE **2026-2024**

| Periudha | Realizimi 2026 | Realizimi 2025 | Realizimi 2024 | Krahasimi me vitin 2025 | Krahasimi me vitin 2024 |
|---|---|---|---|---|---|
| **Janar** | 86,821.62 | 75,314.64 | 120,381.70 | 15% | 0.72 |
| **Shkurt** | 55,456.11 | 85,485.09 | 64,566.80 | -35% | 0.86 |
| **Mars** | 78,385.47 | 75,375.17 | 128,450.93 | 4% | 0.61 |
| **Prill** | 138,880.50 | 225,957.02 | 161,302.05 | -39% | 0.86 |
| **Maj** | 100,913.72 | 152,057.83 | 126233.47 | -34% | 0.80 |
| **Qershor** | 186,125.49 | 116,237.70 | 93,030.81 | 60% | 2.00 |
| **Korrik** | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **Gusht** | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **Shtator** | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **Tetor** | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **Nëntor** | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **Dhjetor** | | | | #DIV/0! | #DIV/0! |
| **Totali** | **646,582.91** | **730,427.45** | **693,965.76** | **-11%** | **0.93** |




Nga të dhënat e paraqitura në tabelë vërehet se gjatë periudhës janar – qershor 2026, realizimi i të hyrave të rregullta ka arritur në 646,582.91 €, që është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, ku realizimi ishte 730,427.45 €. Kjo paraqet një rënie prej 83,844.54€ apo rreth 11%.

Performanca shumë e mirë në muajin qershor ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e rezultatit kumulativ.

## 4. SHPENZIMET PËR TM2 2026-2024

Buxheti për tremujorin e parë (TM2) është 16,918,231.43 €. Gjatë kësaj periudhe buxhetore janë alokuar mjete në vlerë prej 12,037,585.13 €, ndërsa shpenzimet e realizuara arrijnë në 9,151,672.24 €, që përfaqësojnë 76.03% të buxhetit të alokuar. Ky nivel i shpenzimeve tregon një realizim të knaqëshem në raport me mjetet e alokuara.

***Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike***

